



Nebil DURAKU

Biografia

Nebil Duraku u lind më 1934 në Burojë të Skenderajt. Filloi të mësojë si autodidakt, shkollën fillore e kreu në Turiçefc më 1948, shkollën tregtare-financiare të kontabilitetit e kreu në Pejë më 1950. Punoi si nëpunës në rrethin e Drenicës, prej nga vijoi kurset pedagogjike në Prizren, Pejë, Mitrovicë dhe në Prishtinë. Më vonë studioi me korrespondencë në Fakultetin Juridik të Universitetit të Beogradit dhe të Prishtinës.

Ushtri detyrën e mësuesit dhe të arsimitarit më 1951-'52 në Prekaz të Epërm, më 1952-'53 në progjimnazin e në shkollën tetëvjeçare të Runikut, ndërsa më 1955

në shkollën tetëvjeçare të Turiçefcit. Atëkohë, u ballafaqua drejtpërdrejt me problematikën që do të shërbejë si subjekt i shumë trajtimeve letrare e artistike në veprimtarinë e tij të mëvonshme mjaft të pasur, si shkrimtar e publicist.

Në vitet 1957-'75 Nebil Duraku qe gazetar i së përditshmes „Rilindja”, në vitet 1975-'77 redaktor në „Gazeta e delegatëve” të Kuvendit të Kosovës dhe në vitet 1977-'89 punoi si redaktor-reporter i Televizionit të Prishtinës. Gjithashtu qe bashkëpunëtor i disa gazetave dhe i revistave që botoheshin në ish-Jugosllavi si „VUS” (Vjesnik u srijedu) të Zagrebit, „Delo” të Lubjanës e të tjera.

Më se tridhjetë vjet Nebil Duraku qe gazetar i pasionuar, i cili shquhej për shkrimet e tij të qarta, të mbujtura e me përmbajtje interesante në publicistikën shqiptare.

Emri i Nebil Durakut është i njohur në letërsinë shqipe që nga viti 1952, ku paraqitet me shkrimet e para. Që atëherë fillojnë e shtresohen idetë e tij krijuese në projektimin dhe realizimin e temave e motiveve, ku ndërliiden bashkëpunimi i tij me të gjitha gazetat dhe revistat shqip që botoheshin në Kosovë e gjetkë. Formë e krijimtarisë së tij krijuese më vonë u bë proza me temat sociale, psikologjike, të aktualitetit e të vizioneve atdhetare e historike. Prandaj, Nebil Duraku shkroi radhazi tregime dhe romane, ku në thelbin e veprimit përgjithnjë paraqitej njeriu i këtij mjedisi, me shpirtin dhe karakterin e tij, në përpjekje të vazhdueshme për qëndrueshmëri, rezistencën dhe identitetin e tij shpirtëror, kombëtar, kulturor...

Librin e parë me tregime për fëmijë „Topi i larmë” (1965) e botoi në redaksinë e botimeve „Flaka e vëllazërimit” të Shkupit. Më 1966 Nebil Duraku në redaksinë e botimeve „Rilindja”, botoi romanin e tij të parë „Murgesha”, një libër interesant dhe i njohur për rezultate të qëndrueshme prozaike, veçan për temën dhe rrëfimin. Më tutje ky autor u bë një shkrimtar i afirmuar te botuesi „Rilindja”, ku panë dritën romanet „Shtrojera” (1969, ribotimi 1979), „Drenusha” (1980), libri i tregimeve „Kobi” (1983), romani „Egjra” (1989). Romani „Shtrojera” u botua edhe nga Shtëpia botuese „Naim Frashëri” e Tiranës më 1983.

Në vargun e veprave të botuara të Nebil Durakut, u dallua romani „Dhengrënësit” (1980), i cili u botua në vazhdime në gazetën „Flaka e vëllazërimit” të Shkupit. Revista letrare shqipe „Koha” e Podgoricës botoi në vazhdime romanet „I treturi” (1983) dhe „Murana” (1986).

Në fushën e veprimtarisë së tij krijuese, Nebil Duraku u morr edhe me krijimtari dramatike. Radio Prishtina emtoi radio-dramat „Tregtari i kafshatave të dreqit” dhe „Kah fryn era”, ndërsa Televizioni i Prishtinës realizoi dramën e tij televizive „Kopshti i pleqërisë”. Më vonë u vu në skenë edhe drama „Maska e çjerrë”. Është autor edhe i disa skenareve të filmit e të televizionit, nga të cilat i është realizuar

edhe skenari i filmit dokumentar „Lëneshat”. Ka përgaditur skenarin për serialin televiziv „Fedonët” dhe dramën televizive „Rrënjët e thella”.

Nebil Duraku është autor i librit monografik „Ekonomia e Kosovës sot e në perspektivë” (1976) dhe i librit-leksikon „Shkrimtarët e Kosovës ’43-’83”, botuar më 1984.

Shkrimtari Nebil Duraku, pas një sëmundjeje të rëndë vdiq më 26 tetor 1989 në Klinikën „Rebro” të Zagrebit, dhe gjeti prehjen në atdheun e tij, në varrezat e Prishtinës.

Vepra letrare e Nebil Durakut, e përmbledhur përbrenda këtij kompleti, ndër të tjera dëshmon se ai qe një shkrimtar me koncepte e ide të qarta krijuese dhe me vizion të mprehtë...

Detaj nga xhirimi i filmit "Tybelitë" (1966)



Nga vizita e shkrimtarëve të Shqipërisë në Kosovë (1971)



Duke prezentuar kulturën Kosovare në një qendër perëndimore






Intervista e bërë aktorit të mirënjohur Xhon Dereku në shoqëri të Ursulla Andres,

Intervista me kryetarin e Turqisë Bylent Exhevit





*Shtëpia ku u lind
shkrimtari Nebil Duraku*



*Shkrimtari Nebil Duraku
me babanë dhe motrën*



*Nebil Duraku
arsimtar në
shkollën fillore
"Liria" të Turiçefcit*



Formimi i Shoqatës letrare "Përpyekja" në Beograd. (1957)



Nebil Duraku gjatë punës në gazetën "Rilindja"

Me rastin e kremtimit të 60-vjetorit të sh. f. "Liria" të Turiqecit, pranë mësuesit të tij të parë A. Kelmendi (1986)



Nga takimet e shkrimtarëve të Kosovës në Deçan

Çast me kolegët e tij gazetarë të "Rilindjes"



KOHA E KUNDËRSHTISË

Hyrje për interpretim

Mendimi kritik për prozën tregimtare dhe romanore të Nebil Durakut, çelet me dashje me titujt e veprave të tij: „Murgesha”, „Drenusha”, „Murana”, „Shtrojera”, „Egjra”, e të tjerë, për të cilat fillimisht duhet thënë se janë tituj simbolikë që shtresojnë domethënie të caktuara. Kështu, në pikëpamje të organizimit tematik e motivor, veprat e këtij shkrimtari marrin si model shkrimi realitetin, aktualitetin, problemet e shoqërisë e të njeriut në periudha të caktuara kohore. Aty përshkruhen e portretizohen fate njerëzish të lumtur e të zhgënjyer, të vuajtur e plot dhembje, të shtypur e të torturuar në forma dhe mënyra të ndryshme, por më shumë edhe njerëz të guximshëm, që flijohen për idealin atdhetar.

Romanet e Nebil Durakut, para së gjithash, i shquan rrëfimi, cilësi kjo e rëndësishme për prozën e një shkrimtari. Në pika të veçanta rrëfimore tërhiqet diagonalja e kuptimësisë së veprimit të personazhit. Kësisoj, proza tregimtare e Nebil Durakut, ndër të tjera, krijon domosdoshmërinë e krijimit të një realiteti që prodhon situatën morale, politike, shoqërore. Poetika e shkrimit të tij është pikëpamje e shtresuar në kohën dhe e shtrirë në hapësirën e nyjave jetësore.

Në prozën e Nebil Durakut trajtohet jeta me efektivitetin e saj drejtues e ngatërrues, prodhohet koha e bëmave dhe të ndodhurave në rendin shoqëror. Gjithsesi, krijimi i realitetit është gjithfarësh. Nga një shkrirje e krijimtarisë letrare gojore, sidomos e frazeologjisë popullore, N. Duraku „rikrijon” tema të dëgjua e të lexuara, ku shtresohet mënyrësia e përrallës, e gojëdhënës e mitit, e anekdotave dhe e formave të tjera të thjeshta epike. Fryt i prodhimit të tij në krijimtarinë është, para së gjithash, takimi i drejtpërdrejtë me këto tipe të shkrimit letrar e të letërsisë gojore.

Proza e Nebil Durakut është shfaqje lëndore që me idetë themelore percepton realitetin. Intuiti i jetës në të nuk është e përfytyruar, por e ndodhur. Nisesos, proza e tij rrëfimtare i përsërit ngjarjet në relacione të caktuara poetike. Në këtë pikëshikim, ngjarja nuk jepet me tejmasën e figurshmërisë, por si detaj i projektuar dhe i funksionalizuar me tejdukshmëri krijuese. Pa dyshim, tejdukshmëria është shprehësi e modelit të tij tregimtar. Në pjesën më të realizuar dhe më të arrirë të krijimtarisë së tij letrare qartësohet porosia për ekzistencën nëpër udhëtimin jetësor të qenies kombëtare.

Në artin e të shprehurit, Nebil Duraku vë në veprim mendimin e qartësuar të rrëfimtarit. Teksti i tij tregimtar anon më shumë nga personazhi i përgjithësuar shoqëror sesa nga njeriu veprues vetjak. Ndonjëherë, proza e këtij autori merr

atributin e „doracakut retorik e patetik”, që niset nga mësimi i qarkullimit të ideve. Kësisoj, depërtimi në thelbin kuptimor, në materien e saj nuk është vetëm çështje e fenomenologjisë së leximit kritik. Në shkrime të tilla a të ngjashme, koha e vijëzon, e përthekon, natyrën e njeriut dhe i shtreson fenomenet natyrore dhe shoqërore. Detyrimisht, poenta e kësaj proze parapëlqen qartësinë, madje deri në zbulimin e njëjtësisë shpirtërore, kulturore e kombëtare.

Në organizimin tematik e motivor, pothuajse, mbizotëron kërshtëria për temat ekzistenciale. Rrjedha e ngjarjes i përmbledh të dhënat jetësore përbrenda një skeme të caktuar. Prandaj, ky tip shkrimi tregimtar sikur venerohet gjatë çastit të krijueshmërisë me të dhënat e vërteta. Autori shpreh një botë më vete në mbizotërimin e asaj periudhe që vlonte nga kundërshti të ndryshme. Në këtë kuptim, veprat kanë vlerën e tyre jo vetëm përbrenda kohës kur janë shkruar. Për hir argumentimi, duhet thënë se proza e Nebil Durakut është paraqitje e një kohe ku rrinë bashkë entuziazmi me gjendjet absurde ose ku gërshetimi i marrëdhënieve njerëzore bëhet përmes „përmasës ideologjike”. Kësisoj, „fati i bashkësisë”, ndërlidhnisht, përcaktohet nga paralelizmi i së mirës me të keqen njerëzore përbrenda jetës shoqërore. Tek ky shkrimtar, njësoj është sipërtheksuar lidhja shkakësore e gjendjeve dhe ballafaqimi me konvencat. Prozatori nuk e fsheh dhe as e mbulon zhgënjimin me të ndodhurën në realitet, madje duke mishëruar tregimtarinë e tij fuqimisht me jetën.

Në të vërtetë, qëndrimi i autorit niset nga venerimi i gjendjes reale të njeriut. Synimi jetësor kapërthuret nëpër etapat e përvijuara të botëkuptimit dhe botëperceptimit letrar. Kështu që, përpjekja për ta rrëfyer të vërtetën në procesin e të treguarit, do të thoshim, përqendrohet te mënyra e gjurmimit të njësisë të parapëlqyera kuptimore të prozës.

Në prozën e Nebil Durakut përpara ideve dhe domethënieve poetike kërkohet gjithnjë porosia kryesore. Ky kërkim është i hapur me forma të mundshme e të thurura me vërtetësi artistike.

Në procesin e të shkruarit, Nebil Duraku sikur e ka adhuruar shumë ambientin e jashtëm me gjendjet e shpaluara në ndërdijen e rrëfimitarit. Gjithsesi, ai është i ndërgjegjshëm për vërtetësinë e tillë të procedimit të ngjarjeve, të personazheve e të ambientit në rrethana të caktuara. Proza e tij është shprehësi kohore si shkak-pasojë e asaj që përshkruhet e ndodh në jetë.

Tani vetëdija krijuese në mënyrë „shkërbyese” komunikon me ambientin dhe njeriun duke i shkallëzuar gjendjet përbrenda kornizës dokumentare.

Mund të pohojmë qartë e bindshëm se proza e Nebil Durakut, veçantinë rrëfimore e ka të shtresuar në shumë rrafsh të kuptimësisë. Domethënë, shkrimtari bazohet mbi ndjenjat e veta që shpallen si të dëshiruara, për të sugjeruar gjendjen e çdo vizioni dhe të çdo ngjarjeje. Autori zgjedh vetë tematikën pa iu imponuar fare tregimtarisë librore si model për të shenjuar e konkretizuar kohën dhe hapësirën për procedim dhe rrëfim. Vërtet, vetë jeta bëhet temë-mëdyshje e zatetur në tipin e kësaj proze, që na del fort e përqendruar në artin e të treguarit real.

Midis botës së lirisë e të robërimit

1. Romani për fatin e një personazhi

Romani **Murgesha** i Nebil Durakut fillon me simbolikën e shiut duke dëftuar gjendjen rrëfimore me vijëzim kumbues të mënyrës së perceptimit të ambientit dhe të çfarësisë së karakterizimit të personazhit. Është roman që si prodhim shkrimi zberthen fatin e gruas, jetimërinë, në rrethana të caktuara vetjake e shoqërore. Pikënisja ofron subjektin në një proces kronologjik të ngjarjes duke e problematizuar fatin e *fëmijës së dashurisë*. Gjendja është e tejbartur me një ankim të pandërprerë rreth shtrëngesave të fatit për të gjëlluar. Rrjedha e veprimit, fillimisht, është shpjeguese.

Romani i Nebil Durakut shtreson dhe e karakterizon fatin e murgeshës. Kujtimi i të ndodhurës shpaloset nga pikëshikimi i rrëfimitarit. Teksti rrëfimor kalon nëpër shkallët që janë afër perceptimit duke paraqitur një botë të mbushur me dhembje të çuditshme shpirtërore. Mjerimi i njeriut, mbyllja, vetëfljimi i dashurisë, përhumbja e ëndrrave nëpër dyert e „shpëtimit”, bëhen temë - mëdyshje e zgjidhjes fabulative. Ngjarja sillet nëpër shtresat kuptimore të reales: zberthehet fati i murgeshës që lind murgeshën. Një trashëgimi e dhembjes shpirtërore e përplasur në dallgët e jetës e të botës, në kohë-hapësirën e përcaktuar, siç është ambienti i fshatit.

Në gjurmimin e gjendjeve përbrenda këtij teksti artistik, mbizotëron tema e jetës, e vuajtjes, e dashurisë. Lidhja e ngjarjes përfytyron dhembjen, keqardhjen për ndodhinë e tillë: rizbulimi i fatit të *Marës*; lindja e *Syzanës* (Jelenës); bamirësia e *Tomës*; vija rrëfimore dashurore midis *Ukës* dhe Jelenës (Syzanës); dialogu i murgeshave për fatin e „pëllumbit të përgjakur”; raporti Jelena-Pareskeva; shpëlarja e mëkatit; funksioni i personazheve femra, siç janë *Paulina*, *Gita*; dasma, ambienti, mëdyshja nëse është *Shabani* burri i *Marës*; prishja e dashurisë ose ndarja e Jelenës nga *Uka* e të tjerë deri tek mbarimi i romanit me epilog dhe porosi të reduktuar.

Përbrenda gjendjeve të përmendura, veçan funksionalizohet mëdyshja shpirtërore e njerëzore e murgeshës, fija e depërtimit të dashurisë në shpirtin e *Ukës* dhe përballimi i vuajtjes. Autori, vijimisht, ndjek ndëshkimin që i bën *Paraskeva* murgeshës, duke fuqizuar në anën tjetër edhe dashurinë e murgeshës me *Ukën*.

Romani „Murgesha”, shenjëzon, fund e krye, fatin e njeriut. Episodet e rënda të jetës konceptohen në mënyrë reale në prozën e Nebil Durakut. Realiteti i mbërthyer përbrenda pozitës sociale të personazhit, gjithsesi, përfytyrohet drejt polit tjetër, ku gjallëron ende individi keqbërës, siç është vetë *Paraskeva* e kishës së *Deviçit*.

Romani „Murgesha” zbulon një përmasë joshëse, që ndërlihet me disa tipa dhe karaktere që bëjnë jetën e detyruar të mbylljes e të vetëburgimit. Në rrafshin e të menduarit, ky tip shkrimi dhembjen dhe dashurinë i shqipton nga pozicionimi social. Karakterizimi bëhet në nivelin e njohjes së personazheve. Është gjendja jetësore e shoqërore që shenjzon lëvizjen dhe veprimin e personazheve.

Kërkimi i jetës, thelbësisht, bëhet nëpërmjet rrugëve të ndryshme që e afrojnë kuptimin e njëmendësisë. Në këtë jetë diçka duhet të ndërrojë: zakonet, botëkuptimi, apo rrethi shoqëror. Në punën e konkretizimit të ngjarjes, Nebil Duraku vë në veprim personazhin real, njeriun që lufton me ligjet e natyrës e të shoqërisë. Do të pohohet se ambienti i fshatit skicohet me ngjyra të forta që ndonjëherë e motivojnë psikologjikisht edhe njeriun që i përket atij duke iu falur përshkrimin të natyrës, bukurisë, porosisë, pamjeve, në një anë, dhe duke përjashtuar fatkeqësitë që ndodhin në ambientin e këtyre njerëzve, në anën tjetër.

Në këtë rrjedhë, shqiptimi i dhembjes shpirtërore të personazheve ngulitet edhe tek imtësia e simbolizuar. Në këtë mënyrë, pikëvështrimi i *pëllumbit të përgjakur* dhe dialogu i murgeshave për fatin e tij, marrin kuptimin e dhembjes për shpendin e pafajshëm; një hapje e plagës së zemrës dhe e pamundësisë për ta ndërruar realitetin e vrazhdë të regjimit në kishë e gjetiu. Duke i përvijuar gjendjet e tablotë e tilla e të ngjashme, Nebil Duraku ka arritur të sensibilizojë përmallshëm rrëfimin e tij prej përmasës sentimentale e romantike deri te shfaqja e vizioneve realiste.

Ky roman, kryekëput skicon fatin vetjak të personazhit.

Kësisoj, ëndrra këtu bëhet realitet, e realiteti bëhet përmbajtje e përsëritur në rrafshin psikologjik. Kështu, djaloshi pa prindër e me emrin Ukë, thyen konvencionin e aktit moral duke derdhur tërë energjinë e tij shpirtërore me përftesën e fantazisë shenjzuese dashurore që kap fillin e njëmendësisë e të pikarritjes së një dashurie të përjetuar.

Në anën tjetër, Syzana i ikën „ndëshkimit të hapur” duke çelur fatin e vet nga „miti tragjik i rresës” në dëlirësi shpirtërore, në liri veprimi e simbolizim të dashurisë. Dashuria e saj me Ukën shtrihet prej ëndrrës magjepsëse të fëmijërisë që fillon të shkallëzohet nëpër rrathët e kujtesës e të ndodhisë reale deri në realizimin e shprishjes së sërishme. Prandaj, në romanin „Murgesha” prania e elementit dashuror mbizotëron në bazë të ndërëgjegjësimin qëllimor të rrëfimitarit. Dashuria e fshehur deri atëherë, tashti, në pikën e vlimit shpirtëror, doemos, bëhet ideal, vetëdije, ekzistencë.

Në këndin tjetër të pikëvështrimit, në romanin e Nebil Durakut hasim nivele të ndryshme të thënies rrëfimore dhe të takimit të personazheve, që në të vërtetë parathënë ngjarjen kryesore që realizohet nëpër shenjat e përfytyrimit gjatë të papriturave të ndryshme. Gjithsesi, dialogu i personazheve - gra, ku pasqyrohen dashuria dhe jeta, dhembja dhe vetmia, skamja dhe vuajtja, burgu dhe liria e të tjerë, zë një hapësirë të dukshme që vijëzohet në vetëdijen e rrëfimitarit. Këto gjendje përkufizohen përbrenda ambientit dhe rrethanave të caktuara shoqërore. Kësisoj, dhembja shkallëzohet në natyrën e në ambientimin e mbushur me

ikonografi dhe durimi pëlçet nga forca e mospërballimit dhe e shtegdaljes në kërkim të idealit jetësor.

Edhe në këtë roman të Nebil Durakut dokumentohet jeta, si në prozën e tij në përgjithësi. Dokumentariteti, kështu bëhet kërkesë kryesore estetike që kapet dhe shtrohet në pikësynimin e karaktereve të kësaj proze. Do të thotë, procedimi i vijës rrëfimore shqipton edhe të përditshmen përbrenda funksionit artistik.

Prej këtu, është e qartë edhe prania e shpjegimeve të tablove e të hollësive, e vijëzimeve ideologjike, e filozofimeve që sipërtheksojnë të dobishmën në jetë, sikundër edhe kuptimësia e humanitetit, e mbështetur në vlera shpirtërore, me paraqitje psikologjike të karaktereve e në pikëshikim të përmbajtjes së aktualitetit. Me këtë mënyrë, autori synon të krijojë e të shkruajë romanin për murgeshën duke përhumbur përmes vetëdijes shkrimore përmasën e burgut e të çmendisë, për të thelluar vizionin e dëshirës, të arsyes e të lirisë së njeriut. Pra, jetëshkrimi i shpirtit bëhet histori shpirtërore, jetësore, shoqërore në ballafaqim me egërsinë dhe vdekjen.

Në romanin „Murgësja”, ideja themelore strukturohet në përfaqje me fatin e fëmijës jetim. Gjithashtu, shqiptimi i gjendjeve të ndërlikuara shpirtërore e jetësore bëhet me portretizimin letrar të personazheve . Këtu kurthohet jeta me brengat e vijueshme të një ambienti ikonografik në kundërthënie me sfondin e ambientit burimor.

Pos kësaj, në këtë roman kemi paraqitjen e çasteve kyç gjatë dekompozimit të ndodhisë. Këtu theksohet problemi i moralit, takimi i fshehtë i murgeshave, dasma, prania e Gitës që „dokumenton” virgjinitetin e murgeshës, detaji i fluturës që lirohet nga poçi elektrik, gjyqi, ditëlindja, ndarja e të dashuruarve, e të tjera.

Përmes përshkrimit të saktë e të qartë, autori i vijëzon këto elemente përbrenda formave vepruese të jetës. Kësisoj, romani mbërrin efektin përmbajtësor duke u përqendruar me tejtheksimin e fatit të personazhit - grua. Megjithatë, midis botës së lirisë dhe botës së robërimit nuk vihet kufiri i kësaj proze. Nebil Duraku, duke ndërtuar ngjarjen me rolin shkakësor të kontrastimit të personazheve, përbrenda tekstit rrëfimor nuk e vë përgjithnjë simpatiken mbi tragjiken. Prandaj, karakteri njerëzor i këtij romani, edhe pas përfundimit kërkon mbarimin e lumtur, që fatkeqësisht nuk ngjan.

Rrjedhimisht, Syzana venitet nga ironia e fatit të saj të imponuar me thurje të tragjicitetit të vet, kurse Uka mbështetet në sinqeritetin dhe në të vërtetën që tundin pamëshirshëm joshjen e dritësimit dashuror. Kështu që, këputja e lumturisë së ëndërruar jetësore përmbillet brenda kornizës morale, ku „përzieshmëria” e personazheve, gjithsesi, mbetet enigmë e romanit.

2. Rrëfimi për realitetin e një kohe traumash

Romani **Shtrojera** në të gjitha vijat rrëfimore problematizon çështjet e realitetit shqiptar të kohës. Aty shqiptohet pjesa e dhembshme dhe e ndjeshme e qeniesisë,

por edhe fuqia e fjalës shqipe, e paraqitur përmes shkollës. Kësisoj, romani i Nebil Durakut, duke skicuar shtigjet e Kosjerit, kap dhe trajton edhe tema të tjera që kanë ndërlidhni me syzheun kryesor, siç janë: aksioni i armëve, shkollimi, dashuria, por edhe zakonet, mentaliteti, tradita, dukuritë e ndryshme të realitetit jetësor.

Mbase, „Shtrojera”, për specifikën e narracionit, është roman që mbështetet në një faktografi të qëndrueshme me një fabul të qartë, në sfondin e së cilës zhvillohet drama shpirtërore e një vajze, siç është *Hana*, në njërën anë dhe prania e dhunës shpirtërore e fizike në njerëzit e një ambienti fshatar, në anën tjetër.

Pa dyshim, romani „Shtrojera”, është vepra tregimtare më e arrirë e Nebil Durakut. Në njëzet kapitujt e këtij romani gjurmohet bota shpirtërore e njeriut nëpër faza të caktuara të jetës, ku fenomenet dhe dukuritë gjithandej „preken” drejtpërdrejt, edhe arti, kësaj radhe, është i konvencionalizuar. Në roman, gjithashtu, paraqiten paradokset e kontrastet e njerëzve nëpër të treguarit tragjik të ngjarjeve e të bëmave të tyre.

Nebil Duraku ka zgjeruar konceptet e tij krijuese duke i pikturuar këto karaktere sipas funksionit shoqëror që kanë. Kësisoj, përcaktimi i „shoqërizimit”, bëhet besueshmëri e aktantëve të kësaj vepre.

Në kuptimin artistik, romani „Shtrojera” ekspozon rendin e natyrës dhe të ambientimit shqiptar në pikëpamje kombëtare, morale, psikologjike. Në të gjitha nivelet e rrëfimit, thelbësisht, shtrohet ekzistenca e qenies njerëzore. Shkrimtari synon t’i ballafaqojë njerëzit e idealit jetësor e atdhetar me njerëzit e deformuar të apetiteve pushtetmbajtëse. Kësodore, qëllimi parësor i këtij romani është thjesht zbërthimi i kategorisë njerëzore në favorizimin e pjesës së saj më thelbësore, sikur edhe në stigmatizimin e denoncimin e karaktereve të dyshimta, karrieriste e të njollosura, që bëjnë përpjekje të ndryshme që të shtypin e të përdhosin çdo gjë që është kombëtare. Pra, niveli i kundërvënies përmes artit bazohet në bërjet historike dhe në përvojën jetësore.

2.a. Ndërtimi i ngjarjeve kundërthënëse

Romani „Shtrojera” përbëhet nga personazhe bardhë-zi, pozitive-negative, të këqija-të mira, të bukura-të shëmtuara, e të tjerë, që formësohen përbrenda tekstit artistik nga pozicioni i kundërshtisë në rrafshin tematik e estetik.

Fillimi i romanit ka të bëjë me forcën e veprimit të personazhit. „Kallëzimi” për ngjarjen ndërtohet poetikisht atëherë kur Hanën, vajzën e *Ali Fetahut*, e nxjerrin nga pusi, ku ajo gati po mbytej. Tashti, „rasti i përmytjes” në ujë shndërrohet në legjendë. Tema projektohet nëpër episode të veçanta. Prania e *Sylë Bimbashit*, është prani e egërsisë së zatetur moralisht e psikologjikisht në ndërdijen e njerëzve të ambientit të caktuar. Në rrethana tipike, fejesa e „detyrueshme” e Hanës me Ahmetin e Zenë Ferizit nga Kotorri, me insistimin e *Sylë Bimbashit* e të *Zymerit*, tërë kjo me skenarin e *Miloradit*, shefit të UDB-së, bëhet domethënie e shtresuar e dhunës dhe e torturës që ngjan për njerëzit e ambientit shqiptar.

Romani „Shtrojera” idenë e projekton nëpër disa vija rrëfimore, të cilat tërhiqen në fushëveprimin e personazheve. Vija e parë projektohet me thurjen e fatit të Hanës, që bëhet temë-mëdyshje ideore e artistike deri në mbarimin e lumtur të ëndrrës së saj për shkollimin dhe dashurinë. Ndërkaq, vija e dytë rrëfimore që përshkon romanin, ndërlidhet me rolin dhe misionin e drejtorit Agron Spahiu në ballafaqim me pushtetarët e sistemit ekzistues. Në vijën e tretë paraqitet prania e Sylë Bimbashit (kryetarit), i cili prej fillimi deri në fund bëhet simbol i së keqes dhe i dhunës në këtë roman.

Në rrafshin kritik, këto tri vija të mundshme rrëfimore shprehin kontrastin e një bote të përmbushur me dhembje, kënaqësi, dashuri, urrejtje, sakrificë, ngatërresë, moral, jetë. Romani i Nebil Durakut u jep zë në të njëjtën kohë gjendjeve të kundërta të personazheve duke vijëzuar botën e tyre të ndërlikuar emocionale, vetëdijen e formuar për të ndodhurat në realitetin ekzistues. Ideja e autorit mbështetet te psikologjia e karaktereve, te pikturimi i gjallë i ambientit, te qartësimi i idealeve jetësore. Pra, shkrimtari, duke i shqiptuar këto i veçon të pranishme në veprën e tij dhe bart procesin rrëfimor te tre protagonistët: Hana, Agron Spahiu, Sylë Bimbashi. Prej këndeje vendosen raportet midis karaktereve të tjera, ku secili ka rolin e vet.

2.b. Thurja e fatit përmes ngadhënjimit të dashurisë

Nëpër këto vija të shqiptimit rrëfimor, me prani tipizimi personazhesh, është e kuptueshme të mbizotërojë dëshmia a prania e segmentit politik në vepër. Siç u tha, në përcaktimin vijëzues të gjendjeve të brendshme shpirtërore të Hanës, që në fëmijëri i mbështillen në shpirt mëdyshja dhe frika për thurjen dhe shthurjen e fatit të saj për dijen dhe dashurinë.

Romani, duke i afruar gjendjet e jashtme, arrin të funksionalizojë historinë dhe legjendën në brendinë e kësaj proze. Kësisoj, historia bëhet dëshmi e vërtetë, e legjenda bartet si detaj i dëgjuar në gojshmërinë e personazheve.

Në këtë roman, fati i Hanës përdegetohet në përqsasje me fejesën e padëshiruar me Ahmetin, në shkollë, në takimet me drejtorin Agron Spahiu, në shkollimin e saj në qytet, në ballafaqimin shpirtëror me fatin e babait Ali, të cilin e kishin verbuar nga torturimet e mëdha të UDB në aksionin e armëve. Më tutje, pasojnë ndërgjegjësimi për ndërtimin e shkollës së re, njohja me gazetarin Ylli dhe kurorëzimi i dashurisë me të, si dhe prishja e fejesës me Ahmetin e deri te përcaktimi poetik se Ylli dhe Hana në fund dalin personazhe simbolizuese të kësaj vepre.

Me personazhin e Hanës, Nebil Duraku shfaq vendosmërinë e vajzës që të ballafaqohet me jetën e egër, ku baraspesha e vullnetit mund skamjen dhe vuajtjen, ngadhënjjen mbi gjendjet e improvizuara e të kurthuara. Në pikënisje romanore pra qëndron Hana e idealit jetësor, që mposht betejën me jetën. Kështu, figura e Hanës, e projektuar në këtë roman, dëfton mënyrën e të treguarit për t’anë, Aliun.

Gjithsesi, Aliu është personazh i tipizuar, i lidhur thellë me synimet dhe idealet kombëtare, njeri që lufton me shpirt errësirën dhe paditurinë duke dashur dritën dhe jetën e lumtur për fëmijën e vet. Duke portretuar Aliun, rrëfimtari jo një herë, shfaq praninë e dhunës në këtë roman duke sipërtheksuar tragjicitetin njerëzor si në tregimet e tmerrit.

Bota e zjarrtë e Hanës paraqet perspektivën dhe epërsinë e besimit të pamposhtur mbi anatemën, zakonet e mentalitetin primitiv. Figura e saj përfaqëson vajzën e dëlirë e pa paragjykime, të gatshme për t'u flijuar për idealin e dijës dhe për dashurinë e vetëzgjedhur. Në këtë rrjedhë, fati i saj është vendosur në qendër të romanit, prej nga shkallë-shkallë perceptohet fenomeni i jetës së shndërruar në art. Domethënë pikësynimi i saj vështrohet në gjendje varësie me ngjarjen kryesore dhe me personazhet e romanit, por që fundja ky pikësynim ndërlidhet edhe me emancipimin shpirtëror të gruas shqiptare, siç ngjet shumë herë në tematikën e romanit me prirje tradicionale.

2.c. Mbrojtja e idealit jetësor

Në këtë roman dritësimi për të ardhmen shenjohehet përmes personazhit të Agron Spahiut. Në kapitullin e dytë rrezaton kuptimisht ndërgjegjja e tij në mbrojtjen e shkollës shqipe përballë skenarëve çudibërës të ndalimit dhe të mbylljes së saj. Rrëfimtari, duke e vënë në veprim Agronin, arrin të funksionalizojë ngjarjen me shpalimin e ditarit të një mësuesi, në të cilin shpjegohen ndodhitë e së kaluarës që përkojnë me aktualitetin.

Në këtë pikë të ballafaqimit të personazheve, fabula degëzohet në dy kahe: në rrëfimin për Hanën dhe në rrëfimin për shkollën.

Shprehja e mendimit të lirë jepet përmes Agronit dhe del te figura e mësuesit Menduh Gashi, i cili ishte larguar nga procesi mësimor për shkak se në dhomën e tij ishin gjetur portretet e Skënderbeut, Naim Frashërit e Migjenit. Pra, këtu shenjohehet koha e diferencimit politik.

Duke i ballafaquar në dialogë Sylë Bimbashin me Agron Spahiun, autori përbrenda realitetit të një kohe, në një anë ka dhënë deformimin e njerëzve pushtetarë dhe, në anën tjetër, synimin për idealin e së ardhmes. Poenta përqendrohet në „zbulimin” e satirës së shkruar për Sylë Bimbashin. Dialogu i këtyre dy personazheve nxjerr edhe gjendje të tjera që karakterizojnë sprovimet e personazheve në rrafshin veprues.

Pa dyshim, me interes njohës është të theksohet raporti i Agronit me Aliun, që ka të bëjë me fatin e shkollës. Po kështu, zbërthimi i „çështjes” së Menduh Gashit, mësues i larguar nga puna për shkaqe politike, është një kapitull më vete. Në roman hasen edhe gjendje të tjera shpirtërore e njerëzore, që sqarohen përmes personazheve negative, siç janë Ramë mësuesi, Bedriu, i „besuari” i arsimit, mësuesja Mace e të tjerë.

Romani „Shtrojera”, duke funksionalizuar dramën shpirtërore dhe ekzistenciale të Agronit, njëkohësisht bën thurjen e idealit të tij jetësor. Nëpërmjet këtij personazhi sprovohet fati i jetës dhe i mendimit të lirë, shprehet një besim që karakterizon dashurinë dhe sakrificën për të ardhmen. Ky personazh idealit të vetëflijuar për çështje të dijës e të arsimimit, në thelb paraqet fatin e intelektualit me ndërgjegje të zgjuar që mbron qenien kombëtare nga shprishja dhe zhbërja.

Duke i sipërtheksuar faktet e romanit „Shtrojera”, del sheshit qëndresa vetjake e personazhit që merr domethënien e qëndresës për të mos pranuar psikologjinë e robotit. Rrëfimtari fuqizon praninë e Agronit me virtytin e pathyeshmërisë e të vetëdijshmërisë.

2.ç. Shtresimi i përmasës së dhunës

Prania vrasëse e egërsisë që lidhet me ideologjinë sunduese të sistemit, në vendosjen dhe zhvendosjen e gjendjeve e ngjarjesh konfliktore, mbizotëron te figura e Sylë Bimbashit. Ky personazh ngjan me njeriun djallëzor që, me intrigat e tij, shtyp vijimisht njerëzit e pafajshëm. Sylë Bimbashi është fytyrë negative e romanit, që kurdis gjendjet reale dhe dramatike, që shtyp fshatarësinë në forma të shumëfishta, posaçërisht me veprimtarinë e tij shkatërruese për mbylljen e shkollës shqipe dhe me endjet e tij të tmerrshme në aksionin e armëve.

Ironia e rrëfimit në një fragment që ndërlidhet me figurën e Migjenit, jepet kështu:

„Nuk di shumë për të. Po çka kam dëgjuar, ai është shkrimtar i Shqipërisë, i rrezikshëm për ne sa të thuash! Mundet, shumë lehtë të na bëjë farë lidhjesh politike me të, një ditë... tap: të sillet Migjeni nëpër jataqe të veta edhe në Kosjer? - thotë Sylë Bimbashi.”

Gjithsesi, është kjo një vetëdije e ulët dhe e shitur e personazhit që niset nga përmasa rrënuese për të shkatërruar moralin, dinjitetin kombëtarin e personaliteteve historike e kulturore. Me këtë personazh shqiptohet përmasa e dhunës në ambientin shqiptar. Këtë shikim të mundimit e të dhunës, autori përpiqet të na e jap sa më të plotë me një theksim të posaçëm të së ndodhurës konkrete në fshatin shqiptar brenda periudhës së caktuar historiko-shoqërore.

Ky kërkim që lidhet me tipizimin e figurës së Sylë Bimbashit, „bashkëjeton” me figurën udbiste të Miloradit, ku në format më të ashpra shtresohet përmasa e dhunës. Nisesos, autori sprovon të vërë thumbin mbi vetitë e njerëzve që i përkasin një psikologjie personale, ku e përditshmja e pushtimit të ndjenjave dhe mendimeve të tyre i atribuon gjendjet e dhembshme shoqërore. Rrëfimi për Sylë Bimbashin është rrëfim për të keqen dhe kobin, për vuajtjen dhe dhunën.

2.d. Veçoritë e përshkrimit

Romani „Shtrojera”, shquhet edhe për veçori të tjera tematiko-motivore e estetike, të cilat japin rrezatim të fortë kuptimor në rrafshin karakterizues e udhëzues. Gjatë ecurisë së rrëfimit të shkathët e plot detaje, në të hasen përshkrime me një fuqi perceptimi, që fanitet në kujtesën e rrëfimitarit:

„Sa e qetë e nisi dita jetën e saj mbi Mokën, shndriti pllaje e kreshta, ra në lugina dhe dalëngadalë avulloi brymën e bardhë e të kristaltë që e kishte lëshuar nata në Kosjer”.

Në hetimin e përshkrimeve të bukura e të realizuara, që ndihmojnë thurjen e ngjarjes, gjenden shembuj ilustrues që vetvetiu dëshmojnë për një arritje shkrimore në të rrëfyerit e saktë e figurativ:

„Lart, lart diku midis reve të shprishura, u dëgjuan krratjet e kojrilave të vonuar, të cilët, ashtu të rreshtuar, kërkonin rrugën e humbur”.

„I përkundur në djepin e fitores, Miloradin shpejt e zuri gjumi. Sylja pranë tij e ndjente veten si në shtrojerë, prej nga deri vonë, ashtu me sy të zgurdulluar, i përgjonte fishkëllimat e erërave dhe lehjet e qenve në fshat”.

Gjejmë këtu edhe dëshminë e të dhënës, kur del qartë vërtetësia e rrëfimit dhe shpjegohet thelbi e domethënia e romanit, pikëpamja e fshehur në botëkuptimin e personazhit, simbol i egërsisë dhe i së keqes kolektive.

Në romanin „Shtrojera”, shkallëzohen dromcat dhe peripecitë e gjalla individuale e shoqërore. Kësisoj, idetë që shqiptohen këtu, marrin funksion simbolizues midis së mirës e së keqes, midis drejtësisë e padrejtësisë, midis dhunës e lirisë, midis jetës e vdekjes.

Shkrimtari e ka forcuar dëshminë e kohës së përjetuar dhe reagimin intelektual ndaj përmasave të kësaj shturjeje, duke luftuar paralelisht censurën, zhbërjen, analfabetizmin dhe duke shtresuar pikëpamjet e drejta për traditën kulturore.

Në këtë mënyrë, vetëmbrojtja e identitetit shpirtëror e kombëtar e arsimimit dhe e dijes, ndër të tjera, dëfton për përmasën diturore të prozës së vizionit, edhe pse ndonjëherë baraspesha e rrëfimit aludon te efekti i „ideologjisë” së mishëruar në kuptimësinë e veprës tregimtare, veçan te tipologjia e personazheve në modelin tradicional bardhë-zi.

Romani „Shtrojera” është roman i një arti realist, që transponon artistikisht frymëmarrjen dhe ekzistencën e njeriut brenda një ambienti të caktuar, siç është fshati shqiptar i Drenicës, plot kundërthënie individuale e shoqërore. Është roman që shquhet për gjuhën e arrirë, stilin, figuracionin dhe sidomos për porosinë kuptimore e artistike.

3. Prozë e raporteve reale të ekzistencës

Dhengrënësit është një roman që për nga prirja krijuese heton botëvështrimin shumëkuptimor, të paraqitur midis pranisë së reformës agrare si detyrim për fshatarësinë, domethënë një përqafim i dhunshëm i jetës dhe ekzistencës së

imponuar nga të tjerët. Me artin e të treguarit, me rrëfimin dinamik, gjithashtu, paraqet praninë e personazheve, që i shquan, para së gjithash, koha dhe hapësira e veprimit në një ambient të mbushur me kundërthënie e gjendje deri në paskajshmëri e pakuptimësi.

Në romanin „Dhengrënësit” kallëzohet jeta shpirtërore e sociale në kundërvënien e personazheve. Më tutje, përkufizohet ambienti dhe bëmat e strukturuar në të kaluarën e një rrethi njerëzor. Raportet kuptimore të tekstit janë paravajtëse të gjendjeve në rrëfimin, përshkrimin, tipizimin, karakterizimin e ngjarjeve dhe të personazheve. Kështu, e kaluara dhe e ardhmja, thënë kritikisht, gjenden ndërmjet kategorive psikologjike e sociale të tregimtarisë së Nebil Durakut.

Në pikën e konkretizimit të romanit përkufizohen tema që kanë ndërlidhni të fortë me veçantinë e natyrës njerëzore përballë rendit që përmbledh rrafshin real të thurjes fabulative. Kështu, reforma agrare, çështja e kolonizimit, shpopullimi, xhandarmëria, problematika e shpërnguljes së shqiptarëve në Turqi, lufta, paraqitja e botës femërore, përmasa e ideologjizimit, ndër të tjera, bëhen temë - mëdyshje shkrimore, që me udhëzimin e tyre kuptimëson rrëfimin e prozës së këtij shkrimtari.

Romani „Dhengrënësit”, në punën e tipizimit të personazheve, kohën e projekton si mundësi të perceptimit të ngjarjeve kryesore duke e përkufizuar hapësirën si prani që „zhduket” në mashtrimin e personazheve. Në vijën e rrëfimit dendësohet prania e luftës midis drejtësisë e padrejtësisë, midis realitetit e ëndrrës, midis jetës e vdekjes.

Gjatë argumentimit kritik, mund të konstatohet se ky roman është i shkruar mbi detaje të shkëputura, ku në rrafshin e thëniesimit ndonjëherë ndodh këputja e qëllimshme e rrëfimit, që është në rrjedhë për t’u funksionalizuar ngjarja përmes rrëfimit të ri. Rrëfimtari i kësaj proze sikur „zbulon” rolin e personazhit që synon të mbishquajë prirjen e faktografisë në thelbin e romanit. Prandaj, shtresimet e këtilla të domethënies, ndonjëherë përkojnë me nivelin e gojshmërisë së bartur në prozë. Fryt i këtij modelimi është vepra si dëshmi e kohës.

Ndër veçoritë e kësaj proze është të treguarit real, mbase me tejdukshmëri, që vë në dukje imazherinë e natyrës shqiptare, ruralitetin e paraqitur nëpërmjet jetës baritore. Kjo përmasë rrëfimore është ndërtuar në monologët dhe dialogët e personazheve, me një veçanti në përshkrimin e detajeve e pamjeve të ngjyresës ambientale. Gjithashtu, në vegullimin e këtij realiteti jetësor dhe realiteti artistik, rrëfimtari përshkruan edhe elementin fetar që paraqitet me fanitje çudibërëse gjatë thurjes së dromcave moralizuese, që funksionalizohen në rrathët kuptimorë të këtij romani.

Mbi të gjitha, romani „Dhengrënësit” projekton dhe percepton ambientin dhe njerëzit e ndodhur në një gjendje shpirtërore, zgjidhja e së cilës varet nga situimi politik. Domethënia e veprimit dhe e shkakut del nga elemente rrezatuese të „ideologjisë”, që kanë pamundësuar shumë herë ndërgjegjësimin e qeniesisë së plotë shqiptare në kohë dhe gjatë historisë.

Kësisoj, Nebil Duraku si prozator, shenjon dhe „regjistron” në trurin e tij të ndodhurën në kushtet e një jete shoqërore të tejmbushur me gjendje të traumatizuara dhe dramatike. Për më tepër, filli i romanit e kap kujtesën të mbështjellë me figura shkatërruese, të cilat përbrenda trupit lëvizës të rrëfimit shkallëzojnë tragjikën dhe tragjicitetin e një etnikumi nëpër fazat e jetësimit të tij.

Romani „Dhengrënësit” i Nebil Durakut, përbëhet nga pamje të shumta vargëzore si gjithë proza e tij. Në formësimin e karaktereve, autori shqipton dokumentaritetin që forcohet e funksionalizohet në shtresat kuptimore të tekstit artistik. Shpalimi i çasteve jetësore, i rresës dhe i ekzistencës, bëhet me portretizimin letrar të personazheve. Nëpërmjet theksimit të përmasës psikologjike, esencialisht, nënvizohen idetë mbrojtëse që përsëriten në variante të ndryshme. Pikërisht me qëndrimin veprues ndaj realitetit, Nebil Duraku afron jetën bardhë-zi, me shëmbëllesat e imponuara, me ndërrimin e raporteve shoqërore e të marrëdhënieve individuale drejt vërtetësisë.

4. Midis iluzionit të djeshëm dhe vizioneve të sotme

Romani **Drenusha** i Nebil Durakut projekton kohën e bëmave në një pjesë të realitetit shqiptar duke skicuar e karakterizuar figurën e personazhit të Drenushës përbrenda dhembjes dhe shtypjes së dyfishtë, në vuajtje shpirtërore e flijime femërore.

Në rrafshin e tipizimit të ngjyrimin ambiental, rrafshnaltë e Moknës, Gurrat e Bardha dhe veçan Peja, bëhen hapësirë fushëveprimi në pikëpamjen tregimtare. Nëpërmjet ligjërimin anekdotik shtresohet rrëfimi në ndërlidhni të fortë shpirtërore midis *Drenushës* dhe *Helit*. Kësisoj, jeta në këtë roman pikëshikohet nga baza e tematizimit të të ndodhurave. Fillimisht projektohet ëndrra. Pastaj gjenden shembuj në jetë, që e adresojnë përmbajtjen e veprës. Nebil Duraku me anë pyetjesh vargëzore shtron fabulën duke tejtheksuar ndjenjën dhe ndjeshmërinë. Kësisoj, romani në vijën rrëfimore përmbledh një varg gjendjesh të shtresuara njëra mbi tjetrën.

Në secilën gjendje projektohen marrëdhëniet ndërmjet personazheve. E ndodhura mund të vijëzohet nëpër disa shkallë veprimi. *Sadikun*, pas vdekjes, e trashëgon djali i vetëm, Heli. Pastaj ndodh rrethimi i Deviçit, mbytja e fëmijëve, lufta, turqit, ngulitja e të gjallëve në hunj. E të tjerë. Tërë rrëfimi i ngjarjes bëhet në prapavështrim, ku rrëfimtari autorial pyet personazhet. Duke e sipërtheksuar figurën qendrore të romanit, siç është Drenusha, Nebil Duraku vë në veprim edhe një galeri tjetër të personazheve, që përbrenda niveleve të domethënies së rrëfimit paraqesin pikëpamje të arritshme në tipizim. Kësisoj, duke karakterizuar figurën e kalorësit zulmëmadh *Kurt Mani*, autori ka arritur të funksionalizojë përmasën e egërsisë, të djallëzisë dhe të cinizmit përbrenda shtresës kuptimore të veprës. Duke e vënë në veprim ligjërimin e proverbit popullor, Nebil Duraku ka arritur që ta

kuptimësojë rrjedhën e ngjarjes në raporte varësie ndërmjet personazheve. Në këtë vijë procedimi, monologu i Kurtit pas ndenjjes me *Xhabir beun* merr, pothuajse, përmasën kallëzimitare në periudhat e rrëfimit.

Në roman saktësohet gjithnjë mëdyshja e Helit si të shkojë në shtëpinë e *Dan Malësorakut* për të biseduar me Drenushën. Në thurjen e ngjarjes, autori, gjithashtu paraqet fatin e jetimit (Helit) përballë zakoneve e traditave të kohës. Në rrafshin shtjellues të ngjarjes, vajtja e Helit në shtëpinë e Drenushës, ka domethënien e zbulimit të dëshirës erotike përpara martesës. Natyrisht, teksti i Nebil Durakut, me renditjen paralele të ngjarjeve, degëzon rrëfimin dhe veprimin me veçantitë e vizionit të tij. Kështu, fshehtësia e dasmës, zbulohet atëherë kur *Aza* i tregon *Daklan Barutit* ditën e dasmës që deri atëherë mbahej e pashpallur. Kjo e dhënë, dëshmon ekzistencën e tragjikën dhe pastaj, nga rrjedhoja e përcaktuar, tërhiqen dy vija rrëfimore: rrëfimi për Drenushën dhe rrëfimi për Kurt Manin.

Fillimi i konfliktit projektohet me Daklanin si spiun që, si i tillë, i mban fjetet e veprimit në roman si me Helin, po ashtu edhe me Kurt Manin. Prandaj, Daklan Baruti gjendjen e jetës së njeriut e shqipton nëpërmjet tradhtisë, duke e thelluar botën e kundërshtisë. Në rrafshet e venerimit, dasma me „këngëtarët e paftuar”, dëfton ngjarjen dhe pikëshikimi i shkrimtarit përqendrohet te qerraxhiu i Daklanit, që u thotë këngëtarëve që ta këndojnë „këngën e zogut”, ku simbolikisht shqiptohet përshtkrimi i tradhtisë.

Mënyra e krijimit të gjendjes dhe të veprimit në këtë roman shkallëzohet në ambientin e ashpër, ku shkatërrohet lumturia e personazhit kryesor. Kësisoj, njerëzit e Kurt Manit e plaçkitin qerrën e nuses dhe i çarmatosin njerëzit e Helit. Këtu fillon të thuret drama e brendshme shpirtërore e Drenushës në raport me Kurt Manin. Do të thotë vijëzohen çastet e dhembjes e të vetmisë, të durimit e të shpresës. Derisa raporti i kundërshtisë në mes Kurtit dhe Drenushës vazhdon të rritet, në anën tjetër prania e grave të tij: *Zojës* dhe *Nifës* merr përmasa të tjera të veçorive morale. Tashti, motivimi i shkallës psikologjike krijon shprishjen, amoralitetin. Përshtkrimi është lidhur ngushtë me të ndodhurën. Derisa përtej murit tjetër Kurti përpiqet të dhunojë një vajzë, këndej Zoja, gruaja e tij, urdhëron rrogëtarin, Nezirin, që të zhvishet e të bëjë dashuri me të. Është kjo faqja e një realiteti të pabesueshëm që ngërthehet në rrjedhën romanore brenda një jete të shprishur njerëzore.

Ky perceptim i jetës dhe i ambientit projektohet e synohet te Drenusha, e cila tashmë ndien orë e çast vetminë dhe mallin për Helin. Ky shikim i dhembjes kurthohet pabesisht te Daklani, i cili në pritë e vret Kurtin përpara këmbëve të Helit. Pafajësia e Helit shndërrohet në proces gjyqësor dhe gjendja e tij shpirtërore bartet deri te vendburgimi në kullën e Sheremetit.

Në anën tjetër, në pikëshikimin karakterizues të ngjarjeve funksionalizohet detaji tjetër përmes vëllait të Kurtit, Ganiut, që mëton ta dhunojë Drenushën. Kështu, përballë një akti të tillë të dhunshëm, Drenusha zgjedh ikjen dhe vishet me rrobat e Kurtit tashmë të vrarë. Tani ajo për xhandarmërinë, pothuajse, është shndërruar në fantazmë. Pjesa tjetër e romanit është e mbushur me ngjarje, ku

lëvdohen trimëritë e Azem Bejtës e të Shotë Galicës, ku flitet për fatin e Helit në burg, për kolonizatorët, për përmbysjen e Daklanit në humnerë, për operacionin e Helit. E të tjerë.

Kështu, dalëngadalë, me praninë e efekteve, situimit sentimental të romanit, mënyra e krijimit të personazheve bëhet përmes pikëvështrimit psikologjik, ku mbizotëron edhe dashuria për njeriun dhe urrejtja për të. Nebil Duraku përbrenda rrëfimit të tij ka paraqitur ambientin dhe rrethin shoqëror në kundërthënie me njeriun, i cili pret se ç'po ndodh brenda vetvetes dhe jashtë tij. Prandaj, megjithëkëtë, romani „Drenusha” përfundimisht, përmes një përjetësimi të tillë të ngjarjes, përqafon „vijën ideologjike”, midis dyshimit dhe besimit. Krijimi i ambientit, i personazheve të ndryshme, i gjendjeve konfliktore etj., bëhet në funksion të kërkimit të jetës e të vetëdijes për vetveten në gjerësinë dhe në thellësinë e shqetësimeve shpirtërore e shoqërore.

Në këtë mënyrë, duke prekur shenjat e realitetit dhe të përfytyrimit, autori ka arritur të shtresojë ide krijuese dhe kërkesa jetësore që për nga çfarësia e ndërtimit përplotësohen me njëra-tjetrën. Fillimi dhe mbarimi i personazheve i nënshtrohen një kodi etik prej zmadhimit heroik deri te perceptimi grotesk i jetës.

Romani „Drenusha” i Nebil Durakut, kap domethënien e një jete të përdegzuar përmes artit letrar në lidhshmëri me ngjarjet si dëshmi të kohës. Udhëtimi shpirtëror i personazheve i nënshtrohet vetëdijes njerëzore që përcakton faktet historike. Është e qartë mënyra e perceptimit dhe vizioni i qartësuar i shkrimtarit në portretizimin e personazheve dhe në karakterizimin e ambientit.

Le të thuhet në nënvizimin e këtyre veçorive se deri në kapitullin e fundit romani ka rrjedhë joshëse, të funksionalizuar përmes dhembjes shpirtërore të personazhit të Drenushës, ndërkaq në fund merr „forcë” tjetër, duke i përfillur konvencat si qëllim shkrimor në ide dhe përmbajtje.

5. Ndërtimi i vetmisë tragjike

Nebil Duraku do të shkruajë romanin **I treturi** (botuar në vazhdime në revistën shqipe „Koha” të Podgoricës), duke synuar të prekë temën e mërgimit nga një pozicion i përgjegjësimit kritik. Tema këtu është shtresuar në vizionin e një personazhi që herë rrëfen në vetën e parë të njëjësit, herë në vetë e tretë të shumësit, madje duke tërhequr veçantinë e rrëfimit edhe në raportin e rrëfimitarit. Prandaj, natyrshmëria e rrëfimit bartet në drejtimin personazh - rrëfimitar-ngjarje e rrëfyerporosi.

Në romanin „I treturi”, fund e krye, bëhet përshkrimi i jetës së *Malush Ukshinit* në ambiente të ndryshme, në thurje dhe shthurje të hapësirës së konceptuar për vetënjohje. Mënyra e shpalimit të kujtimeve, ku atmosfera e jetës është pëlçitëse, bëhet përmes letrave, letërkëmbimit, pra adresimit të tyre nga ana e Malushit dërguar *Adelinës*.

Drama shpirtërore jepet me kontrastet e jashtme të ambientit të imponuar, ku vezullon fati i njeriut në prag të luftës, si fat i një të shpërnguluri e të përumburi në dheun e huaj, që, me gjithë peripecitë e shumta të jetës, nuk arrin të kthehet i gjallë në atdheun e tij.

Fundi që shtjellohet përmes vdekjes së Malush Ukshinit, është tragjik.

Tashti letrat e „zbuluara”, si kujtime të renditura me ëndrra për jetën, me gëzimet, me hidhërimet, me pikëllimet, me vuajtjet e ndryshme, të adresuara për Linën, vajzën e mallit, kompozohen me ngjyime të forta dhembjesore gjatë përshkrimit të gjendjeve shpirtërore e të flijimeve të Malush Ukshinit.

Romani „I treturi”, pikënisjen dhe thelbin e rrëfimit i mbështet pikërisht te dërgimi i njeriut nëpër kampet e përqendrimit, tek ato pamje rrëqethëse, të vijëzuara në botëperceptimin e rrëfimtari. Duke i veneruar këto imazhe trishtuese, rrëfimtari „shpërbën” fate njerëzish të ndryshëm, gjithsesi, fate të tragjicitetit me pasoja të ndjeshme e të rënda shpirtërore e morale. Kësisoj, duke i adresuar letra Adelinës, rrëfimtari në prapashikim i përshkruan ngjarjet të ngulitura me porosi poetike gjatë përshkrimit të jashtëm të realitetit. Ky veprim artistik, doemos shtreson përcaktimin psikik në vetminë e ndërtuar tragjike të personazhit Malush Ukshini.

5.a. Rrëfimi për fatin e njeriut

Romani „I treturi” është tërësi që rrëfen për mërgimin, për fatin e njeriut, për botën mitologjike, për vullnetin, besimin, dashurinë për jetën. Nebil Duraku, duke e forcuar në rrafshin fabulativ intrigën për udhëtimin e personazhit, ndër të tjera, ka arritur të përfytyrojë e të shfytyrojë ecejaket e njeriut të shkëputur nga trualli i vet. Krejt domethënia e romanit me format shprehjese është ndërlidhur te gjerësia dhe thellësia e paraqitjes së fatit njerëzor.

Duke i shpaluar peripecitë e Malush Ukshinit, rrëfimtari, përmes lidhshmërisë së ngjarjeve me letra dërguar *Linës*, në mënyrë të qartë lirike, ndër të tjera, ka bërë ndërlidhjinë dytësore të ambienteve: mërgim-atdhe. Kështu që, në këtë rrafsh të karakterizimit moral, social, psikologjik të personazhit, mbizotëron ndjenja e kuptimësisë së këtij „përfaqimi” të dhunshëm e të dashur njëkohësisht, që zatetet në botëperceptimin dhe botëndijimin e personazhit, shumë herë me porosi të kapërcyeshme.

Romani „I treturi”, përnga mënyra e shkrimit, qëndron në pozicionin rrëfimor midis vetës së parë të njëjësit dhe vetës së tretë të shumës. Në letrat për Linën, rrjedhimisht, del sheshit gjedhja e romanit - ditar. Gjatë ndërtimit të ideve krijuese dhe shtresimit të ngjarjeve, romani ka kthesa rrëfimore.

E rëndësishme për modelin rrëfimtari të kësaj proze të Nebil Durakut, është veçantia e rrëfimit. Në njërin anë mbizotëron vija e procedimit, e cila tërhiqet në diagonalen e gjendjeve intime të personazhit Malush Ukshini në raport me *Nurijen*, që shndërrohet në përjetim përvëlitar me vendlindjen, sepse, dëfton

kryepersonazhi: „Nurija... ma nxirrte gjumin dhe më shpëtonte nga rrëfimet e mëdha që kisha përjetuar në Mathauzen”, dhe në anën tjetër, shpalohej kujtimi dashuror me Natalinë në raportet e gjalla dhe ëndërrimtare që vezullojnë realitetin jetësor në mërgim.

Në këtë mënyrë, përzierja e realiteteve merr karakter të bashkekzistimit të formave të qeniesisë në kohë-hapësirën e imagjinuar e të ndodhur. Prandaj, artifakti, domethënë krijimi artistik, bëhet dëshmi e shqiptimit të një gjendjeje nëpër rrafshet e dëshpërimit e të pikëllimit, por edhe të shpresës e të lumturisë. Ky, në të vërtetë, është një kontrast i formësuar me porosinë e dendësuar në veçoritë tregimtare dhe tematiko-motivore të prozës së autorit.

Romani „I treturi”, nisesos, percepton rrugëdaljen nga një gjendje të ndërtimeve humbëse. Romani, po kështu, vijëzon rrugëdaljen shpirtërore përmes motivit të pritjes së njeriut në vendlindjen e tij. Mirëpo, në vend të gëzimit, strukturohet lajtmotivi i vdekjes. Vdekja bëhet zgjidhje kryesore e rrëfimit.

Pra, në vend të trupit e frymës së gjallë të njeriut, valixheja bëhet ironikisht rregull tematik i rrëfimit që e kumton mbarimin e jetës, vdekjen.

Fjala rrëfimore kallëzimore: „Urdhëroni, kjo është valixhja e tij”, kësisoj, e shpreh raportin e vdekjesimit që bëhet mundësi e zbulimit të dhembjes për njeriun që merr rrugën për të dhënë shpirtin në atdheun e vet.

Romani „I treturi”, si vepër tregimtare, përmbledh edhe skena e detaje të tjera, në të cilat pohohet jeta ushtarake, përshkrimi në anije, fati i Baki Zhegovcit, rrëfimi për zezakun Bocman, përgjithësimet artistike që shprehen me praninë figurore të shkrimtarit holandez, tashti si personazh i paemërtuar, paraqitja vepruese e Selvjes. E të tjerë.

Duke trajtuar temën e mërgimit dhe përmbajtjen e shkrirë me proceset psikologjike në kampet e përqendrimit, kryekëput, me përmasën e dhembjes vetjake të një personazhi, Nebil Duraku, pa dyshim, e ka theksuar ndjeshëm përbërësin e dhembjes për fatin e njeriut nëpër shtegtimin jetë-vdekje. Ky problem, tashmë është zbërthyer nga nënteksti moral e psikologjik nëpër shtresat kuptimore të tekstit rrëfimor. Mirëpo, thënë ndryshe, lajtmotivi i vdekjes, i shenjuar në fillim, bëhet e dhënë themelore e domethënies në përfundimin e veprës duke grumbulluar disa gjendje që sugjerojnë mundësinë për komunikim me një jetë njerëzore midis vuajtjes e lumturisë.

Romani „I treturi” kap ngjarje të ndodhura në kampet famëkeqe të tmerrit njerëzor. „Fushëvdekja jonë quhet Mathauzen, - thotë Malush Ukshini.” Zbërthimi i jetë-vdekjes bëhet me ndjenjën e kryepersonazhit si në ëndërr, si në njëmendësi. Në kuptimin artistik, „I treturi” është roman që shquhet për vetëdijësimin shkrimor nga thelbi i rrëfimit, pa gjendje të dramatizuara e konfliktore, por vetëm me përshkrimin e detajizuar e joshës, që në një masë u mungon ngjeshuria artistike.

Në vizionin e shkrimtarit rrapëllon koha e dhembjes dhe e absurdit për të shkallëzuar gjendjen shpirtërore, morale, psikologjike, sociale të njeriut të „tretur” në botën e huaj.

6. Kohëdhembja shpirtërore e njerëzore

Romani **Murana**, që sipas përcaktimit të llojit të tipeve epike përdegëzon elementet fabulative e tematike të novelës, është tekst rrëfimor që shtreson përmasën e prozës me pamje të vazhdueshme e të ndërlidhura mbi njëra-tjetrën.

Duke i zbërthyer gjendjet dhe personazhet e romanit, mund të pohohet se vija e karakterizimit do të konceptohet e do të ndërtohet me mundësi interpretimi kritik, pos të tjerash, në këtë mënyrë: Fillimisht bëhet paraqitja e ambientit, siç është qyteti, Hamburgu. Më tutje, formësohet raporti i personazheve *Magdalena - Agroni*. Vjen koha e ankthit si imazh i ngulitur i ëndrrës. Portretizohet *Bernardi*, bashkëshorti i Magdalenës. Në vijën e shkakësisë së të ndodhurave paraqiten prindërit e Magdalenës, Hermani dhe Valentina, të cilët kundërshtojnë urdhrin nazist, po pastaj vriten. Në shtresimin e ndodhisë, skicohet jeta e Magdalenës në jetimore, dhe në rritje detyrimi shpirtëror për t'u marrë me shkrime.

Në rrafshin e perceptimit të ngjarjeve, tashti ndërron ngjyrimi ambiental me vendosjen dhe zhvendosjen e ngjarjeve e të veprimeve në një ambient tjetër, ku mbizotëron përshkrimi për kështjellën e Ulqinit.

Në pikën përfytyruese të tekstit artistik nyjëtohet raporti Bernardi - Magdalena si situatë më vete. Ndodh pastaj rrëfimi për rrëfimin e major Vilit, me letrën lamtumirëse, vetëvrasjen, pushkatimin. Si detaj i posaçëm vijëzohet „rasti” i Magdalenës, që e shpëton Agronin nga mbytja në det. Rrëfimtari mbështet pikëshikimin, gjithashtu, te Xha Meta, i cili rrëfen për Vilin dhe ngjarjen e vrasjes së kurdisur e me paramendim.

Domethënë, skicimi i ngjarjeve bëhet në rrjedhë veprimesh të shtresuara me futje në veprim monologësh e dialogësh të personazheve, që tejshquajnë paralelizmin e ndodhisë së rrëfyer.

6.a. Shkallëzimi i përjetimeve përbrenda gjendjes moralizuese

Romani „Murana” vendos baraspeshën e ngjarjes te çastet dhe përjetimet që e prodhojnë gjendjen moralizuese e psikologjike. Klithja e Bernardit nga veranda e hotelit: „se të gjithë këta njerëz u shndërruan në uniforma”, thotë shumë për funksionalitetin simbolizues të veprës tregimtare.

Në vijën rrëfimore realiste, gjithashtu, prodhohen edhe gjendje të tjera të ndërlikuara që kanë aftësinë krijuese për t'i zgjeruar konceptet e autorit përkitazi me problemet e shtresuara në rrëfimtarinë e tij. Kësisoj portretizohet edhe vejusha Mrikë, kur i shfaqet befas hija e Zukos së saj të ndjerë. Më tutje, bëhet përfytyrimi dhe shfytyrimi i vizioneve dhe ndodhive të Bernardit në hotel, sikundër që rritet përmasa e neverisë së Magdalenës për gjestet e tij.

Pjesa ose kapitulli i gjashtë i romanit zberthen të ndodhurën me përshkrimin në hotel, me përqasjet e Nardit: „M’i lësho në dhomë njerëzit e magjive tua”, duke funksionalizuar, sidomos figurën e Bernardit me kujtimet e tij si ushtar nazist, me valëvitjen shpirtërore në kujtesën plot fantazma, hije, marshe, telefonata...

Romani „Murana”, në përmasën artistike, thëllon raportin e ëndrrës me zhgënjendrrën, të përfytyrimit e të shfytyrimit midis Agronit e Magdalenës, një vijë dashurore si përmasë joshëse e këtij teksti artistik. Gjendja konfliktore paraqitet nga fatkeqësia e papritur në hotel, kur Bernardi goditet nga një vallëzues që kërkonte Magdalenën për vallëzim. Mirëpo, raporti përfytyrim-shfytyrim bartet te Mrika, e veshur me rroba të zeza, që është gruaja e Zukos së vrarë, e cila e godet Bernardin në kokë.

Gjatë mbarështrimit të ndodhive vargëzore pëlçet vërtetësia artistike kur „zbulohet” se Bernardi kishte pushkatuar Vilin dhe pastaj ndodh çmendja e Bernardit. Kapitulli i nëntë është zberthim i ngjarjeve në një proces pikërisht të afrueshëm shpirtëror e intim midis Agronit e Magdalenës.

Romani „Murana” është një prurje artistike me dokumentim të jetës reale në rrëfim. Në rrafshin problematizues, gjurmohet e fshehta e jetës, ndonjëherë edhe me pikëshikime të realizimit magjik, sidomos kur në mjeshtërinë e të treguarit përfytyrohet prania e hijeve dhe fantazmave. Nebil Duraku në veprën e tij „kallëzon” trininë: jetë, dashuri, vdekje - duke prodhuar shkrimin rrëfimor me veçoritë që mëtojnë ta përjetësojnë rrëfimin e shtruar për mundimet e njeriut.

Çështja themelore e romanit mbetet dëshira për të „gjurmuar” jetën në ambiente kundërthënëse plot trauma e psikoza. Edhe kategoritë estetike, e bukura dhe e shëmtuara etj., dalin të ndërthurura në shkallën e njohjes e të gjykim-vlerësimit. Kësisoj, romani „Murana” është roman mbi pasojat e luftës. Ngjarja, ndodhitë dhe pamjet ndërlidhen kuptimisht me tragjeditë jetësore të njerëzve. Më në fund, enigma nuk zgjidhet edhe kur përfillet karakterizimi i personazheve „agresive” apo herën tjetër kur forcohet botëkuptimi i ri ndaj jetës. Autori e shqipton, detyrimisht, përmasën psikologjike të njerëzve duke e tejtheksuar frikën dhe dyshimin brenda moralit e dashurisë.

Romani „Murana”, me brendinë e vet, shfaq kontrastin e një jete plot ankth e neveri, me dinamikë të natyrshme të ngjarjeve që mbindërtohen njëra mbi tjetrën. Nëpërmjet personazhit të Magdalenës paraqitet fati i një familjeje të shthurur në kohën e krizave të mëdha sociale, politike e kombëtare. Rrjedha e rrëfimit mundohet të vërë lidhshmërinë tematiko-motivore e ideore, mirëpo romani më shumë shndërrohet në përfytyrim ngjarjesh sesa në realizimin e përmbajtjes sipas koncepteve të njohura të prozës. Veçanërisht është e tipizuar figura e Bernardit përbrenda polarizimit të gjendjeve me Magdalenën ose në raportin e funksionalizimit të fajit, në zbulimin e krimit. Ndërkaq, Agroni, duke njohur lidhjet e ftohta shpirtërore të Magdalenës me Bernardin, e „fut” shpirtin e tij në intimitetin e kërkuar jetësor e dashuror. Personazhet e tjera thurin fatin e tyre ndërmjet dëshpërimit e çasteve lumturore.

Në pikëvështrimin e romanit „Murana”, ëndrra, pothuajse, bëhet jetë, e jeta shndërrohet prapë në ëndërr. Dhënie-marrja e temave mbizotëruese në veprë ndonjëherë kalon në përlajthitjen poetike si tejdukshmëri, mungesë ngjeshurie, klishezëm apo utopi krijuese. Autori i „prek” temat e ndjeshme me ambientin e tyre të jashtëm e të brendshëm, duke thelluar edhe kuptimin e kundërvënies së personazheve.

Romani „Murana” është një përpjekje krijuese, e papërfunduar si ide e realizim artistik; në të thuret e shturet njëkohësisht drama shpirtërore e personazheve e rrezatuar me kontrastimet çudibërëse.

7. Shtresimi satirik i tekstit rrëfimor

Në kuptimin e parë *egjra* ka domethënien e barit të keq, që rritet dhe që është i dëmshëm për bimë e për njeriun. Kësisoj, në romanin e fundit të Nebil Durakut shtresimi i tij merr rolin karakterizues duke dhënë një tekst artistik e simbolik me përcaktueshmëri satirike.

Në romanin **Egjra**, pra, shkrimtari ka paraqitur gjendje të neveritshme, me imazhe groteske, me përshkrime ironizuese tragjikomike, gjendje të zhvilluara deri në fund e të këputura përgjysmë, që mishërojnë botën e personazheve, kundërthëniet individuale e sociale të një shoqërie, që e përthekojnë ideologji të ndryshme.

Edhe në këtë tip proze, sikundër edhe në romane të tjera të këtij autori, fillimisht skicohet ambienti që bëhet, pothuajse, model i pashmangshëm, kësaj radhe, Gjyteti. Në roman skicohen qëndrime dhe botëkuptime të ndryshme që lidhen me veprime konkrete të personazheve. Karakteret e romanit vështrohen me dashurinë dhe dhembjen e tyre, ku shtresohet veprimi dhe motivimi i veprës.

Autori vazhdon t’i konceptojë pikat kulmore në shtresimin e ngjarjeve duke kërkuar bërësin e domosdoshëm të nxitjes së intrigës fabulative, që ndërthur fate njerëzish me dramaticitet të së ndodhurës. Romani shenjon kohën e kundërthënieve në një lëvizje rrethore të ballëpërballshme, që e ruan intensitetin. Kësisoj, romani kërkon mundësinë për vazhdimin e ekzistencës së njeriut.

7.a. Funkzioni emërtues i personazheve

Romani „Egjra” synon të bëjë kërkimin e një bote dhe të një jete me personazhe të ndërhuara në rrafshin satirik e ironizues. Emërtimi i tyre i qëllimshëm merr simbolikën dhe atributin e caktuar në shpjegimin e ngjarjes kryesore, prej nga lëvizin veprues të tjerë gjatë rrjedhës fabulative.

Personazhet e romanit „Egjra” janë: *Xha Kokorri, Bleta, Korbi, Gverri, Lythi, Mulla Zeku, Erika, Helga*, dhe personazhe të tjera me attribute nënçmuese: Qefini,

Takrraçi, Kuqoi, Shegoi, Xekroi, Dragoi, Hakubeti, Letraku, Kuqesha, Bardhana, që prej të cilëve përkasin botës shtazore, po edhe personazhe të tjera të formësimit tjetër veçues, siç janë: Psherëtima, Cukla, teto Bryma e të tjerë.

Procesi krijues i Nebil Durakut mbështetet te konflikti individual dhe shoqëror i karaktereve të paraqitura në vepër. Kështu, përmes funksionit emërtues të personazheve, autori mëton t'i bashkojë vijat e shkapërderdhura të ngjarjeve për të gjetur thelbin e veprës nëpërmjet fabulës së shkallëzuar. Pra, tema, materiali jetësor e letrar i romanit brenda kodit rrëfimor, shenjon faktin e gjurmimit të një jete me detaje skenike.

Në problematikën e mbarështrimit të ngjarjes, ky emërtim i personazheve, nga raporti ironik e ironizues, bëhet tipar dallues i veprës. Nyjëtimi nuk i përket botës së heshtur apo vetëm përshkrimit, por intensifikimit të gjendjeve të thella njerëzore, botëkuptimit të tyre në kërkimin e fatit në kohën e tejmbushur plot ndeje, trauma, psikoze, drama shpirtërore individuale. Autori, gjithandej bën përpjekje krijuese që „t'i dokumentojë” fshehtësitë e jetës sociale e shpirtërore në raporte personazhesh.

Romani „Egjra” prek pika kulmore dhe dramatike në rrëfim, - futjen në veprim të dialogut Lythi-Korbi, kur bëhet përshkrimi i fatit të tyre dhe jeta në mërgim.

Në përshkrimin e gjendjeve të tendosura mbizotëron shturja e dromcave jetësore në tipizimin e Mulla Zekiut (Hoxhë Qefinit), gruas së tij, Pocerkes, dhe djalit të tij, Shegoit. Pra, përmasa e tipizimit është humoristike.

Në tipizimin e veçorive të personazhit dallohet figura e Xha Kokorrit, i cili i kishte verbuar sytë si bombahedhës. Autori paraqet edhe ideologjinë e tij në grupëzim vijash, ngjarjesh, personazhesh përbrenda shkallës njohëse të një utopie shoqërore. Kësisoj, në kapitullin e nëntë të romanit përdegëzohet shtresa rrëfimore me paraqitjen e sëmundjes së Xha Kokorrit, njeriut që kishte pasur vetëm vdekje në familjen e tij. Romani vijëzon realitetin e thellë social me zhvendosje të atmosferës, siç ngjet detaji i funksionalizimit të pamjeve rrëqethëse, të ngulitura në ndërrijen e rrëfimitarit: „Në qytet do të vdesin njerëzit nga murtaja”. Pamja tjetër shpërthen në tipizimin e sëmundjes që bëhet me ndërrime të papritura të gjendjeve, ku thuret ironia, revolta, madje pamja neveritëse: „minjtë e mbyllur në kuvli i kafshonin mishin njëri-tjetrit”, që dëfton për shkak-pasojat e sëmundjes së paraqitur në njerëzit e një ambienti.

Në roman gjendjet dhe ngjarjet gërshetohen në vijën sociale dhe ekzistenciale, përmbledhin kohë-hapësirën e tejmbushur me përjetime dramatike të veprimit. Kështu, pra, subjekti i veprës mbështetet kryesisht në skicimin e figurës së Korbit, si një legjendë e dhimbshme, e strukturuar në rrjedhën romanore.

Në romanin „Egjra” ndihet shpërthimi shpirtëror, i vijëzuar përmes personazhit të Korbit. Atributi i tij dëfton mesazhin e së keqes. Korbi paraqet vijën e tragjicitetit jetësor në rrjedhën romanore.

Duke vijëzuar figurën e tij, Nebil Duraku ka arritur ta sheshojë botën e personazheve të tjera nga raporti i harmonisë dhe çharmonisë.

Dialogët kallëzimitarë midis Korbit e Erikës dhe shoqërueses Helga, dëftojnë për pasojat tragjike të mërgimit që kishte ndikuar në jetën shqiptare.

Ngjarja e këtij romani është zhvilluar në dy rrafshë tematike: përshkrimi i Gjytetit në pritjen për dasmën e Korbit me Erikën dhe përmasa e mërgimit, e nyjëtuar me fatin e Korbit. Autori ka përshkruar mrekullisht vetminë dhe ndrydhjen tragjike të ndjenjave të Korbit, fatin e tij të hidhur dhe gëzimin e tij të neveritur, që ngjet me përfytyrimin dhe shpërfytyrimin e vdekjes. Tërë porosia dhe ideja e tekstit rrëfimor bartet te tradhtia, tek akti i krimit, te vrasja, te rikthimi i dashurisë në xhelozë.

Edhe pse romani ka këputje të fillit rrëfimor gjatë thurjes së fatit të Korbit, te kjo figurë karakterizimi i veprimit „zbulon” intrigën nga raporti i Korbit me Erikën dhe Helgën. Gjithashtu, në dialogët dhe monologët e personazheve, përfytyrohet edhe Psherëtima, e fejuara e Korbit, në raporte të tronditura të jetës. Personazhet e tjera të shumta të këtij romani janë të lidhura me përshkrimin e fatit të Korbit dhe me zërthimin e mëdyshjeve që i përkasin botës shpirtërore të Xha Kokorrit.

Kështu, natyrshmëria e rrëfimit „prek” edhe dëshirën, frikën, dashurinë dhe vuajtjen nëpër etapa ngjarjesh. Synimet e Korbit flasin për idealin e shpërthyer të dashurisë që përfundon me mashtrim, pabesi, kotësi veprimi e realizimi. Rrëfimtari flet për rrugën e gabuar të personazhit, për shprishjen e qenies së tij shpirtërore, për mëdyshjet mendore, për vetëmashtrimin.

7.b. Përfytyrimi dhe shpërfytyrimi i të ndodhurave

Me vijën e shqiptimit të ngjarjes mërgim-atdhe nga raporti i rrëfyesit që i njofton gjendjet shpirtërore të Korbit, në njërin anë, dhe përmes motivit të pritjes se ç’po ndodh me ngjarjet vijuese, në anën tjetër, autori shtreson përcaktimin e një rrëfimi paralel të ngjarjeve, në dy kahe, në dy forma të kundërshtisë, me ambientim dytësor të personazheve.

Poenta e romanit përqendrohet te procesi mendor, tek akti i krimit. Përjetimi i gjendjes zërthehet në shtresimin e ndodhisë. Shprishet ëndrra dhe iluzioni për jetën e lumtur e të vërtetë në mërgim, dhe rumbullakësohet koha e përjetuar e veprës përmes së vërtetës jetësore, që mëton të bëhet e vërtetë artistike. Aty edhe pëlçet ironia: dasma pa nuse, qëllimi i dashurisë, i martesës së shndërruar në kob, në vdekje. Kësisoj, skena e Korbit me Erikën e vdekur në duar, vijëzon përfundimin e një jete njerëzore. Kjo është përmasa dhembjesore dhe tragjike e mërgimit.

Ndërkaq, duke i transponuar ngjarjet në vendlindje, rrëfimtari që shkruan fatin e Korbit, dëshminë e shpjegon përmes personazhit të Bletës: „Xha Kokorrit i qajnë dasmorët në spital. Jo, e ka zënë egjra.” Këtu del kuptimësia e veprës tregimtare, madje edhe me përcaktimin tjetër të shkakësisë së ngjarjes që, siç thotë narratori: „dikush e ka përzier miellin në kohë dasme”.

Romani, pothuajse, është i strukturuar me një tipologji pamjesh, gjendjesh, veprimesh. Domethënia e tij, rrjedhimisht, bazohet te mentaliteti, karakteri, psikologjia e personazheve. Format e rrëfimit gjithnjë lëvizin nga krahu i konfliktit në vepër, me se vetvetiu imponohet shprehja prolikse, e zatetur në kundërthëniet e brendshme të veprës, aty ku prehen copëza kujtimesh të renditura me qëllim krijues letrar.

Romani „Egjra”, ndër të tjera, zberthen botën e brendshme të karaktereve në gjendje konfliktore, me kundërthënie sociale, psikologjike, morale, shpirtërore përbrenda dy realiteteve, në mërgim dhe në vendlindje, për të shprehur brengat dhe synimet, realen dhe imagjinatën e autorit.

Në roman projektohet dëshira për fillimin e jetës së lumtur, por realizohet kundërthënia për përfundimin e saj nga vuajtja dhe mërgimi. Romani qëndron midis këndit moralist e këndit idealist të pikëvrojtimit të gjendjes. Në frymën e realizimit të ideve del sheshit fatkeqësia me biografinë e dhembjes, të ndërtuar si imazh dhe mesazh.

Në rrafshin e tregimtarisë, ky tip shkrimi në letërsinë shqipe përmbush dhe sintetizon çfarësinë tematiko-motivore të prozës satirike e humoristike, me ambicie gjurmimi nga tipologjia e personazheve sipas fushëveprimit të tyre dhe attributeve përcaktuese. Depërtimi në thelbin e romanit, receptohet me ndëshkimin e vetvetes (Korbi), me gjendjet dhe imazhet përfytyruese e shpërfytyruese të të ndodhurave që „flasin” alegorikisht për dashurinë dhe vdekjen.

Rrjedhimisht, romani „Egjra” nyjëton kuptime dhe ide që në procesin e të treguarit „shpjegojnë” gjendje njerëzish në ambiente të ndryshme, rrethana që pranohen dhe prapësohen në subjektivitetin e rrëfimitarit.

Pikësynimi e shenjon njësinë hapësinore-kohore, të kapërthurur në sistemet tematike, prej nga rrëfimtari i vështron nyjat e jetës e të perspektivës njerëzore në funksione simbolizuese. Romani shenjon edhe kundërvënien e personazheve me fuqinë perceptuese të motiveve të vargëzuara në kuadrin e pamjeve, prej nga hetohet vizioni i vepruesve, prej idesë deri te realizimi poetik.

8. Tregimet që dëftojnë ballafaqimin me jetën

Në vijim të konstatimit duhet thënë se Nebil Duraku ka botuar edhe një libër me tregime, që shquhet për efektin komunikativ dhe veçantinë e rrëfimit.

Vëllimi tregimor **Kobi**, sajohet nga katërmbëdhjetë tregime. Mendimet dhe ndjenjat e personazheve kur komunikojnë me gjuhën artistike, me forcën e gjykimit e të veprimit, dhe kur fantazia përthekon realitetin me laryshinë e vegimeve të çastit e të jetës.

Tregimtaria e Nebil Durakut ka diçka përrallore në mënyrën e ligjërit, ku rrëfimtari „shpirtëzon” sendet dhe karakteret përbrenda kohëpërjetimit. Tregimet e këtij vëllimi janë: „Kënga e një të eturi”, „Gremina”, „Shpuza e cigares”,

„Kërraba”, „Zjarri i Çupëlinës”, „Vraga”, „Ashensori i lartësive”, „I treturi në shkretëtirë”, „Morthi”, „Rruga Abanoz”, „Rrapëllima në shkallë”, „Mulliri me pus”, „Nusja” dhe „Cergarët”.

Në këto tregime përsiaten ngjarjet dhe të ndodhurat në veten e parë njëjës, domethënë pozicioni i rrëfyesit, pothuajse, bëhet nga pikëshikimi i rrëfimtari autorial. Baza e rrëfimit të tillë mbështetet te përmasa hapësinoro-kohore e prozës, përmasë që e zotëron fatin e njeriut të rëndomtë, i cili ballafaqohet orë e çast me befasishtë e fshehta të jetës. Sikur në këto tregime shenjohej shumë elementi ideologjik („Kënga e një të eturi”, „Shpuza e cigares” dhe „Kërraba”), pas ndonjë mesloje në procesin rrëfimor, ku me çdo kusht kërkohen porosia dhe përfundimi a tipizimi i gjendjeve në të mirë të idesë rrezatuese.

Kështu, rrafshohen kuptimet që mëtojnë të jenë domosdoshmërisht paravajtëse të ngjarjeve vijuese.

Nebil Duraku, që njihet kryesisht si autor i romaneve dhe që e shquajnë zëshmëria e njohjes së realitetit, prania e faktografisë apo dëshmia e ngjarjeve të ndodhura, edhe në këto tregime nuk ikën nga shpjegimi i domethënies së fatit të personazheve duke e përcaktuar vetëdijen e tij krijuese nga „shprushja” e gjendjeve prekëse dhe të ndjeshme për njeriun dhe rrethin shoqëror.

Fjala vjen, në tregimin **Gremina**, që mban datëshkrimin 1958, autori, duke i rrëfyer ngjarjet në veten e parë njëjës, shpalos dromcat jetësore për të shenjuar qëllimin letrar nga mbamendja e së ndodhurës. Fjalja rrëfimore që shpëtohet në tekst përmes personazhit të *Dritës*: „Im vëlla e kishte shpëtuar një vogëlushe nga kthetrat e vdekjes”, e shkëputur nga tërësia e porosisë, flet për bamirësinë e njeriut për fëmijën. Nëpërmjet një rrëfimi të brendshëm, rrëfimtari atmosferën e krijuar në tregim, e percepton natyrshëm.

Në tregimin **Rrapëllima në shkallë** jepet rrëfimi realist për fatin e mërgimtarit. Portretizimi i *Viktorit* bëhet me gjeturi artistike, ku rrëzimi i tij në shkallë shpreh iluzionin e një jete të kënaqur e të lumtur, por ndodh e kundërta. Shtresa kuptimore e rrëfimit degëzohet në tiparet e këtij karakteri, në funksion të gjakimit për rresesë tjetër. Kësisoj, rrapëllima, përmes ironizimit, bëhet mbulesë shqetësuese e vizioneve të personazhit.

Në tregimin **Vraga** konceptohet atmosfera e soditur dhe e mbushur me muzikë zezakësh, me muzikën e popujve që vuajnë për lirinë. Në pikën e rrjedhës së veprimit, skicohet edhe figura e poetit, piktorit dhe malësorit. Tregimi ka lidhje vargëzore të veprimit.

Ndërkaq, në tregimin **Rruga Abanoz** rrëfimtari synon të depërtojë në moralitetin njerëzor duke shenjuar edhe temën e mërgimit, edhe veçantinë e vlimeve dashurore. Ngjarja, koha dhe njeriu vrojtohen me lehtësi komunikimi artistik.

Edhe në tregime të tjera, siç janë: **Nusja**, **Ashensori i lartësive**, **I treturi në shkretëtirë**, **Morthi**, etj., Nebil Duraku në qendër të veprimit ka vënë fatin e njeriut përballë dashurisë, vetmisë, mërgimit, dhembjes...

Pa çaste të rrëmbyeshme e dramatike të thëniesimit lirik, të gjitha vijat rrëfimore të tregimtarisë përmbliohen në pikën e vizionit ku thuret rëndomtësia dhe e përditshmja. Tiparet më veçuese shqiptohen nga fokusi i rrëfimitarit. Përjetimi i atmosferës bëhet me fanitje kujtimesh sentimentale, prekëse, në trajtë legjendash e përrallëzimesh për çastin e përfytyruar e të përshkruar në tregim. Autori nuk bën eksperimente krijuese, por vetëm rrëfen si një narrator i kujdesshëm që i shndërron mundimet në formën tregimtare të letërsisë.

Në tregimet e Nebil Durakut ndeshim çfarësinë e venerimeve të botës dhe të hapësirës së paraqitur. Temat janë më shumë reale sesa ireale, më shumë i përkasin të ndodhurës sesa realitetit imagjativ. Në fokusin tregimtar prodhohen gjithmonë copëza kujtimesh të shpaluara në ndërrijen e rrëfimitarit. Ngjarja është lëndore dhe përshkrimi i qartë, i standardizuar, madje në rrafshin shprehës. Tregimtari pikërisht në këtë frymë mëton të poetizojë kohën e përjetuar në rrëfim, dëshminë, forcën dhe optimizmin e personazhit.

Në këto tregime të Nebil Durakut tematizohen bredhjet, shqetësimet, mëdyshjet, paragjykimet e njerëzve të lumtur e të shumëvujtur, të cilët përbrenda imagjinatës krijuese venerohen edhe nga pozicioni i rrëfimitarit. Autori i nyjëton vlimet e brendshme të personazheve, dëlirësinë dhe ndryshkun që vrujon në shpirtin e tyre.

Edhe në këtë tip shkrimi, sikundër në roman, personazhi pikësëpari ballafaqohet me gjendjet ekzistenciale. Ballafaqimi me jetën, kësisoj, bëhet model i të treguarit, forcë gjykimi e vlerësimi.

Prandaj, në rrafshin komunikues zotëron pikëpamja se efekti estetik i këtyre tregimeve mbështetet në retorizmin e shprehjes, në mangësinë e figurshmërisë, në grumbullimin e detajeve si dhe në mosnyjëtimin e gjendjeve psikologjike të karaktereve.

Tregimet e Nebil Durakut imponohen me imazhin dhe ngjyrimin ambiental si dhe me dendurinë e emocioneve, të sipërtheksuar në rrafshin poetik.

9. Drejtpërdrejtshmëria e rrëfimit

Vëllimi tregimor për fëmijë **Topi i larmë** është vepra e parë letrare e Nebil Durakut. Në të janë renditur tregimet e së përditshmës, të aktualitetit të kohës duke filluar nga reflekset e mallit fëmijëror për t'u shtrirë deri tek krijimi i përfytyrimeve joshëse që rrisin kureshtjen lexuesve. Në këtë fushëhetim shquhen tregimet: **Artisti i vogël, Vjollca balerinë, Një herë vjen vera kah dera, Gazeta, Udhëtime të çuditshme**, e të tjerë.

Nebil Duraku, si model shkrimi, përdor rrëfimin përrallëzor për t'i shenjzuar shtresat kuptimore të veprës. Në këtë mënyrë, krijimtaria gojore përcakton shkathësinë e temave, zgjedhjen e brumit, fushën kuptimore dhe artistike të veprës. Rrëfimtari i këtyre tregimeve të shkurtra paraqet edhe gjendje psikologjike

të personazheve që janë: *Demiri, Vjollca, Agimi, Ylberi, Burbuqja, Vjollca, Tefiku*, e të tjerë.

Në këto tregime autori koncepton rrëfimin dhe materien e tij, thjesht e spontanisht, pa stërhollime të mëdha, pa gjendje të ndërlikuara, por me një ndjeshmëri joshëse. Në punën e tipizimit të personazheve mbizotëron kujdesi për gjuhën, për qartësinë, për thellësinë e porosisë poetike. Rrëfimtari prek natyrshëm botën e brendshme të fëmijës: dëshirat, ëndrrat, synimet, idealet që përbëjnë një jetë të lumtur e të dashur, ku e keqja dhe e hidhura mënjanohen.

Tregimet për fëmijë të këtij autori, në mënyrë të veçantë tejshquajnë përmasën didaktike të tyre, rolin mësimor e edukativ, duke kërkuar me çdo kusht të bukurën mbi të gjitha kategoritë e tjera estetike. Autori e materializon praninë e fëmijës-personazh gjatë strukturimit të ngjarjeve duke e pasuruar me elemente të reja dhe joshëse rrëfimin e tij. Bota e këtyre personazheve synon përjetësimin e të ndodhurave në realitetin ekzistues, ku kërkohet vijimisht fuqia e shprehjes për ta thënë fjalën e bukur, për ta mishëruar atë në vizionin e tyre për të ardhmen. Ky autor, sikur është i prirur që edhe në këto tregime të meditojë veçan për fatin e njeriut, për problemet dhe mëdyshjet e tij të shumta. Ndonjëherë, spontaniteti dhe drejtpërdrejtshmëria e thënies rrëfimore, ndër të tjera, vënë në dukje përmasën e tejudkshmërisë dhe retorizmin gjatë konkretizimit të brumit artistik.

10. Kuptimësia e tekstit dramatik

Autori Nebil Duraku ka treguar interesimin e tij krijues edhe për dramatikën, skenarin, dramën televizive e të tjerë, për të shqiptuar thelbin jetësor e njerëzor të personazheve dhe të karaktereve në rrafshin e veprimit të tyre. Domethënë: përveç komunikimit poetik dhe estetik të shkrimit si lexueshmëri, autori i këtyre dorëshkrimeve kuptimësinë e tekstit e kërkon edhe në skenë, si shfaqje që përjetësohet më gjatë te marrësi.

Nga një përzgjedhje e dramave të lëna dorëshkrim nga ky autor, gjithsesi, dallohen „Maska e çjerrë”, „Futa” (skenar drame televizive), „Vegëza” (dramë televizive) dhe „Kopshti i pleqërisë” (skenar për film televiziv). Në këtë tip shkrimor, Nebil Duraku përvijon tematikën, pothuajse të përsëritur në letërsinë shqipe, duke bërë objekt artistik gjakmarrjen në ndërlikueshmërinë e jetës shqiptare. Përmes një gjuhe poetike të shkathët, autori i kap gjendjet psikike të personazheve duke depërtuar në veprimet e tyre.

Në dramën **Maska e çjerrë** hakmarrja bëhet temë që shqipton realitetin shpirtëror e njerëzor duke mbitheksuar vdekjen dhe fatin tragjik prej ëndrrës në jetë dhe anasjelltas. Autori e shkallëzon përmasën e përhellë të hakmarrjes për të formësuar vetëdijen dhe ndërdijen e karaktereve që përcaktojnë kuptimësinë dhe porosinë e ideve. Duke e shenjëzuar hakmarrjen në mendësinë e karaktereve, Nebil Duraku i ballafaqon ndërmjet vetes fanatizmin, mentalitetin, zakonet, dukuritë e

shëmtuara që paraqiten në realitetin shqiptar. Përmes krimit të *Qerim Jusollit*, vrasësit të burgosur, ndër të tjera, ndërtohet tragjika e realitetit jetësor dhe e fatkeqësisë njerëzore. Kësisoj, dialogu midis Qerim Jusollit dhe *Selim Shpatit* vë në qarkullim ideor fenomenet reale dhe mitike, të cilat e shtresojnë rrafshin psikologjik të dramës prej idesë për të vërtetën deri te mënyra e konceptimit të fantazmës që shndërrohet si pamje rrëqethëse në figurën e *Alush Beganit*.

Në dramë thuret vetë jeta, e mbërthyer me vrasje, burg, mbyllje në shtëpi, me tokën peng, me intriga e mashtrime etj. Edhe personazhet: Haxhi Hamiti, Sefa, Malushi, Nifa, Lahu etj., në forma dhe mënyra të ndryshme ndërlidhen me funksionin parësor të ngjarjes. Drama „Maska e çjerrë”, gjithashtu, është e mbushur me ndjenja, mendime, asociacione, prapavështrime, mëdyshje, konflikte, ku formësohet bota e njeriut, prej shprishjes shpirtërore deri tek fenomeni i vdekjes.

Po kështu, edhe drama televizive **Vegëza** është ndërtuar poetikisht mbi sistemin e ideve të dramës „Maska e çjerrë”. Kësaj radhe, tematika e njëjtë është proceduar në një mënyrë tjetër me aktivizimin, fund e krye, të dialogëve kallëzimtarë midis *Qerim Jusollit* dhe *Selim Shpatit* dhe me mënjanimin e personazheve të tjera, që janë të pranishme në dramën „Maska e çjerrë”. Teksti i dramës, edhe këtu shqipton në rrafshin përfytyrues e shfytyrues shqetësimin dhe dyshimin për format e hakmarrjes dhe për shkak-pasojat e saj. Si nivel shkrimor, është më shumë tekst përshkruar i gjendjeve sesa i veprimeve.

Në skenarin për film televiziv, siç e quan autori dorëshkrimin **Kopshti i pleqërisë**, përshkruhen gjendje konkrete të vijëzuara në atmosferën e një jete sociale, ku protagonistin *Dan Berisha* mediton për fatin e vet të kapërdhurur përbrenda shtëpisë së pleqve. Në rrjedhën veprimore të ngjarjes shpaloset bota e brendshme e këtij personazhi me përmasën e dhembjes për sëmundjen e tij, për pozicionin e palëvizshëm të trupit të tij, sikundër edhe për gjendjen shpirtërore përballë punonjësit social, prej të cilit varet kafshata e tij e bukës. Kësisoj, ky skenar për film televiziv, duke paraqitur fatin e Dan Berishës, ndër të tjera, trajton idenë e njeriut për trashëgimi. Duke depërtuar në shqetësimet shpirtërore të Danit, autori vijëzon edhe figurën e *Blerimit*, djalit të tij si dhe shtreson raportin e të ndodhurave midis *murgeshës*, *Zehrasë* e *Danit*.

Në skenarin tjetër për dramë televizive, të emërtuar **Futa** (dorëshkrim i vitit 1978), Nebil Duraku shtreson një temë tjetër, që ka të bëjë me luftën dhe pasojat e saj. Personazhet janë: *Adilja*, *Avniu*, plaka *Sabile*, *Nolja*, *Bilimi*, *majori* e të tjerë. Tipizimi i personazheve është bardhë-zi, i paraqitur me detaje të rëndësishme, ku shfaqet fatkeqësia nga fenomeni i së kaluarës.

Teksti i „Futës” është karakterizues i kohë-hapësirës përbrenda periudhës së caktuar me ngjarje nga luftërat pushtuese sllave. Këtu ngjarja zhvillohet shkallë-shkallë nga ndërtimi i një dashurie midis *Nolës* dhe *Bilimit*, pastaj shpërthimi i luftës nga bullgarët, ku zihet *Avniu* e pushkatohet dhe nusja e tij, *Adilja*, lidhet me pranga, fati i shtatëdhjetë e pesë femrave të robëruara, prania e ushtarëve të maskuar (bullgarë e serbë) që i torturojnë femrat, dhunimi, ndërrimi i rrobave të

ushtarëve pushtues, e të tjerë. Kësisoj, „Futa” është përplot detaje e përshkrime skenash që realizohen gjatë veprimit të karaktereve.

Konstatime përmbyllëse

Proza e Nebil Durakut, e karakterizuar përbrenda kësaj qasjeje studimore me veprat: „Murgesha”, „Shtrojera”, „Dhengrënësit”, „Drenusha”, „I treturi” „Murana”, „Egjra” dhe „Kobi”, tregon për përmasat e një arti të treguar nëpër një shkallë të caktuar të thënies rrëfimore.

Duke i përmbyllur konstatimet përkitazi me veprat tregimtare të Nebil Durakut, me rendin e tyre të botimit, ndër të tjera, mund të pohohet:

Romani **Murgesha** (1966) shtreson dhe karakterizon fatin e murgeshës. Në gjurmimin e gjendjeve mbizotëron tema e jetës, e vuajtjes, e dashurisë. Në pikëshikimin tjetër, mjerimi i njeriut, mbyllja, vetëflijimi i çasteve lumturore, përhumbja ëndërrore në „derën shpëtimtare”, jo rrallë, bëhen temë-mëdyshje e zgjidhjes fabulative;

Romani **Shtrojera** (1969) përmbledh karakteristikat e një proze që projekton kohën e aksionit të armëve, shkollimin, dashurinë dhe dukuritë e ndryshme të realitetit shqiptar në një periudhë të caktuar historiko-shoqërore. Ndërtimi i gjendjeve konfliktore bëhet me „dokumentimin” e lakmisë pushtetmbajtëse të njerëzve, siç ndodh me Sylë Bimbashin. Vija e idealit jetësor e kombëtar përfaqësohet me personazhin Agron Spahiu, ndërsa veçantia dashurore dhe e emancipimit me Hanën, që niset prej legjendës për të dhe mbaron me zgjidhjen fatlume të veprimit romanor;

Romani **Dhengrënësit** (1971), me artin e të treguarit, dëfton përmasën e kolonizimit e të shprishjes së qëllimshme të hapësirës shqiptare nga pushtuesit. Gjendjet në tekstin rrëfimor janë paravajtëse, që përmbledhin rrafshin real të të ndodhurave. Në këtë roman bëhet tipizimi i personazheve prej shkallës së iluzionit, nëpër teshun e ideologjisë e deri te faktografia e rrëfimit. Për më tepër, në të shpalohet kujtesa e mbështjellë me tragjikën dhe tragjicitetin e një etnikumi;

Me romanin **Drenusha** (1980), Nebil Duraku kohën e bëmave e vendos në një kohë tjetër plot kundërthënie në ambientin shqiptar. Drenusha venerohet përbrenda dhembjes dhe vuajtjes shpirtërore ballëpërballë me mendësinë e flijimeve femërore. Kësisoj, romani shpalon faqen e një realiteti të tejmbushur me laryshi të forta të moralitetit të shprishur brenda një jete njerëzore. Do të thotë fillimi dhe mbarimi i personazheve i nënshtrohet kodit etik prej pikës së zmadhimit heroik deri te perceptimi grotesk i përftesave ideologjike;

Në romanin **I treturi** (1983), në kujtime të renditura si në ëndrrën për jetën, bëhet konstruksioni i vetmisë tragjike, duke e prekur temën e mërgimit, për të paraqitur vizionin e një personazhi (Malush Ukshini) me mundimet e shumta të ekzistimit. Mënyra e shpalimit të kujtimeve i ngjet vetëdijes shkrimore nga

romani-ditar, ku nëpërmes letrave të „zbuluara” si kujtime të renditura kronologjikisht, zbërthehet një pjesë e jetës në kampe përqendrimi e në mërgim nga pozicioni i ndërgjegjesimit kritik;

Autori me romanin **Murana** (1986), në nivelin karakterizues e përthekon fatin njerëzor të nyjëtuar nga raporti i kundërshtisë në një rrafsh paralel të të ndodhurave. Në të bëhet shkallëzimi i përjetimeve në mërgim nga fushëveprimi i gjendjeve moralizuese e psikologjike, ku herë rritet përmasa e neverisë midis personazheve, herë zmadhohet ideali dashuror. Në punë të strukturimit të ngjarjeve, „Murana” është roman i shkruar mbi pasojat e luftës dhe ndjek vijën e vërtetësisë në zbulimin e krimit. Kësisoj, gjendjet janë të tejtheksuara midis dyshimit e drojes dhe moralit e dashurisë;

Në këtë pikëshikim, romani **Egjra** (1989) shqipton rrafshin satirik e ironizues që përgjatë rrjedhës fabulative bashkon elementet e një proze plot ndjenjë, trauma, drama shpirtërore e kolektive përmes funksionit emërtues të personazheve. Në tipizimin e karaktereve dallon figura e Xha Kokorrit, dhe veçan e Korbit. Ky roman shquhet për pamjet rrëqethëse të grumbulluara në sfondin e perceptimit, madje edhe për degëzimin kuptimor të një utopie shoqërore që vijëzohet në shtresat e domethënies. Doemos, edhe tragjika dhe tragjiciteti bëhen pika kulmore dhe dramatike në procesin e të treguarit të një ndodhie;

Po kështu, edhe me tregimet e paraqitura në vëllimin **Kobi** (1983), Nebil Duraku përmbledh dhe sintetizon vegimet e çastit dhe të jetës, shumë herë nga pikëshikimi i rrëfimitarit autorial. Në to zotëron përmasa e fatit në përmasën hapësirë-kohore, ku dëftohet ballafaqimi i njeriut me jetën. Kësisoj, tregimtaria e këtij autori kërkon me çdo kusht porosinë dhe përfundimin e ngjarjes përbrenda atmosferës së soditur. Në këto tregime poetizohet koha e përjetuar me dëshminë, forcën dhe optimizmin e personazhit. Në vijën e shqiptimit të kuptimësisë, shenjohe tek-tuk edhe elementi ideologjik përmes botëkuptimit dhe ndjenjave të personazhit.

Në bazë të këtyre konstatimeve, mund të përfundohet se vepra letrare e Nebil Durakut është mbështetur më së shumti në faktografi, në dokumentaritet, që brenda realitetit të kohës transponon edhe ndjeshmërinë dhe vizionin e saj historik, kuptohet si paraqitje e të ndodhurave. Pikërisht, ky takim i vazhdueshëm me kohë-hapësirën e veprimit të ngjarjes, ka përcaktuar me vetëdije mundësinë e shkrimit dhe rrugën e tij krijuese.

Autori i ka ikur artit abstrakt, duke rënë shpeshherë në tejdukshmëri krijuese, ku thelbi dhe kuptimi janë kushtëzuar në forma të ndryshme për ta „shpjeguar” të ndodhurën në realitetin konkret. Në këtë mënyrë, edhe realiteti social është vijëzuar me njëmendësinë e veprimit të personazheve. Prandaj proza, duke i bashkuar episodet e jetës e të vdekjes së njeriut, madje të tipave dhe karaktereve të ndryshme, ndër të tjera, është shndërruar në parimësinë e konvencës me idealizime e moralizime të çastit.

Nebil Duraku, herën tjetër do të përqafojë kujtimin krijues të asaj që ka ndodhur. Në epiqendër të veprimit të ngjarjeve është vendosur njeriu dhe fati i tij.

Depërtimi në botën e tij të brendshme është qëllimi kryesor i autorit. Gjithsesi, proza e tij „vërteton” përkatësinë e të ekzistuarit kah kuptimësia e prozës tradicionale shqipe. Forma e tillë romanore mbështetet në faktin e tillë letrar. Nebil Duraku nuk është larguar nga caku i kuptimeve që e prodhojnë artin drejtpërsëdrejti si domosdoshmëri humane.

Në këtë sprovë leximi kritik, le të thuhet, ndër të tjera, se vepra e tij letrare botën shpirtërore e njerëzore e rrumbullakëson si dëshmi të kohë-hapësirës së përjetuar.

Vehap Shita

Proza artistike e Nebil Durakut

Përjetimi subjektiv i realitetit objektiv është karakteristik për një periudhë bukur të gjatë të prozës realiste të fundit të shekullit XIX e të dhjetëvjetëshave të parë të shekullit tonë. Me kohë, ai do të marrë ngjyrat e realizmit kritik për të kaluar më vonë, sidomos pas Revolucionit të Tetorit në Rusi (1917), në të ashtuquajturin socrealizëm që, si drejtim letrar, pas Luftës së Dytë Botërore, nën ndikimin e letërsive sovjetike e jugosllave, do të depërtojë edhe në letërsinë shqiptare, dhe, siç e dimë, një kohë do të vërshojë edhe letërsinë këtu në Kosovë. Për më tepër, si formë dhe si shprehje, ai akoma qëndron i „fortë”, pa marrë parasysh sesa mohohet nga vetë ata që e praktikojnë.

Karakteristikë qenësore e socrealizmit ka qenë dhe ka mbetur përshkrimi bardhë e zi, duke filluar nga personazhet e gjendjet e deri te ngjarjet e madje edhe përjetimet e emocionet më intime jo vetëm të protagonistëve - heronjve pozitivë e negativë të krijimeve letrare, por edhe të episodistëve më të thjeshtë. Me një metodë të këtillë të shikimit, të përjetimit e të pasqyrimin të kohës dhe të hapësirës së caktuar ose të imagjinuar, jo vetëm që frenohet imagjinata dhe brumëzohet frymëzimi e fuqia krijuese, nëse ekziston fare, por edhe të shprehurit e autorit do të jetë jo si e sheh dhe e ndien ai vetë subjektin, por si do të dëshironte që ta shohin ose ta ndiejnë të tjerët, të shumtën e rasteve, jo publiku i gjerë lexues, të cilit duhej t'i drejtohej vepra letrare, por, në radhë të parë, ata që e kanë në dorë ta botojnë ose të mos e botojnë veprën në fjalë, ta lejojnë ose ta ndalojnë publikimin e saj.

Besoje, nuk është e nevojshme të përmend një varg shembujsh të këtillë në letërsinë tonë, këtu tek ne, prej ditëve të para të nismës së saj, pra, prej botimeve të para në revistën tonë letrare „Jeta e re”. Autori që, në këto rrethana, ka synuar të shkëputet nga kjo mënyrë e të vështruarit dhe të paraqiturit të realitetit objektiv, është dashur të ketë jo vetëm guxim, por edhe shumë mjeshtëri që, me fuqinë e imagjinatës, me alegori e metaforë, me hermetikë e besa edhe me konfuzion, jo vetëm në poezi, por edhe në prozë, ta shprehë realitetin objektiv si e sheh, si e ndien vetë si artist, si i gufon në shpirt - për ta shënuar dhe përjetësuar në veprën e tij. Por, në ato rrethana vërtet nuk ka mjaftonin talenti, mjeshtëria, frymëzimi, aftësia e të perceptuarit, e vrojtimit dhe e të shprehurit artistik. Artisti, në këto raste, është dashur të kishte edhe më shumë kurajo civile e guxim njerëzor. Kësaj kategorie të autorëve tanë të prozës artistike (Hivzi Sulejmani, Zekeria Rexha, Anton Pashku, Rexhep Qosja etj.), këtu në Kosovë, ndonëse në përmasa më modeste, i përkiste edhe Nebil Duraku.

Realizimet e këtilla në prozë do t'i quanim prozë e realizmit kritik të shprehur me metodën dhe veprimin e socrealizmit, që ishte mbizotërues si drejtim dhe metodë e prozës artistike të kohës dhe të hapësirës në të cilën po krijohet ajo. Dihet se me krijime të këtilla artistike në prozë ka qenë vështirë të depërtohej në botimet tona atëherë - sidomos në qoftë se ato kanë qenë të lidhura me çastin aktual - qoftë të sotëm, qoftë të së kaluarës sonë më të afërme, qoftë edhe të traditës, nëse vetëm mund të mendohej e shpeshherë edhe të trillohej se mund të ngjallnin farë asociacionesh, që mund të lidheshin aktualisht me të përditshmen tonë. Ta kujtojmë vetëm rastin e njërit nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës - Hivzi

Sulejmanit. Romani i tij „Njerëzit” është dashur të presë plot dhjetë vjet për t’u botuar, madje edhe atëherë i „redaktuar”, ose, të themi më mirë, i reduktuar nga „shokët e Komitetit”. E ai, romani „Njerëzit”, si e dimë, është pikërisht një përjetim subjektiv i realitetit objektiv - i jetës, i kohës, i hapësirës, në të cilën protagonist është vetë autori (Hafizi) - pjesëmarrës veprues i lëvizjes përparimtare të studentëve të Beogradit para luftës, pjesëmarrës veprues i Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në kohën e pushtimit fashist të vendit e funksionar i lartë i pushtetit pas luftës. „Njerëzit” e Hivzi Sulejmanit janë edhe i vëllai, Azizi, i vrarë nga çetnikët serbë të Kollashinit, e ëma - Xhemilja trime, strehuese e punëtorëve ilegalë dhe e luftëtarëve të LANÇ, vëllai më i madh i Hafizit (Hivziut), Rizai, punëtor i kripores së Tuzllës, që do të vdesë në mënyrë misterioze para luftës, dhe tërë brezi i Hivziut, në të cilin do të takojmë edhe luftëtarë të shquar të lëvizjes përparimtare studentore e antifashiste si Rashid Dedën, Rifat Burxheviqin, Alia Aliagiqin (atentator ndaj ministrit të Punëve të Brendshme të Mbretërisë Jugosllave, Drashkoviç), etj.

Pothuaj të njëjtin fat do ta përjetojë edhe romani i dytë i Hivzi Sulejmanit „Fëmijët e lumit tim”, i cili mezi do t’i kalojë të gjitha censurat e mundshme të komiteteve e të komisioneve, të jurive e të recensentëve, për të dalë më në fund në dritë, edhe ky i „reduktuar”. Ndërkaq, romani i tretë i Hivziut, i cili me dy të parët do të përbënte një trilogji të lidhur tematike aktuale, i bërë dorëshkrim, ja, mbeti i pabotuar edhe më se 20 vjet pas vdekjes së autorit. Nëse atëherë mendohej se romanet e Hivziut na qenkëshin të „rrezikshëm” për ndonjë pushtet ose sistem, kohë, mjedis ose personazh që mund të ngjallte tërthorazi ose zgjidhje për ndonjë person, të paemëruar me emrin e tij të vërtetë, do të thosha se shumë më të „rrezikshme”, nëse do të mund të thuhej kështu, mund të ishin tregimet e Hivziut „Mjegullat” ose „Hijet në kuvertë” e të tjera, të cilat kanë kaluar pa asnjë „ferrë në këmbë” nga juritë e recensurat, e të mos flas për ndonjë censurë tjetër të mundshme, e cila ndoshta nuk ka ditur t’i „lexojë” e të zbërthejë metaforikën e tyre.

Libri i këngëve popullore, të komentuar nga Zekeria Rexha, është djegur në zjarr pasi është shtypur në shtypshkronjë. Romani „Oh” i Anton Pashkut ka pësuar disa redaktime dhe ka pasur disa versione, derisa është shtypur në njëqind e ca faqe. Romani **Shtrojera** i Nebil Durakut është kthyer disa herë nga recensentët derisa ka marrë formën në të cilën është publikuar etj.

Të mos përmend tash prozën e shumë të tjerëve, në vrojtimet dhe në analizat e holla të të cilëve paraqitet psika e ndërvoja e njeriut tonë sot e në të kaluarën më të afërme e më të largët, por edhe fshihet një labirint i tërë preokupimesh e porosish të nduarnduarta të tyre, që ngjallin emocione e asociacione dhe cysin ndjenjat e mendjen e lexuesit, duke e angazhuar thellësisht për qenësinë e tij si individ dhe si pjesëtar të kolektivitetit të cilit i takon, të shoqërisë dhe të mbarë njerëzimit.

Në kushtet e rrethanat në të cilat është krijuar, është rritur dhe i ka marrë këmbët letërsia jonë bashkëkohëse, pikërisht proza, më duket se e ka pasur rrugën më të vështirë dhe më me gjemba. Prandaj më së paku prozatorët do të mund t’i qortonim

për mungesën e guximit, dhe aq më pak t'i fajësonim për atë që me të vërtetë i mungon prozës sonë artistike. Por, do të mund t'i fajësonim edhe vetë autorët, edhe recensentët e kritikët tanë letrarë, që nuk kanë arritur gjithherë që, me fjalën e vet kritike, ta „ndajnë shapin nga sheqeri” dhe t'i quajnë me emrin e vet ato që e ngarkonin dhe që e ngarkojnë prozën tonë, duke filluar nga niveli i ulët i shkrimit letrar e gjuha e varfër e deri te shtrembërimet e njëanshmëritë, që janë të pranishme në mjaft proza të botuara - nga tregimi më i thjeshtë e deri tek romanet e dramat.

II

Më se tridhjetë vjet rresht, në prozën tonë, ashtu si ishte, me të gjitha cilësitë e mungesat e saj, vepronte aktivisht edhe Nebil Duraku. (Në shënimet e veta të lira bio-bibliografike, që m'i dërgonte kur po përgatitja pashënien për botimin e dytë të romanit të tij „Shtrojera”, shkruante se „shkrim-leximin e 36 shkronjave të alfabetit” shqip e mësoi nga komisari i një grupi partizanësh shqiptarë, që ishin strehuar në odën e tyre. Por duhej të kalonin edhe katër vjet që ta merrte rrugën e shkollës. Ndërkohë ua „ruante bagëtinë apo ua punonte fushën djelmoshave që ndiqnin shkollën, me kusht që, kur të ktheheshin, t'i tregonin çfarë kishin mësuar në shkollë. Kështu edhe mësonte, krahas atyre që ndiqnin shkollën. Kështu edhe e kreu Shkollën fillore në Turiçefc...” Gjithë kjo do të lërë vragë edhe në veprën e tij letrare e publicistike - më vonë).

Mësues autodidakt e nëpunës në komunën e Turiçefcit të Drenicës, por një kohë të gjatë gazetar veprues, Nebili nuk mund të mos ishte reporter, ose të them më mirë, raportues tipik i realitetit, në të cilin ka jetuar e ka vepruar, edhe në prozën e tij artistike. Të gjithë e dimë se Nebili nuk i takon as njërës e as palës tjetër të prozatorëve tanë, për të cilët fola shkurtimisht. Por ai, në krijimtarinë e tij në prozë, në romanet, në tregimet, në radiodramat e në dramat televizive, vërtet pasqyron realitetin objektiv me përjetimin subjektiv të tij, ashtu që ne që e lexojmë, e dëgjojmë ose e shohim veprën e tij të ekranizuar, e ndiejmë sikur vetë e kemi parë ose përjetuar ashtu - pa u thelluar më shumë në analizën e shkaqeve, të rrethanave, të kushteve e të vijëzimeve të tjera. Një shkrim i gjallë, autentik, një përjetim i sinqertë që gufon nga vepra e Nebilit, e bën veprën e tij - të gjallë, autentike, të vërtetë jetësore, madje edhe artistike. Ai nuk shpreh ndonjë diapazon të gjerë të imagjinatës ose të njohjes. Ai ndalet, kufizohet në atë që sheh, që ndien, aty për aty, drejtpërdrejt, dhe atë e tregon me tërë sinqeritetin e tij si autor dhe si krijues. Ai, me të vërtetë, do të thosha, e „riprodhon” realitetin me fjalën e raportuesit të drejtpërdrejtë, por ky raport i tij e ka atë kompozicionin e metodologjinë e prozës artistike - qoftë të tregimit apo të romanit, të dramës apo të skenarit. Megjithëse gjithnjë e mban anën e përparimit, të së drejtës, të themi më afër, të të ndjekurit, të të persekutuarit, të të varfëruarit, Nebili si autor, nuk është i njëanshëm në përshkrimin as të personazheve, as të ngjarjeve e të gjendjeve në prozën e tij.

Shumë shkrimtarë, edhe nga ata më të mëdhenjtë e më prodhimtarët, në shumicën e shkrimeve të tyre kanë për objekt vështrimi e vrojtimi pikërisht mjedisin e tyre më të ngushtë. Aty sikur janë përherë më të sigurt. Në këtë mënyrë pasurojnë njohjet e përgjithshme, thesarin kulturor, kombëtar e të përgjithshëm njerëzor.

Nebili, me veprën e vet letrare, në letërsinë tonë bashkëkohëse ka futur Drenicën e tij aq të pasur me letërsinë gojore dhe përgjithësisht me folklorin shqiptar. Ngjarjet zhvillohen në këtë trevë më pak të zhvilluar të Kosovës, por, si thotë Nebili, „ndër njerëz fisnikë e bujarë”, të cilët, në kushte të reja, e „shihnin qartë se shkollimi i fëmijëve të tyre, pikërisht në gjuhën amtare, ishte shpëtimi i tyre, ardhmëria e tyre”.

Prandaj s’është çudi që edhe deformimet, që do të jenë subjekt i romanit të tij „Shtrojera”, botuar për herë të parë në vitin 1969 e ribotuar dhjetë vjet më vonë dhe më 1983, nisin pikërisht aty, me pengesat për shkollimin e fëmijëve sidomos të vajzave, madje edhe me përpjekjet për mbylljen e disa shkollave ose heqjen e klasave të larta të disa shkollave fillore e të mesme. Nebili do të shkruajë në këtë roman për aksionin famëkeq të mbledhjes së armëve (1956) dhe për shpërnguljen e një pjese të madhe të popullsisë sonë në Turqi në vitet pesëdhjetë, etj.

Tema të ndjeshme e „delikate” Nebili prek edhe në shkrime të tjera të tij. Në romanin **Dhengrënësit**, botuar në vazhdime në vitin 1980 në „Flakën e vëllazërimit” në Shkup, Nebili merr për subjekt kolonizimin e Kosovës midis dy luftërave botërore. Mjedisin ku zhvillohen ngjarjet, thuaja në të gjitha prozat e tij, është fshati.

III

Ndonëse përherë i lidhur me fshatin e njerëzit e tij, duket sikur pikërisht në romanin **Shtrojera**, më shumë se në të gjitha veprat e tjera, Nebil Duraku, si autor, është i lidhur drejtpërdrejt me vendlindjen dhe, si thotë vetë, shumë ngjarje në këtë roman janë të vërteta autentike dhe nga ato që përjetoj ai vetë, kur ushtronte detyrën e arsimtarit. Për më tepër, ai „pati telashe të mëdha me disa individë - bartës të deformimeve, të cilët, edhe pse me emra e mbiemra të ndryshuar, për shkak të ngjarjeve të njohura - e gjenin veten në këtë roman dhe kërcënuan se do ta padisnin në gjyq...”

Ngjarja e romanit zhvillohet në Kosjer (Runikë) të Drenicës, por ajo që e karakterizon „Shtrojerën” e Nebil Durakut, është thellimi i autorit në kontradiktat në jetën dhe në zhvillimin e fshatit tonë në përgjithësi në dhjetëvjetëshin e dytë të jetës pas mbarimit të Luftës së Dytë Botërore tek ne, kontradiktat dhe proceset nga të cilat kanë lindur edhe deformimet e njohura që kanë goditur më rëndë pikërisht fshatin tonë në Kosovë. Mirëpo, megjithëse e pranishme dhe në qendër të vështrimit kritik, deformimet nuk janë esenca e këtij romani. „Shtrojera” është më parë një kronikë e tërësishme e jetës në fshatin tonë në një periudhë, e jetës së

shikuar nga shumë pikëpamje, që i cilëson përpjekjet e peripecitë, sukseset por edhe pengesat në rrugën e zhvillimit të tij për emancipimin dhe transformimin e jetës dhe të marrëdhënieve në instancat e fundit, duke filluar nga ato në familje deri tek ato në shoqëri, në përgjithësi, por me theks të veçantë në ato që janë bazë e zhvillimit të mëtejshëm të gjithanshëm - në shkollimin dhe në arsimimin e masës më të gjerë, në radhë të parë të fëmijëve e të rinisë.

Në këtë kuadër u shfaqën deformimet e njohura të të gjitha formave, por në këtë periudhë takojmë edhe përpjekjet e sukseset e forcave më të shëndosha popullore dhe përparimtare të fshatit tonë, që ngadhënjë në përpjekjet dhe në luftën e tyre për zhvillimin dhe përparimin e jetës në fshat.

Në një gjerësi të këtillë subjektsh e motivesh, shumë nga këto ngjarje, pamje e dukuri të një kohe e të një mjedisi, të proceseve vendimtare të zhvillimit të fshatit tonë në atë periudhë; pasqyrojnë gjallërisht atmosferën, vlimet dhe gjendjet në një mjedis tonë tipik, në të cilin zhvillohen procese vendimtare jo vetëm për ndryshimin e botëkuptimeve të vjetra e prapanike dhe për formimin a forcimin e botëkuptimeve të reja, përparimtare, por edhe të gjithë asaj që ka qenë pengesë herë e hapët, herë e kamufluar e tinëzake në rrugën e zhvillimit dhe të emancipimit të fshatit tonë dhe të njerëzve të tij.

Fabula e „Shtrojerës”, e treguar në formën klasike të romanit bashkëkohës, ka një kompozicion të mirë e logjik dhe paraqet tërësinë e jetës dhe të fatit të personazheve kryesore në një fazë vendimtare të formimit të tyre, prej nga del mjaft e plotë dhe e formuar edhe pamja e tërë fshatit dhe e proceseve të zhvillimit të tij, e të luftës për ndryshime rrënjësore që ndodhin në një periudhë në të gjitha shtigjet, ku ngadhënjimi i botëkuptimeve përparimtare nuk imponohet vetvetiu, po rezulton si rrugë e pashmangshme, si zhvillim dialektik, në të cilin njeriu është faktor kryesor. Për më tepër, ai më shumë duket në horizonte sesa forcohet me shtjellimin dhe me zberthimin klasik të përfundimit të romanit me fitoren e bartësve të ideve të përparimit.

Kësisoj, autori thur me mjeshtëri një lëndë mjaft të gjerë nëpërmjet fatit të një vashe të re fshatare dhe të familjes e të të afërmeve të saj, duke dhënë tërthorazi një galeri të tërë personazhesh karakteristike të jetës në fshat që, ndonëse të lidhura ngushtë me fatin e heroinës së romanit të tij, Hanës, vijnë e bëhen fytyra karakteristike, thuaja tipike të fshatit tonë në periudhën e parë të jetës pas përfundimit të Luftës së Dytë Botërore - me të gjitha ato që i kanë ngarkuar nga e kaluara dhe që ndikojnë në orientimet dhe në veprimet e tyre.

Në këtë mënyrë, përmes gjendjeve faktografike, Nebil Duraku i jep „Shtrojerës” së tij edhe fuqinë e vizionit, ngjyrimet artistike, që e bëjnë atë më të gjallë, më tërheqëse e më impulsive. Në këtë kuadër, ai formëson rrethin, atmosferën në të cilën i shohim të gjalla dhe të mishëruara me gjak e ndjenja, me qëndrime e botëkuptime të veta, personazhet kryesore të romanit të tij. Ai i formëson dhe i rrumbullakëson shkallë-shkallë këto personazhe, që, në fund, të duken vërtet të gjalla, jetësore, autentike, impulsive dhe njëkohësisht të bindshme.

Heronj pozitivë kryesorë në romanin „Shtrojera” janë *Hana* e vogël, babai i saj, *Aliu*, dhe mësuesi, *Agroni*. Hana është heroinë tipike e fshatit tonë të pasluftës. Që nga fëmijëria e hershme e derisa ta kryejë maturën e Normales dhe të kthehet mësuese në fshatin e vet, ajo i shijon të gjitha gëzimet e peripecitë e mundshme, për të cilat kemi dëgjuar se e përcjellin ose, së paku, se e kanë përcjellë shkollimin e një vashe të re fshatare. Kësisoj, ajo vjen e formohet në këtë roman si fytyrë shumë e gjallë karakteristike, thuaja tipike, përkundër ca veçantive që i mvishen në jetën e saj intime në familje.

I ati i Hanës, Aliu, ish-luftëtar dhe invalid i luftës, me botëkuptime thuaja instinktivisht përparimtare, dhe burrë i ndershëm e bujar, trim i vendosur e prind i përkushtuar, siç kemi mjaft njerëz të këtillë në fshatin tonë, bëhet edhe luftëtar i vendosur dhe i patundshëm për ndërtimin e shkollës së re në fshat, për përfshirjen e djemve, madje edhe të vajzave në shkollë. Ai është i papërkulshëm dhe pa kompromis në luftën e tij për përparimin dhe emancipimin e fshatit dhe të njerëzve të tij, që ka qenë pikësynim i luftës, të cilës i qe kushtuar me tërë qenien e tij që në ditët më të vështira të pushtimit të vendit.

I këtillë, Aliu është i paracaktuar të bjerë në përleshje të ashpra me forcat e prapambetura në fshat, të cilat do t’i përgatisin grackat më tinëzake për ta hedhur më në fund edhe në mundime dhe terrorizime të njohura të periudhës së deformimeve të organeve të të ashtuquajturit „pushtet popullor”, të policisë e të sigurimit shtetëror serb, që kanë qenë karakteristike edhe për këtë fazë të ngecjes së zhvillimit tonë të pasluftës.

Lidhur me këtë fytyrë interesante të romanit të vet, autori paraqet edhe shumë skena tronditëse nga aksioni famëkeq për mbledhjen e armëve, duke i ilustruar këto edhe me fakte të vërteta, për të cilat është dëgjuar dhe shkruar në shtyp në kohën e dënimit të njëzëshëm të këtij aksioni dhe të deformimeve të tjera të asaj periudhe.

Nebil Duraku ka ditur t’i ndërthurë të gjitha këto në romanin e tij „Shtrojera” ashtu që tingëllojnë në mënyrë mjaft të natyrshme e të bindshme, me një rrjedhë logjike, të lidhura e të trupëzuara mirë në bërthamën e ngjarjeve të romanit, ku, Aliu me të vërtetë del një nga fytyrat më të formuara, më të gjalla, më autentike. Ai nuk është paraqitur në mënyrë të njëanshme dhe nuk është aspak fytyrë e njëtrajtshme. Në luftën dhe në përpjekjet e tij, ai nuk është viktimë e rastit dhe fshatar i pavetëdijshëm. Përkundrazi, ai lufton gjatë tërë kohës me koshiencën më të lartë për qëllimet dhe idealet që e kanë ushqyer gjatë Luftës Antifashiste Nacional-lirimtare, në të cilën ka marrë pjesë vepruese dhe së cilës ia ka falur edhe një pjesë të trupit dhe të shëndetit të vet, idealet e së cilës i mban gjithnjë të gjalla në ndërdijen dhe në tërë qenien e tij.

Me vetëdije të plotë, Aliu hidhet në përleshje me elementët rrënues e kundërveprues të fshatit që, në një fazë të caktuar, kanë arritur të futen në të ashtuquajturin „pushtet i ri popullor” dhe të zënë, madje, edhe pozita drejtuese në të. Por, duke luftuar kundër këtyre, Aliu në asnjë çast nuk deklarohet kundër atij

pushteti, për të cilin ka luftuar edhe vetë dhe të cilit do t'i qëndroj besnik deri në fund.

Janë dhënë në roman edhe disa fytyra interesante të luftëtarëve të përparimit në fshat, ndër të cilat dallohet sidomos ajo e drejtorit të ri të shkollës, mësuesit Agron, i cili gjithashtu do të bjerë viktimë e deformimeve. Mësues, revolucionar e pishtar i arsimit, i kulturës, i emancipimit dhe përgjithësisht i përparimit në fshat, Agroni është figurë tipike e atyre arsimitarëve tanë të parë të rinj, që hidhen me pasionin e rinisë së vet në betejat e reja të luftës për transformimin shoqëror, për zhvillimin dhe ndërtimin e vendit e të njeriut. Ai është me të vërtetë bartës i denjë i frymës së re në mesin tonë, personifikim i „idealit të vërtetë” të plejadës së parë të arsimitarëve tanë të shkolluar në frymën e liritimit dhe të përparimit të njeriut e të emancipimit kulturor e kombëtar të popullit tonë.

Por, autori i „Shtrojerës” e largon shpejt Agronin nga skena e romanit të tij - atëherë kur, nën ndikimin e reaksionit dhe të bartësve të deformimeve (lexo: organeve të sigurimit shtetëror serb - UDB-së e të pushtetit sllavo-komunist), e largojnë, e shkarkojnë edhe nga detyra e drejtorit të shkollës së re edhe nga puna në arsim. Megjithëse vetëshkarkimi i Agronit në kushte të këtilla nga shkolla dhe nga veprimi, në roman ka domethënien e vet të vetvetishme, fryma dhe funksioni i Agronit do të jenë gjithnjë të pranishëm në „Shtrojerën” e Nebil Durakut me vetë shtjellimin e mëtejshëm të ngjarjeve, në të cilat, Hana e re do të jetë vazhduese e veprës së Agronit - gjithnjë heroinë e vogël e vërtetë, luftëtare e paepur, e re e përkushtuar, e thjeshtë e modeste, por e vendosur, bosht i ndërrimeve dhe i transformimeve, paralajmëruese e fitores në horizont. Ajo do ta kryejë Normalen dhe do të kthehet mësuese e parë në fshatin e saj, do ta realizojë ëndrrën e vet dhe të babait të saj të verbuar nga peripecitë që do të pësojë.

Por, kjo nuk do të jetë fitore vetëm e saj dhe e babait të saj. Do të jetë kjo fitore e fshatit mbarë, e forcave përparimtare, e përparimit dhe e ardhmërisë së sigurt të tij. Do të jetë kjo njëkohësisht humbje e forcave prapanike, kundërvepruese dhe e bartësve të deformimeve në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit të fshatit tonë. Do të jetë kjo simbolikë e së sotmes dhe e së ardhmes sonë.

Në romanin e Nebil Durakut, ndërkaq, do të ketë edhe shumë personazhe e figura të tjera që, në një mënyrë a në një tjetër, pasqyrojnë dhe portretizojnë një periudhë të caktuar në jetën dhe në zhvillimin e fshatit tonë. Në mënyrën e vet janë interesante edhe personazhet negative në romanin „Shtrojera”, të cilat sikur janë të „punuara” më shumë, të latuara më mirë nga autori që nuk është kursyer fare në portretizimin dhe në karakterizimin e tyre si bartës të prapambeturisë, të injorancës, por edhe të kundërveprimit, të dhunës, të pengimit të çdo përparimi.

Ndër figurat e këtilla negative më të formësuara, janë ajo e kundërvepruesit tipik të fshatit, *Sylë Bimbashit*, dhe ajo e operativistit të deformuar të UDB-së, Miloradit, të cilët, haptazi ose në mënyrën më tinëzake, do t'i nxisin përpjekjet për mbylljen e klasave të larta të shkollës fillore të fshatit, për pengimin e nxënësve, sidomos të vajzave, për të vazhduar shkollimin në shkolla të mesme e të larta, e do të jenë bartës të deformimeve për ndjekjen e veprimtarëve të ndershëm e të

njerëzve të pafajshëm, të aksioneve për mbledhjen e armëve nga shqiptarët dhe të torturimit e të terrorizimit të tyre, pastaj për shpërnguljen e shqiptarëve në Turqi etj.

Autori Sylë Bimbashin e paraqet kundërveprues tipik të fshatit, i cili është gati të hyjë në shërbim të kujtdo për t'i realizuar qëllimet e veta grabitqare, të ndyta e prapanike. Me intriga, ngatërresa e dënime sipas urdhrit, në një kohë karakteristike të shëmtimeve të pushtetit sllavo-komunist dhe të ndjekjeve e të persekutimeve të shqiptarëve nga organet e sigurimit shtetëror serb, ai do të arrijë të bëhet edhe kryetar këshilli në „pushtetin popullor”, por do të vazhdojë të jetë kundërveprues e intrigant, egoist e grabitqar i pangopshëm, shkues e „pari”, po edhe spiun e vegël e verbër në dorën e huaj vetëm për të ruajtur interesat e veta.

Si i këtillë, Sylë Bimbashi i Nebil Durakut është përfaqësues tipik i klasës së përmbysur në fshatin tonë, që bën përpjekjet e fundit, prandaj më të egrat, në luftë për t'u mbajtur në sipërfaqe dhe për ta kthyer të vjetrën e përmbysur. Të këtillë do ta gjejë dhe do ta shfrytëzojë deri në maksimum operativist i UDB-së, Miloradi, - bartës dhe përfaqësues i forcave të errëta që patën arritur të zënë pozita kyçe në aparatit e sigurimit shtetëror në të gjitha instancat dhe t'u sillnin dëme shumë të mëdha përpjekjeve të përgjithshme në rrugën e zhvillimit dhe të përparimit.

Është karakteristike në këtë mes edhe figura e mësuesit *Ramë*, një injorant sharlatan e karrierist denoncues, i cili, pasi të arrijë t'i zërë vendin një mësuesi të ri, të aftë e përparimtar, që ishte Agroni, medoemos do të demaskohet shpejt faqe botës.

Tërthorazi janë prekur ose janë paraqitur në këtë mes edhe personazhe të tjera të ardhura në fshat ose që vetëm parakalojnë nëpër të, por që gjithashtu kanë luajtur role me rëndësi në jetën e tij në këtë periudhë, si është ajo e operativistit Milorad, pastaj e njerëzve të rrethit - Bedriut, Milanit etj.

Është dhënë këtu edhe një galeri personazhesh të tjera të fshatit që, në mënyrën e vet, plotësojnë mjedisin e një fshati malor, siç është Kosjeri i „Shtrojerës”. Në këtë mes është mjaft karakteristike fytyra pothuajse tragjike e *Ahmetit*, djalosh fatkeq, të cilin i ati e fejon me Hanën, që nga bangat si nxënëse e shkollës fillore dhe, për këtë arsye, Ahmeti detyrohet të largohet nga shkolla - pa e pasë kryer ende - vetëm e vetëm që të mos ishte në të njëjtën shkollë me të fejuarën. Por, janë shumë të ashpra peripecitë që i ngarkohen këtij personazhi të romanit në kohën kur vjen në shtëpinë e së fejuarës për ta pritur derisa të kthehet nga shkolla normale, marrëdhëniet e tij me vjehrrën e qëndrimet ndaj vjehrrit të verbuar etj. Është i rëndë fati tragjik i Ahmetit, të cilin nuk e shohim fajtor as viktimë të botëkuptimeve, të cilave s'ka pasur fuqi t'u bënte ballë, ndoshta, edhe pse nuk ka pasur një baba si Aliu i Hanës. Kësisoj, figura e Ahmetit do të jetë figurë tragjike, më tepër e patjetërsueshme sesa tipike.

Në të vërtetë, këtu dhe në disa motive të tjera të romanit „Shtrojera”, ka pamje që do të duken edhe të konstruktura, siç ka edhe ngjarje që do të jenë veçse ilustrime të regjistruara sa për të paraqitur më plotësisht një kohë dhe një mjedis në sa më shumë përmasa. Kjo gjerësi, me të vërtetë, ndonjëherë pengon dhe e

rëndon veprën. Por, megjithatë, të lidhura mirë dhe të kompozuar në një tërësi fabulative, ato formësojnë rrethin, atmosferën, në të cilën i shohim bartësit e tyre - personazhe të gjalla, prej gjaku e ndjenjash, me botëkuptime e qëndrime të veta, të mishëruara në gjendjet në të cilat i takojmë, të formësuara shkallë-shkallë, autentike, të bindshme.

Prandaj si i këtillë, romani „Shtrojera” i Nebil Durakut lexohet me një frymë, me interesim e me ëndje dhe, në mënyrën e vet, pasuron letërsinë tonë.

IV

I preokupuar gjithnjë nga ngjarjet që i ka parë dhe i ka ndier thellë në shpirt, Nebil Duraku, jo vetëm në romanin „Shtrojera”, sikur i regjistron ato në mozaikun e kohës e të mjedisit të vet, dhe sikur është vetë dëshmitar i gjallë i tyre. Tërë zymtësia e ngjarjeve rrëqethëse, me të cilat është ngarkuar shpeshherë proza e Nebil Durakut, sikur çirret nga zgjidhjet e pashmangshme, nga të gjitha deformimet dhe pengesat që i bëhen popullit të thjeshtë në rrugën e tij të emancipimit e të përparimit në çdo fushë. Por, përfundimet e këtilla në prozën e Nebilit, nuk tingëllojnë të imponuara, artificialisht të kurdisura - pikërisht për shkak të rrethanave në të cilat janë shkruar, dhe të kohës kur janë dhënë për botim, kur vështirë që të mund të botoheshin ashtu si i kishte shkruar në versionin e parë Nebil Duraku. Sepse, pos nëpër duart e recensentëve letrarë, të gjitha tekstet „politikisht delikate”, para dhe pasi të kalonin nëpër duart e tyre, kalonin edhe nëpër duart të „recensentëve” censorë, që bëheshin se ishin më „kompetentë” e profesionistë për të lejuar ose jo botimin e tyre.

Shkrimtarëve siç ishte Nebili, shkrimet e tyre letrare u „nxirrnin punë” edhe pas botimit të tyre. „Ende nuk jam në gjendje të përqendrohem që të shkruaj sa e si duhet... se vijimisht gjendem i shtrirë në shtëpi... por e di se të duhen këto shënime që të punosh - më shkruante Nebil Duraku më 24 shkurt 1979. - „Romanin (fjala është për „Shtrojerën”) e shkrova në vitin 1965/66. U ble në konkursin letrar të „Rilindjes” (qershor 1966). Ngjarja zhvillohet në Kosjer (Runikë) të Drenicës, që përfshin kryesisht fillet e deformimeve në këtë trevë, duke filluar nga masat që të mbyllen klasat e larta të fillores në gjuhën shqipe më 1953/54, masa këto që kishin për qëllim suprimimin edhe të disa shkollave të mesme shqipe në Krahinë, e deri te aksioni për mbledhjen e armëve më 1955-56...” Dhe vazhdon të shkruajë: „Duke ushtruar në atë kohë detyrën e arsimtarit të shkollës fillore, përjetova të gjitha këto peripeci dhe në roman nuk është vështirë të identifikohen të gjithë protagonistët. Nga kjo del se kisha parasysh ngjarjet e njëmendta që u zhvilluan në atë kohë në njërin prej trevave tona më të mbrapambetura, por ndër njerëz fisnikë e bujarë, të cilët e kishin të qartë se shkollimi i fëmijëve të tyre, pikërisht në gjuhën amtare, ishte shpëtimi i tyre, ardhmëria e tyre...” Dhe, në përfundim të letrës së tij, Nebili më shkruante:

« „Shtrojera” u shit brenda muajit. Por pata telashe të mëdha me disa individë - bartës të këtyre deformimeve, të cilët, edhe pse me emra e mbiemra të ndryshuar, për shkak të ngjarjeve - e gjetën veten në roman dhe kërcënuan se do të më padisin edhe në gjyq... »

Bashkë me këtë letër dhe shënimet autobiografike, Nebili m’i dërgoi edhe recensionet e Jakup Cerajës e të Emin Kabashit, të botuara nga një faqe gazete në të përkohshmen „Fjala” të Prishtinës (11 nëntor 1972 dhe 15 maj 1975). „Të lutem, - më shkruante Nebili - këto dy copa gazetash të m’i ruash. Mendoj se këta dy autorë të këtyre kritikave gjithashtu bënë përpjekje t’ia qëllonjë dhe, çfarë është më me rëndësi, s’kanë qenë të ngarkuar me çështje të tjera të kohës.”

Shikuar nga disa pikëpamje, që unë këtu sapo i shënova, proza e Nebil Durakut kërkon t’i kthehemi përsëri - në tërësinë e saj - si kritikë dhe si lexues, se në të do të gjejmë shumë gjëra që ndoshta nuk kemi arritur t’i vërejmë për të gjallë të autorit. E do të shohim, më duket, se edhe në kushte e rrethana më të vështira, në të cilat ka jetuar dhe ka vepruar një shkrimtar si Nebil Duraku, do të mund të bëheshin, e besa edhe të botoheshin, vepra letrare që do ta pasqyronin më gjallërisht realitetin objektiv me përjetimin subjektiv - imagjektiv dhe artistik të autorit.

As që ka nevojë të përmend se nga historia e letërsisë sonë, por edhe e asaj botërore, dimë se në shumë raste vepra të bukura e cilësore artistike e letrare janë krijuar pikërisht në kohë e në rrethana të vështira. Dhe ato, përgjithësisht, herët a vonë e kanë parë dritën e diellit. Ja po e shohin tash dritën e diellit edhe veprat komplete të Nebil Durakut - në saje të angazhimit të pasardhësit të tij të drejtpërdrejtë, djalit Shkëlqim Durakut, e të afërmeve të tjerë të Nebil Durakut, por edhe në saje të shokëve e të bashkëpunëtorëve të tij. Besoj se, të paraqitura kështu, veprat komplete të Nebil Durakut, të shoqëruara edhe me studime të deritashme për veprën dhe personalitetin e tij, do të jenë jo vetëm një „larje borxhi” ndaj tij dhe veprës së tij, por edhe një kënaqësi për opinionin tonë lexues dhe një shkas më tepër për kritikët dhe studiuesit e letërsisë sonë që, me studimet dhe me vështrimet e veta, t’ia afrojnë këtë shkrimtar të zellshëm e të guximshëm dhe veprën e tij opinionit më të gjerë gjithëkombëtar. Sepse, Nebil Duraku ishte shkrimtar e gazetar, depërtues e guximtar, e mbi të gjitha, punëtor i zellshëm që punonte porsibleta, dhe atdhetar i heshtur që, pa pompë e rrahagjoks, mbronte popullin e vet dhe çështjen kombëtare shqiptare.

I këtitillë mbeti në kujtimet tona. Të këtitillë do ta paraqesin veprat e tij të botuara në këtë komplet para opinionit tonë sot e para breznive të ardhme nesër.

dhjetor, 1996

Jakup Ceraja

„Shtrojera”- roman realist

Për romanin e dytë të Nebil Durakut **Shtrojera** është shkruar fare pak dhe kalimthi dhe në mënyrë të pastudiuar mirë, ose në mënyrë mospërfillëse, për të mos thënë edhe përbuzëse.

Nebil Duraku, që me tregimet dhe me romanin e parë ka treguar tiparin e vet prej shkrimtari realist e të lidhur fort me truallin dhe me njerëzit e tij, problemet dhe jetën e të cilëve i njeh dhe i kupton thellësisht. Një rrugë të tillë e ndoqën (dhe e ndjekin) të gjithë shkrimtarët realistë të të gjithë popujve, natyrisht secili sipas mundësisë së vet intelektuale. Nebil Duraku është i vetëdijshëm për këtë të vërtetë, prandaj edhe mëtimi i tij si shkrimtar është të shkruajë e të thotë atë që mundet. Shikuar vetëm nga

kjo pikëpamje, do të shkoqitnim dhe do të paraqitnim drejt e bindshëm veprën e këtij shkrimtari të zellshëm.

Romani „Shtrojera” i Nebil Durakut është shkruar me një stil e gjuhë të rrjedhshme, megjithëse me pak figuracione e rekuizita artistike, por me shumë vërtetësi e guxim. Shihet se, kur gatoi brumin e kësaj vepre dhe e poqi në furrë, shkrimtari u nis nga interesi i përgjithshëm e jo vetjak dhe rrahu e zbërtheu me guxim një problem shoqëror të qenësishëm: ngadhënjimin e së drejtës. Nebil Duraku në romanin e tij „Shtrojera” nuk i la vend trillit të shkrimtarit, por realitetit tonë jetësor, duke i dhënë atij petkun artistik. Meritë e parë e këtij shkrimtari është se shkroi për probleme e ngjarje të së kaluarës sonë të afërme, që i ka përjetuar dhe i njeh mirë, prandaj, ashtu të përgjithësuara, na i paraqet edhe neve. Meritë tjetër është guximi i paraqitjes të së vërtetës në mënyrë lakuriqe e revolucionare, natyrisht duke mbrojtur përpjekjet e shëndosha të shoqërisë sonë.

Ngjarja e romanit „Shtrojera”, si thamë edhe më lart, është e ditëve tona, e së kaluarës sonë të afërme, që zhvillohet në fshatin tonë të prapambetur e me shumë analfabetë. Kur të merren parasysh edhe forcat e errëta të shoqërisë, që vepronin në atë kohë kundër interesave vitale të popullit tonë, janë të kuptueshme divergjencat, konfliktet e mëdha, të cilat ndërseheshin, frymëzoheshin dhe udhëhiqeshin nga njerëz të papërgjegjshëm të organizuar me qëllime të caktuara politike, të cilët kishin gjetur mbështetje në karrieristët dhe demagogët, të gjithë ata që fshati i ka përjashtuar me kohë nga rrethi i njerëzve të mirë, nga oda e burrave, si do të thoshin ata, që tani i shikon me dyshim, me mosbesim e me urrejtje. Vetë mbështetja në këto elemente të forcave, ka shpejtuar edhe dështimin e tyre me turp para forcave përparimtare të kohës, fakt ky që është i theksuar me mjete artistike në këtë vepër.

Ngjarja e romanit zhvillohet në fshatin Kosjer të Drenicës. Anën e shtresës përparimtare e përfaqësojnë në vepër Ali Fetahu, bujk-fshatar, ish-luftëtar i dalluar, me të bijën, Hanën, Agron Spahiu, mësues, përfaqësues i inteligjencies kombëtare dhe persona të tjerë episodikë, që paraqiten në vepër më shumë si ilustrim sesa si figura me rol e individualitet të vet. Anën e pjesës kundërvepruese e kundërshoqërore e përfaqësojnë Sylë Osman Bimbashi, Milorad Stamenkoviqi, Ibër Çpurdha, Ramë mësuesi dhe ndonjë fytyrë tjetër episodike. Ndërsa, grupi i ngushtë i Stamenkoviqit vepron me vetëdije e prapaskenë, rrethi i gjerë i tij vepron pa vetëdije, me frikë nga trysnia. Konflikti i këtyre dy palëve lind me ardhjen e drejtorit të ri dhe me vendimin e fshatarëve për ngritjen e shkollës së re në vend të asaj të vjetrës, e cila nuk i plotësonte as kushtet e domosdoshme për mësim. Kjo kërkesë e drejtë e fshatarëve të Kosjerit me mësuesin Agron dhe me Ali Fetahun në krye, has në kundërshtim të rreptë të grupi i Stamenkoviqit, i cili bënte përpjekje që të mbyllej edhe ajo shkollë që ishte e jo të ndërtohej një e re në vend të së vjetrës. Për atë kohë, ky rast e motivonte mirë dyshimin e grupit të Stamenkoviqit në mësuesin e ri, si element „antisocialist” e „nacionalist”, prandaj fillojnë t’ia presin rrobat me ndihmën e „mësuesit” Ramë, (vegël e verbër e Sylë Bimbashit, e të dy së bashku vegla të Milorad Stamenkoviqit), i cili personifikon fundërrinë e një patriarkalisti e tradhtari, në të cilin jeton etja e hakmarrjes, prandaj në mënyrën më çnjerëzore e të ulët fillon

veprimtarinë shkatërruese kundër mësuesit Agron, i cili që ditën e parë iu bë halë në sy me pikëpamjet e tij prej revolucionari e idealisti të vërtetë, që solli frymë e botëkuptim të ri në atë rreth njerëzish, që ishin mësuar vetëm të kryenin detyrë e urdhra e të ulnin kokën edhe kundrejt ish-drejtorit Ramë, që tani me forcë po kundërshtonte çdo gjë në kohën e vet. Ky protagonist është tipik dhe i domosdoshëm në një vepër si kjo e Nebil Durakut. Kështu, sado që me këtë rast ka mbetur, fatkeqësisht, episodik, është një farë embrioni i romanit, i cili luan rolin e vet mjaft të rëndësishëm në vepër, por që shkrimtari nuk i ka dhënë rëndësinë që do të duhej t'i jepte. Konflikti merr përpjestim tragjik sidomos me aksionin famëkeq të mbledhjes së armëve, që i sjell fuqi e pushtet më të madh grupit të Sylë Bimbashit, që me metodat e rafinuara dhunojnë e shfrytëzojnë deri në palcë fshatarët e frikësuar, të cilëve ua shesin pushkët që ua marrin pastaj me dajak, për t'ua marrë përsëri e shumë herë me radhë. Po gjatë kësaj periudhe „mësuesi” Ramë, me rrethin e vet, arrin qëllimin dhe përjashtojnë Agron Spahiun nga detyra, madje në mënyrë komprometuese. Ky është fundi i një epilogu tragjik dhe fillimi i një tjetri, tragjik për palën tjetër, e cila që tani fillon të ndiejë rrëshqitjen e dheut nën këmbë, sado që në këtë vepër pësimin e tyre nuk do ta përjetojmë, por do ta hetojmë.

Shikuar si tërësi, gjithë ngjarja në roman zhvillohet në dy linja kryesore: *Ali-Hanë-Agron* dhe *Sylë-Milorad-Ramë*, shkrimtari krijon skena dhe prapaska, të cilat veprës i japin gjallëri dhe ndonjëherë edhe dramacitet. Kujtoni për shembull Sylë Bimbashin dhe Milorad Stamenkoviçin me rastin e aksionit të armëve, kur nga një odë fshati, si nga një pusi gjuajnë shenjën e fitimit në mënyrën më të poshtër çnjerëzore, dhe shesin me çmime të larta armët që fshatarët i sjellin aty me një mijë mundime, duke i gjetur e duke i blerë ku janë e ku s'janë edhe jashtë Kosovës. Të kujtojmë atë skenë tragjikomike të vrasjes së *zogut* të mërdhirë nga dimri, që u futet në dhomë posa ia hapin dritaren, në të cilin shtien me revole pa mëshirë njeriu. Ky është një simbol shumë i qëlluar, nëpërmes të cilit autori jep portretin shpirtëror e moral të grupit në fjalë. Kemi edhe disa skena të tjera joshëse në këtë roman, por kemi edhe disa skena të pasendërtuara mirë, të ngushtuara, të cilat herë-herë e zbehin tërë ngjarjen që na duket se në disa vende është dashur të zgjeroheshin edhe më shumë për të arritur ngjarja kulmin natyror dhe bindës. Bie fjala, rasti i mbledhjes së fshatarëve për kundërshtimin e atyre që pengonin ndërtimin e shkollës dhe për marrjen e vendimit për ndërtimin e shkollës së re, ilustron bindjen tonë se shkrimtari mu aty ku i duhej të përqendrohej më së shumti, duke derdhur gjithë filozofinë e tij për të paraqitur motivin që trajton ai, shpejton dhe ikën nga ballafaqimi joshës. Kështu, kur lexuesi me interesim pret shfryrjen e mllefrit të fshatarëve të ndershëm kundër atyre demagogëve, që po i mashtronin e dëmtonin me gjuhën e tyre të mprehtë, që dinë të qëllojnë e të kripin mirë, të të bëjnë budalla për pesë para, ai dëgjon nga gjithë ai grup vetëm fjalët e mësuesit Agron, që me këtë rast nuk janë aq joshëse për lexuesin dhe fjalët mjaft të mprehta e të qëlluara të Ali Fetahut, që lexuesi i ka hasur edhe më parë në vepër dhe do t'i hasë edhe më vonë. Si duket, shkrimtari i është përmbajtur me vetëdije etikës filozofike fshatare: „Gojës kapak, trupi rehat!”. Edhe pranimi i dhëndrit (të fejuarit të Hanës) në shtëpinë e Aliut para se të martohej

me Hanën, nuk na duket rast tipik, sado që shkrimtari e motivon disi nga një anë (kujto verbërimin e Aliut pas torturave!), por harron se ai është bir i një fanatiku të Kanunit dhe të fesë, që më parë në vepër e ka përshkruar si të papajtuashëm me ato që sjell jeta e re, me Aliun. Për të mos u turpëruar para fshatarëve të tjerë, ai e ndal të birin nga shkolla që të mos shihej me të fejuarën, Hanën, të cilën i ati nuk pranon ta ndajë nga shkolla. Si duket, shkrimtari me këtë rast ka pasur parasysh vetëm mundësinë e një rasti të tillë e jo tipikën, e cila duhet të trajtohet në art. Aq më keq, ky rast përsëri përfundon me ndarjen e Hanës dhe të Ahmetit, në mënyrë shumë të përcipte e jo bindëse, sado që shkrimtari nga nënteksti na jep të kuptojmë se kjo po ndodhte aq lehtë për shkak të marrëdhënieve intime të Ahmetit me t'ëmën e Hanës gjatë jetës së tij në atë shtëpi, argument ky i panjohur për Zenë Ferizin dhe bashkëvendësit e tij, të cilët për prishjen e një fejeje në mënyrë të tillë, do të kërkojnë „fytyrë”, llogari e shpërblim të madh, i cili kërkon flijime. Të kalosh vetëm me konstatime një përfundim të një ngjarjeje të këtillë, domethënë të mbetesh në sipërfaqe të realitetit tonë fshatar, të ngutësh për të përfunduar dhe të zhgënjesh lexuesin, të cilin deri aty e ke mbajtur në duar e të mbërthyer për vete. Këto, pra, ishin dy vërejtje serioze që, sipas mendimit tim, mund t'i bëhen kësaj veprë në pikëpamje të shtruarjes së materialit dhe të zhvillimit të ngjarjeve e të motivimit të tyre, sado që ka edhe ngutje e kapërcime të tjera, të cilat, siç u tha edhe më lart, e zbehin veprën si tërësi. Si çdo vepër e këtillë, edhe ky roman ka një galeri personazhesh të dorës së parë dhe të dorës së dytë dhe të tillë që në vepër paraqiten vetëm sa për ndonjë krijim situatë a zbërthim të materies letrare, që trajton, e cila, vërtetë, në këso rastesh kërkon edhe personazhe dytësore, që lexuesit nuk i lënë mbresa, por që kanë rolin dhe rëndësinë e vet. Ndodh që portreti i personazhit të dorës së dytë të na dalë, nganjëherë, më i plotë se ai i dorës së parë, më i tipizuar. Një dukuri e tillë në këtë roman është Zenë Ferizi i Kotorrit, ose mësuesi Ramë, sado që këtyre duket se shkrimtari nuk u kushton aq kujdes për t'i nxjerr sa më të përpunuar. Ndoshta për vetë rolin që luajnë në jetë, njëri fanatik i kanunit dhe i dokeve, e tjetri demagog e injorant i inteligjencies, këto dy personazhe na nguliten menjëherë në kokë dhe s'na shqiten dot, sado që hetohet se shkrimtari gjithmonë ndaj tyre është sjellë me përbuzje e përçmim, me mospërfillje, me dëshirë për karikaturimin me çdo kusht, ndonëse janë në të vërtetë tragjikë e jo komikë.

Portretizimi i personazhit më të rëndësishëm negativ, Sylë Bimbashi, dhe i shokut të tij, vegël e të cilit është Sylë, është dhënë i plotë dhe i rravijëzuar në shumë pikëpamje, i gdhendur me mjeshtëri dhe i tipizuar bindshëm. Ky fakt na bind se Nebili di dhe ka mundësi të na japë edhe personazhe të shartuara mirë. Krahas këtij, madje shumë më i latuar është personazhi pozitiv i Ali Fetahut, i cili bart gjithë tragjikën e luftëtarit të zhgënjyer nga kundërshtarët e socializmit, dhe të prindit e patriotit të ndershëm shqiptar, që askujt s'ia bën e as s'ia kujton të keqen, por as s'e duron të keqen dhe, më në fund, për këtë „kokëfortësi” e pëson fizikisht, por ngadhënjën mbi të keqen: shkolla ndërtohet, Hana kryen normalen dhe del mësuese e parë në fshat, Sylë me shokë diskualifikohen politikisht dhe gjunjëzohen para forcave përparimtare, para arsimdashësve. Prandaj, mund të pohojmë se Ali Fetahu

si personazh romani, është një ndër më të qëlluarit në prozën shqipe që krijohet në Kosovë dhe meriton një vend nderi. Përkundër këtij, portreti i Hanës, i cili në vepër zë vendin kryesor për nga vëllimi, ka dalë i zbehtë, fragmentar, jo aq bindës e tipik. Shkrimtari, duke pasur simpati të dukshme ndaj këtij personazhi, që është e kuptueshme dhe e arsyeshme, shpeshherë e idealizon dhe kështu na nxjerr më shumë një personazh romantik e levarash sesa real. Lexuesi pret me të drejtë që shkrimtari me Hanën të krijojë tipin e intelektualës së re fshatare, e cila, e ndihmuar nga shoqëria dhe i ati, do të thyejë të gjitha pengesat dhe do t'i sjellë fshatit dritë e hov të ri, në vendin e Agronit të përjashtuar me kohë nga arsimi, i cili dikur kishte ndihmuar shkollimin e saj. Hana ka dalë në disa raste personazh ekletik (kujtoni bisedat e saj me shoqet e shkollës dhe ndikimin që bëjnë ato në të me botkuptimet e tyre cinike mbi jetën, mbi fshatarët e mbi punëtorinë), dhe ekletike në mendime fundamentale të jetës (kujtoni luhajtjet e saj të dashurisë!). Për të na dhënë portretin e vërtetë të një Hane, siç e ka menduar shkrimtari, është dashur një thellim psikologjik në mëdyshje e hapa të rëndësishëm jetësor. Sa do të ishte më fatlume lidhja e saj me Agronin, vendin e të cilit do ta zërë edhe në vepra, jo me Yllin, lidhje kjo e mundshme, por jo tipike dhe e qëlluar për këtë rast, pranohej dramaciteti i veprës në kulmin e tij bie në fashë të plotë dhe bëhet një zgjidhje vetëm për t'u mbyllur vepra solemnisht. Sjellja e Hanës në familje gati në mënyrë arrogante, sidomos kur të merren parasysht flijimet dhe dashuria e t'et tani të verbër mu për shkak të këtyre përpjekjeve për të cilat e di edhe Hana, nuk na japin tipin e Afërditës së re, për të cilën fshati ynë i prapambetur, më në fund, do të bënte lum, por tipin e një mohuese e të të mirave të dhuruara nga të dashurit e saj, të cilën fshati do ta shikojë me dyshim një kohë të gjatë. Mendoj se ligjet kanunore nuk thyhen me forcë, por me arsye e logjikë, me argumente e durim, me mësim e shembuj bamirësie. Këto virtyte duhej t'i kishte Hana e shkolluar për ta plotësuar besimin e atyre që i besojnë dhe presin prej saj. Gjithë kjo nuk do të thotë se Hana, si na është dhënë këtu, nuk është protagonist i mundshëm dhe i argumentuar në mënyrën e vet, që ka edhe shumë anë pozitive, sidomos përpjekjet e saj për ta mësuar Ahmetin (të fejuarin) dhe për ta ngritur atë në nivelin e saj të arsimit. Shumë veprime të një natyre të këtillë në fshat, sidomos gjatë pushimeve shkollore, do ta formonin Hanën si protagoniste të kërkuar në jetë.

Agron Spahiu, mësues përparimtar, i përshkruar dhe i tipizuar shumë mirë, bartës i denjë i frymës së re në mesin tonë, personifikim i idealit të vërtetë, bosht i romanit, sipas mendimit tim, është protagonist i më fatkeq në vepër nga ata pozitivë, mu pse shkrimtari e mënjanon, jo vetëm nga arsimi, por edhe nga vepra në tërësi, që mendoj se nuk është dashur. Kuptohet, shkrimtari më këtë rast ka dashur të thotë me heshtje se ne e kuptojmë që njerëzit e tipit të Agronit, në kushtet e paraqitura nuk mund të veprojnë, por kjo nuk është e bindshme. Ne si lexues, ku më shumë e ku më pak, do ta donim Agronin përherë të pranishëm në vepër, qoftë edhe vetëm përmes Hanës, Aliut dhe shokëve të tyre, sepse një njeri si Agron mbetet me frymë e vepër përherë i pranueshëm në mesin e njerëzve të mirë e të drejtë.

Protagonistët e tjerë, kështu si na janë dhënë, shumica janë të nevojshëm dhe të qëlluar, por nuk i kanë individualitetet artistike, prandaj nuk po flasim për ta, vetëmse

po mjaftohemi me konstatimin se ata meritojnë nderim. Si gjë pozitive vërehet me këtë rast se shkrimtari ka ditur të krijojë specifika gjuhësore e shprehimore te kryepersonazhet (shih shprehjen e Sylë Bimbashit: „pas po!”) etj... Gjithashtu romani ka një stil të rrjedhshëm e gjuhë të kulluar.

Në fund, mund të them se e gjithë ngjarja në këtë roman është dhënë me vërtetësi e realizëm, me frymëzim e ndërgjegje, por pa thellim të duhur psikologjik dhe pa dramacitet të mjaftueshëm.

„Fjala”
nëntor, 1972

Emin Kabashi

Historiku i rritës sonë

Rrita e krijimtarisë shpirtërore

Nganjëherë jemi të prirur të flasim dhe të shkruajmë vetëm për veprat të cilat, në të vërtetë, kanë trajtuar kënde të llojllojshme jete, dhe të cilat, na e merr mendja se janë të mira, ose vetëm me pak të meta. Kjo është e mirë, nëse nuk injorohet mesatarja dhe më pak e mira; herën tjetër qëllimi ynë është i drejtuar vetëm nga interesimi social i autorit në vepër, dhe në faktin se, sa ka pasur ai aftësi që t'i gjallërojë problemet që ka marrë në shqyrtim. E, kur na rastis të lexojmë ndonjë vepër, e cila, për një arsye a për një tjetër, ose vetëm i ka cekur, ose vetëm pjesërisht i ka gjurmuar

problemet, atëherë i varim buzët në shenjë moskënaqësie duke mos marrë parasysh asnjë rrethanë dhe duke parë vetëm me një sy.

Letërsia jonë, kjo që krijohet në Kosovë, është në rritën e saj, andaj është e pamundur që ajo të ketë aftësinë e trajtimit të problemeve jetësore në nivel me simotrat e saj evropiane. Këtu nuk lë gjurmë vetëm tradita e shkurtër kohërisht, po edhe kushtet specifike në të cilat ka filluar të lëshojë ajo shtat. Arsyet e shkaqet janë parë disa herë drejt, janë cekur disa herë drejt, megjithëse ka pasur raste kur kemi qenë në gjendje edhe t'i injorojmë të mbërrimet tona. Kështu ndodhë ndonjëherë, ngase na mungon përvoja krijuese dhe ngase nuk jemi ende në gjendje, së paku, të veçojmë kulmet nga brumi i një letërsie. Kjo vlen sidomos për këtë tonën, e cila në këtë dhjetëvjetëshin e fundit ka bërë kthesa serioze, si në pikëpamje sasiore, po ashtu edhe si cilësi. Në shtatëzimin e kësaj letërsie është e pamundur të kërkojmë gjithmonë përsosmëri, as edhe në të rrëfyer kur është fjala për romanin.

Prandaj është e kuptueshme të shkruhen, vepra mesatare, asosh që përbëjnë brumin e një letërsie. Këtu nuk e kemi fjalën për ato krijime që duke vrapuar mbas shëmbëllimeve, përveç që kanë humbur autoktoninë, kanë mbetur vetëm krijime formaliste.

Të dhënat historike - si dëshmi

Në mesin e atyre krijuesve, veprimtaria e të cilëve përbën brumin e një letërsie numërojmë edhe Nebil Durakun. Romani i tij **Shtrojera**, me gjithë vërejtjet e shumtë, është një vepër e rëndësishme, nëmos për asgjë tjetër, për faktin se e para ka trajtuar një problematikë mjaft specifike në rrugën e zhvillimit tonë.

Në ato 179 faqe libri, autori e kishte të pamundur të përfshinte gjithë tërësinë e atyre viteve. Pra, shkrimtari në disa raste është mjaftuar vetëm duke vënë në pah një të dhënë. Mirëpo, këtu del sheshazi dëshira e shkrimtarit që të përfshijë sa më tepër materie. Dhe në këtë dëshirë, autori i „Shtrojerës” është ngatërruar në kohë. Koha ku e vendos ngjarjen, hetohet që nuk është e përcaktuar sa duhet dhe vërehen kapërcime që nganjëherë janë aq pa vend, sa sheshon qartë ndarja në mes të kapitujve, po edhe brenda tyre. Aty-këtu duket sikur është hequr ndonjë pjesë, thuajse, me dhunë, ose pa farë kriteri. Tërësia e veprës deri në kapitullin e dhjetë e të njëmbëdhjetë ka dalë e zbehtë. Shkrimtari, thuajse nuk ka pasur fuqi t'i shkrijë problemet e ngjashme ose të afërta, të kohëve të ndryshme, historikisht jo të largëta - në një kohë. Ky cungim në ngjarje jo vetëm që e bën të vështirë për t'u kuptuar tërësia e shkrimit, por bën të mundshëm edhe ngatërrimin e periudhave kohore, kështu që lexuesi vështirë e përcakton se për kë, për se dhe për kur është fjala. Kjo ndodh edhe atje ku shkrimtarit, nga dëshira e madhe që të përfshijë sa më shumë ngjarje, kronologjia e të rrëfyerit i ka ikur nga duart, andaj edhe bindja është zbehur.

Sidoqoftë në vepër janë trajtuar mjaft probleme që asokohe kishin peshën e tyre në rrjedhën e historisë. Nga kryesoret është arsimimi i popullit dhe rruga e zhvillimit të tij. Me këtë rast po shtojmë se shkrimtari ka pasur aftësinë e përgjithësimin të këtij

fenomeni që na duket unik për mbarë këtë trevë, ose, mbase, gjendja ishte kudo e ngjashme.

Në vorbullën e ngjarjeve dhe në dinamikën e rindërtimit të vendit u përbiruan edhe elemente të atillë të cilëve nuk u flente në shpirt rrita e kosjerasve të vegjël, ua prishte planet *Hana* e Kosjerit, një shkollare që nesër jo vetëm do t'ia hapte sytë t'et (i cili, ndonëse i verbër, shikonte më mirë se të tjerët me dy sy), po edhe do t'ua nxirrte në shesh mëkatet e *Sylë* Bimbashëve e *Milorad* Stamenkoviçëve me shokë. Andaj ata nguten që punëve t'ua presin hovin që në fillim, filizave t'ua ndalin lëngun që në lule, fëmijëve t'ua ndalin rritën që në vegjëli. Dhe, ç'është më e keqja, vlera e veprimeve të tyre ishte shumë e madhe. Njerëzit e këtillë nuk ishin të verbër. Ata përveç rrjedhës së historisë, që nuk e kuptuan kurrë, për të tjerat ishin shumë largpamës. Largpamësia më e madhe e tyre ishte se e kishin kuptuar se, po të mbeteshin fëmijët si baballarët e tyre, ujët shkonte në mullinin e tyre.

Sylë Bimbashi me shokët e ngre zërin për të mbyllur klasët e larta të shkollës së Kosjerit. Jo pse shkolloheshin fëmijët, po pse mësonin vetëm në një gjuhë, pse i humbnin mësitnitë dhe ngase e kishte të qartë se ata fëmijë nuk do të ndjeknin gjetiu mësimet, sepse njihte mentalitetin dhe gjendjen ekonomike të prindërve të këtyre fëmijëve. Dhe, më në fund, sepse Sylë Bimbashët me shokë nuk i linte të qetë prania e arsimitarëve, përhapësve të njohurive dhe të dritës kudo në vendin tonë. Kështu, siç thotë populli, ata nuk lënë vend pa i futur hundët, dhe për këtë punë u duheshin njerëz-vegla të atillë, që nuk kanë asgjë të veten, po janë tjetërsuar në hiç. Është interesante historia e zhvillimit dhe e rritës sonë, se kishte faza kur edhe hiçet luanin rolet e mëdha të Jagove dhe vranin e kthjellnin, dhe thurrin rrugët e fateve të njerëzve si pa asgjë të keqe.

Viktima të hienave të këtilla ishin kryesisht të rinjtë, ata që kishin kuptuar drejt zhvillimin e shoqërisë, andaj nuk pajtoheshin me marifetllëqet e tyre. Këto, mospajtime, sado që dukeshin pa efekt, ato nuk mbesin pa jehonë. Jehona më e madhe ishte hapja e shkollave aty ku edhe Hana pa dritën e diellit. Rrita e Hanës, si rritë e brezit të saj, është dhënë bukur dhe përmes gjithë atyre kundërthënieve që karakterizojnë zhvillimin historik të çdo shoqërie.

Mirëpo, kontradiktat shoqërore në trevën për të cilën shkruan N. Duraku, kishin specifikat e veta, të cilat mbase, në atë mënyrë shfaqeshin vetëm në mjedise të caktuara. Ndryshe nuk mund të shpjegohet ai veprimi sharllatan dhe i ndytë i Sharoviçit, i cili, pa pëlqimin e asnjë organi, dërgon në shkollë, për mësuese të muzikës, një „këngëtare” kafenesh. Ata kishin shkuar edhe më larg, kishin sjellë aty mësues gjysmakë, vegla të tyre, që jo vetëm jepnin njohuri të rreme, po të gjymtonin edhe në shpirt. Ç'është më e keqe, elementët e këtillë edhe ngadhënjenin, merrnin nën udhëheqje vendet kyç dhe ashtu, simbas skemave të tyre, të përcaktuara dhe afatgjata, edhe vepronin. Kur themi ngadhënjenin, nuk kemi parasyshtuar shuarjen e anës së kundërt-të mirës, që në vepër e përfaqësojnë *Agron Spahiu*, *Aliu*, Hana e të tjerë. Atëherë, si është e mundur që në ngadhënjimin e së keqes, të rritet e mira. Rrita jonë, në ato vite nuk ishte aq shtathedhur, po me gjithë kontradiktat, ne rriteshim. Kjo kurorëzohet me ruajtjen e shkollës (që të mos mbyllet), kur Ali Fetahu dërgon të bijën

në shkollë, kur kjo emërohet mësuese: dashuron pa recetat e Sylë Bimbashëve dhe kur, thuaja vetë, zgjidh problemin me të ish-fejuarin. Por, as këto pak punë (!) nuk kryheshin pa sakrifica. Nga këto, në vepër është dhënë mjaft bukur çështja e Agronit. Largimi i tij nga puna bëhet në mënyrë aq idiote, sa edhe lexuesi të ndiejë neveri ndaj atyre që caktonin kallëpet e fatit të njeriut.

Sado e vogël të duket kjo fitore, sado të duket si ndërmarrje individuale, shkollimi i një Hane, punë e Agronit dhe e Aliut, ndonëse si tërësi vërtet nuk kap përmasa të gjera, megjithatë si vlerë, për atë kohë e edhe për sot, peshon rëndë. Në një mjedis të këtyllë, çfarë ishte ky yni, me aq antipode, ecja e Hanës, si simbol i së resë (jo si emër), po si ndryshim, ishte e vështirë të realizohej përmes një sërë pengesash, mënyrash dhe formash të ndryshme.

Disa veçori të personazheve

Kontradiktat e këtylla shoqërore e kanë detyruar shkrimtarin që edhe konfliktin e ngjarjes në vepër ta mbështesë këtu. Kështu janë krijuar „taborret” e personazheve me synime dhe kahe të kundërta. Por, këtu nuk është çdo gjë në rregull. Disa fytyra, qoftë pozitive, qoftë negative, nuk janë punuar më me përkushtim, nuk janë gjurmuar sa duhet, andaj njerëzit e këtyllë, në punë, në lëvizje, në jetën e tyre kanë dalë të ngathët dhe jo sa duhet bindës. Në ndonjë rast, ndonjë personazh, që, duke marrë parasysh kohën dhe mentalitetin e atyre anëve, nuk mund të kishin gjë në dorë, janë ngarkuar me „gjynahe” të tepërta, siç ndodh me Shahen. Kjo është edhe më pak e arsyeshme, kur dihet se nëna për fëmijët, veçmas për vajzat, është shumë më e afërt dhe lëshon më tepër pe. Vërtet, shkrimtari është përjekur ta arsyetojë me jetën, martesën dhe fatin e saj, po kjo nuk është sa duhet bindëse. Na duket edhe më pak bindës fakti që një grua (nënë) e atyre viteve të ketë farë iluzionesh me të fejuarin e së bijës, edhe pse, mbase, ka mundur t’ia zgjojë ato ndjenjat e fjetura të një rinie, si duket të hovshme, zhvillimi fizik i Ahmetit. Në këto ndjenja nuk ka asgjë njerëzore, aty hetohet vetëm nevoja e shuarjes së epsheve, që Shaha ka mundur t’i realizojë në drejtim tjetër. Mëgjithëkëtë, nuk ka rregull pa përjashtime. Andaj, kështu e ngjeshur me të gjitha këto etiketa të zeza, ajo si fytyrë del më neveritëse se Sylë Bimbashi e Milorad Stamenkoviqi. Kështu mund t’i shihet për të madhe shkrimtarit, ngase nuk ka treguar sa duhet kujdes në sistemimin dhe rëndësinë e ngjarjeve, andaj problemit të dorës së parë ia zë frymën një tjetër, i një rëndësie të dorës së dytë dhe i një përmase më të vogël shoqërore. Edhe nëse mendojmë se synimi i shkrimtarit ishte që përmes problemeve familjare t’i paraqiste ato shoqërore, nuk është e plotë ngase ato janë edhe më të ngushta se problemet familjare.

Të shkojmë me radhë. Sylë Bimbashi me shokë është fytyrë tipike me çfarë mjedisi ynë asokohe ishte qendësuar në çdo anë. Ata ishin pjellë e një propagande shthurëse (edhe më keq) që realizohej nga lart-poshtë. Shkrimtari ka pasur aftësinë që të zinte disa çaste kyç të psikologjisë së tij, në mënyrë që të na e japë sa më të plotë edhe si qenie shoqërore. Ai është njeri pa asgjë të veten (përjashtojmë këtu

aftësinë e shkuesit), i cili për të mbrojtur lëkurën vet, duke parë drejt se në ç'anë është „drejtësia”, u vihet në shërbim herë njërit e herë tjetrit.

Në rrethin e një shoqërie, ku hante, ai edhe mësonte të gjitha ato veti që për njerëzit e asaj treve nuk ishin të zakonshme. Sa shpejt njeriu-kukull paska aftësinë t'i bëjë të vetat dhe t'i thithë të gjitha ato „mësime” që i servohen. Pa e njohur rrethin e tij, do të na duket e huaj çdo gjë që bën ai: edhe morali i tij, edhe jeta e tij, edhe ai vetë. Por, kjo përshtatje vargore ka lënë gjurmë edhe në botën e tij të brendshme. Ai, tashti, ia di të gjitha huqet eprorit të tij dhe pa tjetër duhet t'ia plotësojë, ngase „lodhej bre vëlla”, „lente qetësinë e familjes vetëm për të mbajtur rregull, e ne, mos t'i gjendemi për kaq punë” - i tillë për afërsisht, do të ishte arsyetimi i tij për punët që kryente. Ai, na duket i mjerë në veprimet e tij, është shumë i ngathët dhe tarallak. Megjithatë, në veprime ka atë energjinë e tij, po kjo energji ka brenda një dozë paralize, apo, mbase, lexuesi fiton këtë bindje ngase ai nuk vendos asgjë me kokën e tij - ose më mirë, ai nuk ka fare kokë.

Çështja që është diskutuar lidhur me patriotizmin e personazheve, edhe këtu është e diskutueshme. Në të vërtetë shkrimtari ka ndjekur atë shembullin bardhë-zi dhe kështu i ka kategorizuar personazhet. Andaj, në vepër fytyrat kanë dalë ose gjithmonë të mira, ose gjithmonë të këqija, kur është fjala për heronjtë negativë. Në roman ky grupëzim ka ndjekur lindjen e jetës. Një njeri nuk është i keq për të gjithë, siç nuk është as i mirë, ngase gjithsecili ka adhuruesit e tij, varësisht se cilës parti i takon. Mirëpo, këtu mbetet jashtë shqyrtimit çështja e individit si pjesëtar i shoqërisë. Në veprimet e Sylë Bimbashëve nuk ka asgjë të përgjithshme dhe thujse ata, në këtë aventurë kanë hyrë nga oreksi i tyre individual. Kështu, problemi i shtruar dhe i ndjekur drejt deri diku, tashti zbehet, ngase ka humbur përmasën e gjerësisë shoqërore. Kjo është njëra anë dhe, kur mendojmë se edhe në këtë këndvështrim ata kanë „miqtë” dhe armiqtë e tyre, atëherë lind tjetër problem.

Antipodi i tij, shikuar nga të gjitha anët, ishte Agron Spahiu. Bota e tij e brendshme është gjurmuar më bindshëm dhe më me sukses, kurse sa i përket linjës së trajtimit, është ndjekur po një rrugë, me përjashtim se ata u takojnë skajeve të kundërta të litarit. Rjedhimisht edhe përgjegjësia e tyre shoqërore është e kundërt.

Edhe pse nuk ka gjurmuar sa duhet personazhin e Milorad Stamenkoviçit, ai papë, në vija të trasha, ka dalë mjaft bindës. Mbase, as që ka pasur nevojë të shkruajë më tepër për të, ngase edhe si e këtille ka dalë e plotë fytyra - maska e tij. Nëse në gjërat e këqija, të shëmtuara, kërkojmë bukuri estetike, kjo u mungon këtyre personazheve, po është shumë bindës realiteti shëmtues i veprimeve të tyre që ndonjëherë kalon edhe në sadizëm. Andaj, nëse këtu mungon e vërteta artistike, e vërteta reale (ajo jetësore) nuk mungon. Këtu mungon diçka tjetër. Hetohet sheshazi se shkrimtari nuk i ka punuar me përkushtim të duhur dhe nuk i ka dashur kurrë personazhet e tij negative, e kjo e ka penguar në realizimin më të sukseshëm të këtyre fytyrave.

Njerëzit e këtille çdo gjë që realizojnë, e bëjnë në emër të rregullit dhe të drejtësisë, që asnjëherë nuk i zbatojnë vetë. Kjo është bazë, që mungon e përkushtimit

të shkrimtarit. Nga ky kënd do t'i vërë në lojë, dhe, përveç heqjes së maskave, edhe t'i tallte, e kamxhikosja do të pasonte vetiu.

Kur e kemi fjalën për personazhet negative, ato i ndajmë në dy grupe: në satrapë dhe në injorantë. Të dy kategoritë kanë nga një përfaqësues tipik, punuar bukur mirë, për të cilët folëm. Fytyrat e tjera kanë mbetur të pagdhendura sa duhet, dhe shpesh duken vetëm si hije, po jo me funksionin e hijeve, se ashtu do të dilnin të plota. Me siguri nga ky shkak shumë pjesë të veprës nuk janë realizuar si duhet, veçmas pjesa e parë e librit.

Ka raste kur autori vetëm ka shtruar disa çaste të disa ngjarjeve historike, pa u thelluar në to dhe kështu ato kanë dalë si rrëfime tregimtare. Kështu ndodh, sidomos me pjesët ku bëhet fjalë për aksionin famëkeq të mbledhjes së armëve. Shkrimtari, thuajse nuk i ka kushtuar kujdes të duhur këtij problemi, andaj ai ka mbetur nën hijen e interesimeve të tjera, që mbase nuk peshojnë aq rëndë në tërësinë e problematikës së shtruar. Ka vende ku ngjarja është shtjelluar me mundim, ose hetohet ndonjë cungim i përdhunshëm. A është bërë kjo ngase autorit i ka munguar përvoja krijuese, apo nga dëshira e madhe që të përfshijë sa më shumë materie a për arsye të tjera, mbetet çështje e kohës, e cila, siç thotë populli, nuk lë asgjë për atë botë. Mirëpo, në libër ka edhe pjesë të bukura, analiza të holla shpirtërore, paraqitje të mrekullueshme të çasteve, si në kapitullin e katërmbëdhjetë. Kjo është pjesa më e fuqishme e librit, ku për mrekulli është shpaluar bota shterpë e një injoranti: Sylë Bimbashit dhe e një satrapi: Milorad Stamenkoviçit, vërtet dy hiena, dy fundërrina nate.

„Fjala”
maj, 1975

Arsim Kajtazi

„Shtrojera” – sfidë e jetës nëpër kohën e letërsisë

Shkrimtari i mirënjohur Nebil Duraku, tashmë përjetësisht pushon në dheun e Kosovës, në dheun që aq shumë e deshi dhe për të cilin bëri aq shumë, duke dhënë një kontribut të çmueshëm në shumë lëmenj. Në fillim si veprimtar i arsimit, e më pastaj gazetar, publicist dhe shkrimtar, për të gjallë të tij la një vepër madhore, që në vete pleks vlera të çmueshme kulturore, edhe sot aktuale, për një komunikim të gjerë intensiv dhe interesant. Pikërisht ky dimension i mbijetimit kulturor të vlerës

bën që vepra e tij të shikohet me tërë kompleksitetin e saj, duke e nxjerrë kështu në pah figurën e *Nebil Durakut* ndër krijuesit e spikatur letrar, romancier, tregimtar, dramaturg, publicist, etj., i cili u zotua që sa më qartë dhe vazhdimisht të komunikojë me bashkëkohanikët, po edhe me brezat që do ta kenë kërshërinë dhe interesimin për veprën e tij.

Kredoja e tij krijuese është ajo që ne e quajmë *gjedhe e letërsisë së kohës*, apo një standard i letërsisë aktuale në kuptimin më të gjerë të fjalës. Pra, emëruesi i përbashkët do të ishte ky: bashkëkohësinë e ka kërkuar në një formë të gërshetimit të përvojës së letërsisë shqiptare me kahet e letërsisë realiste të moderuar. Në këtë përpjekje të tipizimit përgjithësues poetik dhe teoriko-letrar, e kemi fjalën për prozën e Durakut, romani **Shtrojera**, mendojmë se mbetet vepra më përfaqësuese e kredos së tij letrare, e materializuar letrarisht dhe artistikisht.

Romani „Shtrojera” - arritje e shkathtësisë krijuese

Për romanin „Shtrojera” nuk është e lehtë të thuhet diçka më shkoqitur, nga shkak se autori për të gjallë të tij, në muajt e fundit të jetës, derisa po i bënte ballë lëngatës së sëmundjes, i hyri punës së ripunimit, ose, më saktë, të krijimit të variantit „*botimit të tretë të përmirësuar*”, do të shprehet fare thjesht autori përmes këtij shpjegimi në fillim të romanit, që kështu, vetëm me pesë kapitujt e ripunuar, mbetet një vepër e pakryer, një *torzo* tragjike për nga jeta e saj gjysmake. Kësisoj, varianti gjysmak, dhe romani në fjalë me dy botimet nga Redaksia e Botimeve „Rilindja” e Prishtinës, botimi më 1969 dhe ribotimi i parë më 1971; ribotimi në Tiranë, më 1983 nga Shtëpia Botuese „Naim Frashëri”, dhe tani ribotimi më i ri në këtë *komplet veprash postmortum*, si variant i pakryer, (të cilën me kërkesën e autorit, për të gjallë të tij, i hymë ta kthenim nga gegërishtja letrare në gjuhën letrare të njësuar, për të krijuar kësisoj deri diku përshtypjen e një vepre të tërë, të konsoliduar me një shprehje letrare?!..), tregojnë për format e jetesës së këtij romani. Megjithëkëtë, ky fakt na bën të flasim për *katër variante*, një ai i pakryeri dhe tragjiku; i dyti: pjesa e ripunuar nga autori së bashku me pjesën e „translitteruar”; i treti që, do të thotë i pari (1969, 1979), dhe i katërti, ai i botuari nga Shtëpia Botuese „Naim Frashëri”, 1983, i cili pa dijen e autorit, për të gjallë të tij, është letrarizuar kryesisht, duke ruajtur dialogun dhe monologun në gegërishten letrare të kohës, për ta futur kësisoj romanin në skemat e realizmit socialist (tipizimit të personazheve përmes rrethanave dhe gjuhës autentike). Mendojmë se është e udhës të kujtohen këto variante, sidomos kur mëtohet një qasje më e hollë dhe më profesionale për qëllime interpretimi multidisiplinar.

Sidoqoftë, „Shtrojera” edhe me këtë variant, që kësaj radhe zë vend në kompletin e veprave të Durakut, është një vepër përfaqësuese dhe në vete ajo pleks tërë përvojën e romancierit realist, edhe si preokupim tematik (si i tillë, në këtë pikëpamje është ndër veprat e para të letërsisë shqiptare të krijuar në Kosovë, që merret me fatin e njeriut - tipin e intelektualit të ri, të ballafaquar me rrethana

antikulturore, gjenocidale dhe etnocidale; me sfidimin e dogmatizmit të socializmit dhe të komunizmit pansllavist antihuman dhe antishqiptar...); po edhe në pikëpamje të shprehjes letrare, gjithashtu shpreh prirje letrare romanore, që modernitetin e kërkon mbi përvojën e letërsisë realiste të moderuar, posaçërisht në pikëpamje syzheore-kompozicionale; mënyrën e zbërthimit dhe të tipizimit të personazheve. Nga tërë opusi krijues, ndër veprat e tij më interesante mbetet „Shtrojera” me dy variantet, që shquhet për një prirje të rrëfimit realist, siç është edhe tërë krijimtaria e tij letrare, që për bazë ka këtë shprehje ideoartistike. Në këtë vazhdë të përpjekjeve për gjetjen e tipit të romanit, pra, të tipizimit të tij, do të thoshim se jo vetëm ky roman, por edhe të tjerët, do t’i përkasin tipit të romanit (nënkupto: letërsisë) realist të moderuar. Edhe Nebil Duraku do të mund të radhitej në mesin e atyre krijuesve, i cili ka bërë përpjekje që *metodën e realizmit socialist*, të mos e përqafojë e kuptojë aq ngushtë, por edhe modernitetin e tipit surrealist, simbolist, abstraksionist, ta qasë me hezitim dhe maturi herë-herë opozicionale, që për pasojë ka sjellë një formë hibride të qasjes dhe të prirjes së perceptimit të realitetit, objektit krijues, prore të vjelë nga realiteti, në rastin konkret të ballafaqimit të krijimit të inteligjencies së re shqiptare të Kosovës karshi strukturës shoqërore tëhuajsuere jugosllave me prirje antikombëtare shqiptare, dehumanizuese, gjeonocidale dhe të bashkëveprimit me elementët më konservativë dhe primitivë shqiptarë!...

Kështu, me gjithë përqafimin e kësaj metode dhe të parimeve pak a shumë të moderuara dhe risimtare, konkretisht në veprën „Shtrojera” autori bën një sintezë të kësaj letërsie mbi përvojën migjeniane, kadareane dhe do të mund të thoshim njëfarë dore edhe heminguejane. Shprehur në mënyrë më të përgjithësuar dhe më të gjerë, Duraku më tepër *shilerizon* sesa *shekspirizon*, apo shprehur me një pikëpamje më tradicionale estetike, vepra e tij më tepër priret nga *estetika platoniane* sesa *aristoteliane*.

Tematikisht, autori përqendrohet në peripecitë rreth formimit të intelektualit të ri: shkollimi i të rinjve, shkollimi i femrës shqiptare, peripecitë e kuadrit të ri mësimor shqiptar me prirje kulturore kombëtare, nën administratën socialiste titoiste, në një fazë kritike të qenësisë shqiptare në trojet e tyre etnike, nën tutelën e kësaj administrate politike-policore-ushtarake pas Luftës së Dytë Botërore dhe krijimit të së ashtuquajturës Jugosllavi Federative sllavomadhe, ku populli shqiptar nuk i realizoi aspiratat e veta nacionalçlirimtare, por vetëm se doli i mashtruar nga sloganet internacionaliste të „vëllazërim-bashkimit”. Autori guximshëm e zë këtë fije të pasojave të këtij mashtrimi sllavist. Kohësisht, ngjarja përqendrohet në periudhën e ashtuquajtur të *deformimeve*, kur shqiptarët i ishin nënshtruar represionit të gjerë shkombëtarizues, shfarosës, që për pasojë kishte ndjekjen e intelektualëve të rinj shqiptarë, suprimimin dhe mbylljen e shkollave shqipe, torturimin masiv të qytetarëve shqiptarë në të ashtuquajturin *aksion të armëve* dhe si rezultat final i tërë kësaj, shpërnguljen masive për në Turqi dhe vende të tjera të botës. Duraku është preokupuar me këtë problematikë, kur plagët e marra nga ky terror shtetëror ishin ende duke kulluar, pra pa ndonjë distancë të madhe kohore,

atëherë kur mendohej se është bërë zvogëlimi i intensitetit të represionit sa për sy e faqe, që do të thotë se kësaj ka shfaqur guximin intelektual dhe krijues tek merret me racionalizimin romanor të këtyre fenomeneve ekzistenciale. Në këtë rast, autori me gjeturi ballafaqohet thuaja me të gjitha dimensionet e kësaj kohe, duke mëtuar që të bëjë një tipizim konkret të kohës, të ambientit dhe të njerëzve, në hapësirë dhe në kohë të caktuar, me të gjitha linjat rrëfimore që gërshetohen sipas një logjike të baraspeshuar syzheore-kompozicionale, madje tepër të racionalizuar, gati në tendencë ideestetike që ka rrezik të gjasojë në skematizëm të njohur të shkrimit socrealist. Ky realitet kontradiktor përballohet nga personazhet e autorit dhe këtu triumfon, jo me ndonjë triumf shkëlqimtar, e drejta e qenësisë njerëzore, kulturore dhe kombëtare shqiptare: shkolla mbijeton makiavelizmin e UDB-së; revolucionarët e mirëfilltë, që kanë bërë luftën antifashiste, edhe pse të mashtruar nga „lufta nacional-çlirimtare”, me gjithë këto sakrifica vazhdojnë ta bëjnë rezistencën e tyre në mbrojtjen e çështjes së emancipimit kombëtar; pjesa më e ndjeshme, inteligjencia e re, me orientim human dhe kombëtar sakrifkohet për të vazhduar formimi dhe krijimi i inteligjencies më të re, me theks të veçantë potencohet shkollimi i femrës shqiptare; femra shqiptare arrin të shkollohet, të bëhet e aftë për vetveten dhe e zonja për të bërë shkollimin e të tjerëve, duke tejkaluar kurthin e zakoneve prapanike, anakronizmin e tyre, që jo vetëm femrën shqiptare e linin prapa në gëzhgjën e konservatorizmit, të injorancës, që e ushqenin elementët e korrumpuar të pushtetit jugosllav antikombëtar. Kuptohet, tërë kjo problematikë zbërthehet përmes së veçantës së tipizuar, që, si e tillë, mëton të tregojë për fenomenet tipike në realitetin tipik.

Në vorbullën e intrigave makiaveliste

Pjesa më e qëlluar dhe më e realizuar artistikisht, mendojmë se është ajo që shtjellon intrigat rreth ndalimit të shkollës shqipe, e kamufluar si prirje për „*racionalizimin e rrjetit shkollor*”, që kishte për qëllim mbylljen „e klasëve të larta të tetëvjeçares” dhe kështu shuarjen e shkollës shqipe në perspektivën e afërt! Në këtë tendencë shuarjeje zhvishet, me tërë vrazhdësinë e saj, me skenat dhe prapaskenat, makineria makiaveliste, ajo makineri e sigurimit, e njohur me emrin UDB, që paralelisht realizonte projektet e shkombëtarizimit të shqiptarëve, ndërsa cak të fundit kishte edhe largimin fizik të tyre nga Kosova përmes shpërnguljeve masive, të cilat duhej të kamuflloheshin me pretekstin e riatdhesimit të popullatës turke! Vetëm me dokumentacione të tilla falso popullata e dërrmuar nga gjenocidi mund të shpëtonte jetën duke lëshuar truallin e vet!... Ndërsa, përpara syve të botës, askund nuk thuhej se shqiptarët po dëboheshin prej trojeve të tyre!?... Megjithëkëtë, qëndrueshmëria që vinte nga e drejta natyrore e të jetuarit në vendin e vet, dhe logjika e jetës bënë që maskat e këtyre satrapëve të zhvisheshin, të çirrej demagogjia e „internacionalizmit proletar”, demagogjia e „luftës nacional-çlirimtare”, si dhe qëllimi famëkeq i parullës ortodokse pansllaviste i „vëllazërim-

bashkimit”, këtu në roman jo në ndonjë mënyrë të shkoqitur, por më tepër në mënyrë shenjzuese, metaforike, përmes parimit të „Ajzbergut” heminguejan.

Zbërthimi i këtyre nyjeve romanore, shkathësia e autorit që të gjejë mënyrën për t’i trajtuar këto çështje dhe njëherazi t’i bishtërojë censurës së kohës, vërtet ka bërë që në letërsinë shqipe të paraqitet një roman me një nivel realizueshmërie dhe me një materie të patrajtuar deri atëherë ndër ne.

Në këtë roman autori nuk ngurron të fusë edhe personazhe reale, madje edhe me emër, po edhe personazhe me fytyrëzim real, si: Ali Fetahaj, Sylë Bimbashi dhe Agron Spahiu, të cilit makineria udbiste i monton gjenezën e familjes „së dyshimtë” „antipartizane” vetëm pse ai doli në ballë të përpjekjeve për ruajtjen e shkollës. Përmes këtyre situatave autori zhvesh vellon demagogjike të sistemit që vetëm me fjalë propagandonte lirinë, drejtësinë, barazinë për të gjitha kombet, ndërsa ato i gëzonte vetëm struktura e majorizuar që kishte uzurpuar pushtetin dhe në emër të këtyre sloganeve demagogjike sendërtonte interesat e veta hegjemoniste serbomëdha. Ndërsa, ndërgjegjësimi për *mashttrimin e madh* të LNC-së, tashmë po paguhej edhe me haraç dhe sakrificë edhe më të madhe të shqiptarëve. Pushteti ekzistues me këtë platformë shkombëtarizuese edhe përpjekjen më të vogël për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit kombëtar përmes afirmimit të historisë, të letërsisë dhe të kulturës kombëtare, që sublumohej në masivizimin e ndjekjes së mësimin në gjuhën amtare, e trajtonte si prirje nacionaliste të shqiptarëve të Kosovës, dhe, kuptohet, pasonin keqtrajtimit më barbare mbi bartësit e këtyre prirjeve dhe përpjekjeve. Siç cekëm edhe më parë, këto çaste prore trajtohen sipas përvojës heminguejane me të ashtuquajturën *parim të Ajzbergut*, pra kapen me thjerrëzen e shkrimtarit ato pika karakteristike që e sugjerojnë tërë dramacitetin dhe tragjikën e brendshme të këtij fenomeni. Tërë kjo më shumë është nëntekst që nxjerr në pah ato çaste delikate të tragjikës sonë kur shteti jugosllav kishte arritur qëllimin që ta bënte shkëputjen e një pjese të kombit shqiptar nga trungu i vet natyror-historik, kulturor, letrar, dhe së fundi politik, duke inskenuar prishjen me aleatin historik BRSS-në, (!...) e në anën tjetër duke i realizuar synimet e tij strategjike! (mosrealizimin e integritetit të faktorit shqiptar në ballkan!). Në këtë vazhdë tipizimi, autori arrin t’i kapë me ndjenjë të hollë edhe prirjet tjetërsuese dhe bastardhimin në një sistem tjetër të vetëdijes dhe të vlerave kulturore e morale, duke i ndaluar prirjet natyrore të qenësimit njerëzor e kombëtar. Ky sistem policor, përmes shqiptarëve bastardhë të tipit të Sylë Bimbashit me shokë, konservativë, injorantë, karrieristë, intrigantë, lakmitarë, pra të një njeriu të prishur nga karakteri, që për qëllimet e veta personale karrieriste, nga pozita e tij, është në gjendje të sakrifikojë të gjitha ato vlera kombëtare dhe zhvillimin e tyre normal, vetëm për të qenë besnik ndaj padronit, njerëzve të pushtetit policor kolonizues, të tipit të Milorad Stamenkoviqit. Ky në makinerinë antishqiptare kishte futur pseudoshqiptarët si Sylë Bimbashi, Ramë mësuesi, Bajram Feka etj., për t’i ndjekur shqiptarët përparimtarë. Në tërë këtë rrëmujë ndjekjesh shumëdimensionale autori e sheh të udhës që si lajtmotiv ta vërë përpjekjen për mbajtjen gjallë të shkollës në gjuhën shqipe, që kësajsoj bëhet një simbol iluminist

dhe kombëtar, prandaj, pas shumë ballafaqimeve të të kundërtave, vijëzohet fundi optimist i romanit, në mënyrë triumfuese, i ndërlidhur prore me fatin e heroit kryesor, Hanës, si një prototip i heroinës pozitive (sipas parimeve të *realizmit socialist*, pjesërisht); në këtë rast ajo më tepër paraqitet si simbol i triumfit të emancipimit të intelektualës së re, i triumfit iluminist, utilitarist dhe kombëtar, e asesi i ndonjë triumfi ideologjik socialist, apo komunist, siç do të hasen shumë personazhe stereotipe të veprave letrare të tipit të realizmit socialist, ku me triumfin konkret, ndërlidhet edhe vitaliteti dhe triumfi ideologjik socialist-komunist! Këtu, me këtë shmangie të vetëdijshme, Duraku na dha „Afërditën” shqiptare të Kosovës, ku ballafaqimet dhe sakrificat bëhen për një qenësim të emancipimit kombëtar.

Këtu autori është i veçantë dhe origjinal në shumë pikëpamje. Përmes së veçantës autentike ai nxjerr në shesh të përgjithshmen, fenomenin shoqëror. Me këto elemente romani „Shtrojera” është dëshmi jo vetëm ilustrative e kohës, por edhe vepër me vlera të theksuara ideoartistike.

Ky dimension nuk është edhe aq i theksuar, ngase, megjithkëtë, duhen kuptuar edhe rrethanat kur është krijuar e botuar romani, pikërisht pas një pushimi të përkohshëm të procesit gjenocidal, atëherë kur krijohej një maskë e re, gjoja duke i denoncuar aktorët e proceseve të *deformimeve*, që Titoja, atëherë „i verbër” dhe „i shurdhër” për të gjitha këto procese (?!), shkarkoi nga posti kryesisht disa persona që i kishte rreth vetes (që ia rrezikonin postin!), me kryeprijësin e realizuesin aktual Aleksandër Ranković, dhe shih ti, tërë kjo violencë gjatë Luftës së Dytë Botërore, e vazhduar edhe pas përfundimit të saj, kur shqiptarët e panë veten të mashtruar nga ideologjia komuniste, titoiste dhe staliniste, vazhdoi dhuna e egër e makinerisë serbomadhe, edhe pas mashtrimeve të bukura të vitit 1974, të autonomisë së Kosovës dhe të subjektivitetit të saj në Federatën Jugosllave, me po ato forma, që ishin nxitëse për autorin t’i hynte një ripunimi të mundshëm edhe një herë të romanit „Shtrojera” për të nxjerrë në pah edhe një herë mësimet nga pësimet!

Vazhdimi i egër i kësaj lufte, siç thamë, paraqitet shumë bukur edhe me rastin e „spastrimeve të terrenit” gjoja nga elementët antikomunistë, që ishin elementë liridashës kombëtarë, të cilët e panë herët mashtrimin nga ideologjia komuniste dhe lufta e përbashkët vëllazërore! Ky dimension eksplikohet bukur përmes trajtimit të dramës së Bali Katravellës, që si rast arrin, madje edhe të instrumentalizohet nga makineria policore-ushtarake, për t’u përdorur si pretekst për ndjekjen masive të të gjithë atyre që e kanë strehuar për ndonjë ditë, siç është praktikuar në shumë raste anembanë Kosovës dhe në vise të tjera shqiptare nën Jugosllavi! Pra, autori ndriçon një nga rastet e mundshme, ngase edhe në opinionin real rreth këtij rasti tregohen, ka shpjegime kontradiktore rreth ndodhisë. Megjithkëtë, autori nxjerr në pah thelbin e çështjes: instrumentalizimin dhe manipulimin me njerëz përmes montimit të proceseve, metodë kjo e përpunuar dhe efikase (!), që praktikohet edhe me rastin e piktorit dhe të arsimtarit, Menduh e Agron, kuptohet e moderuar, e cila nga po ajo strukturë njerëzish, me po atë bazë

ideologjike ka vazhduar të praktikohet edhe pas vitit 1981, për të arritur ashtu, si në vitet 50 kulminacionin e objektivave: shpërnguljen masive të shqiptarëve!... Edhe sot, derisa po i shkruajmë këto radhë në shenjë nderimi për veprën e Nebil Durakut, rreth romanit dhe ngjarjeve që janë pasqyruar në të, po vazhdojnë të përsëriten me vrazhdësi ato dukuri. Për fat të keq, ato edhe sot e kësaj dite vazhdojnë dhe tregojnë më së miri atë vlerën intuitive dhe përgjithësuese ideoartistike të një teksti letrar, i cili jo vetëm provon të kapë çaste të rrethanave reale-aktuale, por edhe nxjerr përfundime të caktuara ideoartistike.

Intuitë artistike

Pikërisht për këto dimensione reale-universale, romani „Shtrojera”, jo rastësisht, është marrë në dorë edhe një herë nga autori, për t’u *përmirësuar*, që thënë më shkoqur tregon për vetëdijen e zgjuar të krijuesit që të bëjë gjenerimin e ideve të tij rreth atyre proceseve dhe fenomeneve që prapë vazhdojnë të përsëriten, edhe pse pas një *kohe shtrojere*, inteligjencia shqiptare e Kosovës, në vazhdën e emancipimit të lartë kulturor, arriti ta hapë edhe universitetin në gjuhën shqipe (?!...), por në realitet prapë po shfaqej ajo sulje e egër mbi shkollën, universitetin, i cili më 1981 cilësohej si *Kështjellë e nacionalizmit, irredentizmit, separatizmit shqiptar*; prapë po ajo ndjekje e inteligjencies, po ai aksion i mbledhjes së armëve; i proceseve të montuara politike; i rrahjeve masive të qytetarëve shqiptarë për armën që nuk e kanë; dhe tani edhe shpërngulja më masive e shqiptarëve në botë! Dhe, shqiptarët e Kosovës janë ata që prapë rezistojnë me shpirt ndër dhëmbë, përpiqen të mbijetojnë këtë mynxyrë unikate për shumëçka orveliane. Andaj, idenë e mbizotërimit të rrethanave dhe triumfin e progresives iluministe, madje natyrore, do të thoshim, nga një simbol neoromantik, neoiluminist, vetë realiteti e bën simbol tipik realist, për t’u gjeneruar në perspektivë në simbol universal, pikërisht përmes realizmit autentik, i cili, ja, prapë, jo vetëm për shqiptarët, po përsëritet në formën më të vrazhdë!

Për tërheqjen e këtyre paraleleve vlerësuese kemi parasysh të gjitha variantet e romanit, sidomos variantin e dytë, ku autori ka arritur të bëjë ripunimin e pesë kapitujve të fillimit të romanit në gjuhën letrare, me se edhe për shumë nuanca teksti ka fituar në dimensionet e shprehjes artistike, vetëkuptohet, sepse tani Duraku tregon shkathhtësi dhe përvojë më të madhe të rrëfimit prozaik artistik. Tashmë autori ka përfytyrim edhe më të plotë për këto procese, andaj edhe bën përpjekje të lirohet nga kufizimet dhe sindromi i censurës dhe i autocensurës. Hetohet prirja se autori këtë vepër e ka dashur dhe ka pasur motiv shumë të thellë që ta punojë me përkushtimin më të madh krijues, pikërisht pse realiteti i saj artistik, sipas intuitës së autorit, për fat të keq, ka zënë të përsëritet në formën e tij më të vrazhdë, por edhe prirja për të rezistuar dhe për t’u flijuar për çështje të mëdha kombëtare, janë dimensione që e përshkojnë këtë vepër. Megjithëkëtë, marrja me pasojat e tragjikës dhe zbërthimi i shkaqeve, është më e theksuar sesa

ndonjë glorifikim i heroikës, që veprës do të mund t'i jepte tingëllim deklarativ socrealist. Në një realitet të bastardhuar socialist, siç ishte ai i atyre viteve në Kosovë, nën tutelën serbe, megjithëkëtë zë vend një prirje e rezistimit kombëtar për ruajtjen dhe kultivimin e identitetit, ndërsa konturat e sistemit socialist, ideja komuniste, elementet e liberalizmit socialist (!) në këtë rast kapen në dekadencën e tyre, siç provon ta bëjë këtë edhe në romanin „Egira” e në ndonjë vepër tjetër. Ky *happy end* është i natyrës iluministe, madje edhe realiste do të thoshim, e assesi i mbështetur në estetikën socrealiste. Andaj, do të thoshim më shkoqur, se realizmi prozaik i „Shtrojerës” shkon nga një realizëm artistik, që formën e tipizimit artistik, tipizimin e ambientit dhe të personazheve e bën sipas mbështetjes në një realitet më kompleks faktik, madje edhe të përjetuar nga vetë autori, përvojë kjo që në një formë ose tjetër zë vend në këtë roman. Prandaj, realiteti i „Shtrojerës” nuk është realitet i imagjinuar, as i ideologjizuar, por realitet vërtet tipik dhe autentik në kuptimin e plotë të fjalës.

Pikërisht, për këto prirje, romani „Shtrojera”, jo vetëm për realitetin shqiptar të Kosovës, ofron mesazhe kuptimplota artistike dhe sociokulturore se si është ruajtur dhe si mund të ruhet prirja progresiste e kultivimit të formës së qenies kombëtare, karshi apetiteve totalitare, kolonizuese dhe represive që përfundojnë në gjenocid, etnocid dhe kulturocid. Vetvetiu, i pashqiptuar deklarativisht, por si një nëntekst i këtij konteksti real-artistik, del mesazhi: *violencës totalitare*, megjithëkëtë, në aso rrethanash ka pasur mundësi për t'iu kundërvënë vetëm me emancipim dhe civilizim kombëtar, që provon të ngrihet në një *filozofi* me premisa neoiluministe të kohës.

Elementet e strukturës poetike

Romani „Shtrojera” ka strukturë pak a shumë të gërshetuar mbi modelin e mozaicitetit të ndërtuar mbi logjikën e ballafaqimit të të kundërtave, sipas logjikës shkak-pasojë, me premisa reale dhe tipizuese, me një tendencë nga progresiviteti. Kjo hetohet më shkoqur kur të vërehen lëvizjet e personazheve të tipizuara mbi bazën e veprimit të tyre, po edhe të ndërhyrjeve narrative të subjektit krijues, i cili herë-herë mund të hetohet se „*vrojton nga Olimpi*” duke i „urdhëruar” personazhet të lëvizin sipas skemave syzheore, kompozicionale dhe ideoartistike. Tipizimi bëhet edhe me ndonjë retrospektivë përshkruese, monologjizuese (mbi bazën e asocimit sporadik), e cila nuk teprhet sa të harrohet dinamika e lëvizjes, e veprimit, e dialogëzimit të personazheve. Kështu, dialogu funksionalizohet vetëm në rastet e situatave më dramatike, pra në rastet kulmore të ballafaqimit të personazheve në situata; të eksplikimit të ideve që ata bartin dhe që i karakterizon si personazhe të profilizuara. Duke i theksuar të gjitha këto veçori të tipizimit, mund të konstatohet se në pikëpamje të ndërtimit kompozicional, të tipizimit të personazheve dhe të ambientit, autori ndjek parimin e një subjekti romanor të realizmit bashkëkohor, pra, u shmanget ekzagjerimeve narrative të tipit të realizmit

klasik, kështu që sajón një syzhe të përdegzuar, por kompozicionalisht të formësuar sipas logjikës ideoartistike. Sidoqoftë, prirja për narracion të ngjeshur me një ndjeshmëri psikologjike, po edhe tipizimi psikologjik i karaktereve të personazheve, nuk mungon, gjë që e rrisin edhe emocionalitetin e përgjithshëm të veprës dhe mundësojnë përjetim më intensiv të romanit. Autori duket se mëton që të gjitha elementet ndëruese t'i funksionalizojë, duke u nisur nga përshkrimi i situatave dhe ambientit, nga vënia në veprim e personazheve përmes dialogëve, nga përshkrimi psikologjik dhe i përgjithshëm, nga nënteksti dhe idetë që rrezatojnë nga shtjellimi i tyre. Kështu, përpara perceptuesit racional dhe emocional, sajón një *ndërtesë* me një arkitekturë dhe pamje të pëlqyeshme. Ajo të ngacmon për një përjetim intensiv estetik, shprehur figurativisht, do të thoshim të fton ngrohtësisht për të hyrë brenda në të. Me vetë faktin se prapë manifestohet logjika e përsëritjes së gjërave dhe fenomeneve të trajtuara në këtë vepër, tani në hapësirë të ngjashme, por në një kohë tjetër, e bën tepër ilustrativ faktin se vepra është e pleksur me prirjen e përgjithësimit artistik. Ky përgjithësim i së veçantës së realitetit (Kosjeri, lokalitet i Drenicës), është një emërues i përbashkët thuaja i tërë asaj që ndodh në një formë ose në një tjetër aktualisht nëpër shumë vise të Kosovës. Kuptohet, nga niveli i shprehjes, gjithsesi, edhe në pjesët e përpunuara nga autori, se ai ka shprehur një përvojë të veçantë dhe të çmueshme që shtrihet edhe në fushën e njohjes së historisë dhe të traditës kombëtare, po edhe të letërsisë shqiptare, të cilat si shenja të vetëdijes dhe qenies kombëtare jo rastësisht bëhen edhe ideale të personazhit Agron Spahiu - mësues ambicioz dhe sakrifikues për çështjen e shkollimit dhe të ndërgjegjësimit historik-letrar kombëtar. Janë këta: Skënderbeu, Naimi, Migjeni, që atëbotë ishin bërë objekt frymëzimi edhe për portretizim figurativ-piktural të Menduhut, shok i brezit të tij, i cili anatemohehet dhe hidhet në rrugë si i papërshtatshëm për edukimin e brezit të ri, siç do t'i ndodhë më pastaj edhe Agronit, pse, pos të tjerash, në dhomën e tij paska mbajtur të varura pikurat e tij! Në mënyrë tejet ilustrative autori tregon për të vërtetën tashmë tejet banale, kur vlerat historike kombëtare ose ndonjë vepër e letërsisë shqiptare etj., anatemohehin dhe ndaloheshin të mësoheshin në shkollën e sapohapur shqipe në Kosovë, ndërsa njerëzit që në çfarëdo mënyre kontaktonin me këto vlera historiko-letrare, gjithashtu anatemohehin dhe ndiqeshin si nacionalistë dhe armiq të socializmit pansllavist (?!...) Këtë ndjekje e përjetojnë Menduh Gashi dhe Agron Spahiu, që janë shenja të ndjekjes së intelegjencies së re përparimtare shqiptare të Kosovës. Me apostrofimin e modeleve ideore: Skënderbeu, Naimi, Migjeni, pastaj me krijimin e modeleve të reja, Ali Fetahaj, Agron Spahiu, Hana etj., ku mishërohet energjia e rezistencës dhe e qenies kombëtare, përballë makinerisë dehumanizuese sllavokomuniste, autori krijon kështu një *gjedhe neoiluministe* përballë dhunës dhe terrorit shtetëror, si formë të qenësimit dhe të mbijetimit. „Shtrojera” e Durakut, me shtresime të tëra dëshmuese, autentike, ofron një lëndë të begatë për studime sociokulturore dhe filozofike, posaçërisht të filozofisë së qenësimit kombëtar me forma neoiluministe, përballë aparatit shtetëror represiv, totalitar, që i përdor të gjitha metodat makiaveliste të terrorit psikologjik dhe

violent. „Shtrojera” kësisoj është edhe një sfidë e iluzioneve të „triumfit” të lirisë nacionale dhe të barazisë së „fituar” në LNÇ-në, të shqiptarëve të Kosovës nën Jugosllavinë socialiste. Kjo sfidë shumëdimensionale vjen e bëhet edhe sot pas ribotimit të katërt, me një pjesë të *përmirësuar* nga autori në vitin 1989, vit ky që shënon fundin e jetës së shkrimtarit, por edhe në një mënyrë fatin tragjik të „Shtrojerës”, dhe me pjesën tjetër të transliteruar (si dëshirë e autorit për të gjallë të tij, të cilin sëmundja dhe vdekja e hershme e ndanë nga ky projekt, gjithsesi, me rëndësi për letërsinë dhe kulturën kombëtare!). Duke i rezistuar sëmundjes, ai përmes „Shtrojerës” edhe një herë donte të na kujtonte rezistencën e tij krijuese dhe intelektuale përballë *kohës së sëmurë*.

Sidoqoftë, romani „Shtrojera” ekziston dhe reziston në hapësirë dhe kohë, edhe ai i botimit të parë në një gegërishte letrare të kohës, kur është shkruar e botuar, për herë të parë, por edhe ky torzo i kompletuar në gjuhën letrare, për të cilin autori duket se nuk kishte për qëllim thjesht letrarizimin, por një punë më serioze krijuese, krijimin e një varianti të ri. Kjo dëshmohet me ndërhyrjet e thella të dorës krijuese-rikrijuese të autorit, kur ai vërtet kishte koncepte më të plota dhe më të përparura e më të diferencuara estetike, për ndërhyrje të tillë. Nga analizat krahasimtare që kemi bërë, me plotësimet që janë bërë në kapitujt përkatës (prej kapitullit të parë deri në të pestin), mund të konstatojmë se ato edhe më tutje janë me interes artistik dhe stilistiko-letrar të analizohen dhe të bëhen vështrime më shteruese stilistike të makrostrukturës dhe të mikrostrukturës poetike dhe stilistike, sidomos për të kuptuar fenomenin e krijimit të varianteve të një vepre, që ndodh ndër shumë krijues. Kësaj radhe, në vija më të trasha mund të skicojmë se në versionin e fundit të papërfunduar, Duraku ishte më i kujdesshëm dhe më i liruar në mishërimin e narracionit me vlera më të holla poetike të tekstit, duke u nisur nga strukturat më të mëdha, siç mund të jenë pjesë e ndonjë kapitulli fare të ri, futja e situatave dhe ideve të reja, e deri te ndërrimet e përmirësimet e fragmenteve si dhe të strukturave më të imta, siç janë: fjalitë, togfjalëshat, frazeologjitë e shprehjet, që rrëfimin e bëjnë më nuancues, më emocionues estetikisht. Në versionin e parë, në atë periudhë të njëfarë liberalizimi të pjesërishtëm të jetës shoqërore e kulturore, posaçërisht të një liberalizimi të pjesërishtëm e perfid (që solli vetëm një lidhje ambivalente dhe perverse të Kosovës me Serbinë dhe me Federatën Jugosllave...), kuptohet se autori nuk ka mundur të afrojë një tekst të liruar plotësisht, sa nga censura e kohës aq edhe nga autocensura, ndërsa me rastin e përpunimit të *botimit të tretë të përmirësuar*, duke u ekspikuar disa nyja ideoartistike, si ai i vrasjes së Milun Jakshiqit, apo rasti i Bali Katravellës etj., na bën të kuptojmë më mirë pasojat negative të censurës e mbase edhe të autocensurës së kohës! Prandaj, pos vlerave ideotematike, versioni i fundit provon të sjellë vlera të reja poetizuese, nga të cilat, po të realizoheshin deri në fund nga shkrimtari, vërtet do të kishim një roman edhe më të realizuar në shumë pikëpamje poetike romanore. Në pjesën tjetër të „transliteruar” të romanit janë bërë përpjekje që të ruhet autenticiteti i dorëshkrimit autorial, dhe në pikëpamje të gjuhës së veprës mendojmë se është ruajtur struktura imanente e saj dhe është bërë vetëm letrarizimi

i mundshëm, pothuaj i fjalëpërfjalshëm, ngase struktura sintaksore te ky autor është një *kështjellë autonome*. Ndërsa, disa funksionalizime morfologjike, stilistike, kanë qenë të domosdoshme, për t'u krijuar një tërësi deri diku kompakte romanore. Mendojmë se kështu është arritur të krijohet më tepër se *iluzion* për një vepër autentike (!!...) si realizim i dëshirës së autorit.

Megjithëkëtë, „Shtrojera” e shkrimtarit dhe e njeriut të çmueshëm Nebil Duraku, mbetet vepër autoriale, sfidë e jetës nëpër kohën e letërsisë.

Dhjetor, 1995
Bad Dürkheim

Robert Elsie

Mendime për librin „Shkrimtarët e Kosovës '43 - '83”

Libri **Shkrimtarët e Kosovës '43 - '83** shënon dyzetvjetorin e botimeve në Kosovë dhe përbën veprën më voluminoze të prozës bashkëkohore, që ka dalë deri tani në këtë krahinë. Ai është hartuar e redaktuar nga Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës nën drejtimin e Nebil Durakut, edhe vetë romancier i njohur. Duraku thotë se ky libër nuk është antologji në kuptimin e zakonshëm të fjalës, e përmbledhur sipas kriteresh specifike, por është më fort një paraqitje e një numri sa më të madh autorësh nga Kosova. Bashkë me materialin biografik dhe bibliografik, ai përmban fragmente veprash nga 198 shkrimtarë të Kosovës: 149 shqiptarë, 38 serbë dhe 11 turq, pasqyrim i rreptë ky i raporteve zyrtare etnike të krahinës. Pas këtij botimi, ky libër do të pasohet edhe nga botimet në gjuhën serbo-kroate e turke.

Janë përfaqësuar në këtë libër jo vetëm klasikët e poezisë së sotme në Kosovë, si Enver Gjerqeku, Din Mehmeti, Esad Mekuli, dhe romancierë me emër si Nazmi Rrahmani e Hyvzi Sulejmani, por edhe një numër i madh nga brezi i shkrimtarëve

të rinj, të shqetësuar, që po lind, por që nga nevoja apolitike, shumica e të cilëve janë anëtarë të Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës. Pjesët e zgjedhura janë të shkurtra, por të mjaftueshme për të treguar se sa vendosmërisht letërsia shqiptare në Kosovë është shkëputur nga nacionalizmi romantik i së kaluarës dhe është hedhur drejt një të ardhmeje të pasigurt.

A janë të nevojshme paqja, qetësia sociale dhe një vilë përballë Liqenit të Gjenevës për të patur një prodhim letrar të dendur? Me sa duket, letërsia palestineze dhe ajo veri-irlandeze e kohëve të fundit flet për të kundërtën. Ka më shumë të ngjarë që Muza të marrë rrugën për atje ku ka konflikte civile, gjendje të nderë etnike dhe vuajtje, - në qoftë se krijuesit më të mirë arrijnë të mbesin gjallë.

Krahina e Kosovës në Jugosllavinë Jugore është një zonë e tillë, nga ku presim në të ardhmen. Skena është ngritur. Shqiptarët etnikë, të cilët tani përbëjnë 78 për qind të popullsisë dhe kanë një ritëm lindjesh që do t'i trulloste madje edhe irlandezët, janë në konflikt me federatën jugosllave. Për herë të parë arsimit i përgjithshëm ka dhënë frytet e veta në një krahinë që deri vonë i ngjante më shumë Botës së Tretë sesa Evropës, kurse radha e të papunëve, që kanë mbaruar shkollat e larta po bëhet mjaft e gjatë dhe shqetësuese. A nuk ishte ushqimi i keq në mensat universitare të Prishtinës që ndezi kryengritjen e përgjithshme më 1981, pas së cilës erdhi vendosja e shtettrëthimit në këtë krahinë? Autoritetet e Beogradit po i përndjekin dhe i ruajnë me vigjilencë bashkëvendësit shqiptarë. Është pikërisht kjo atmosferë e nderë politike në Kosovë, që e bëri aq të dukshme mungesën e çdo referimi ndaj politikës aktuale dhe nacionalizmit në këtë vëllim.

World Literature Today
(Letërsia Botërore Sot)
dimër, 1986

II. Intervista

Rrustem Berisha

Koha për frymëzimet e reja

Nebili, duket, i kushton mjaft kujdes punës letrare. Ai botoi romanin „Murgesha” dhe përmbledhjen e tregimeve për fëmijë „Topi i larmë”. Radio-dramat: „Nga fryn era” dhe „Tregtari i kafshatave të dreqit” iu emetuan në valët e Radio Prishtinës. Ai gjithashtu shkroi dy skenarë të filmit: „Tybelitë” dhe „Shpëtimi”.

Në gazeta dhe revista botoi edhe një sërë tregimesh për të rritur.

• *Romani juaj „Murgesha” është ndihmesë e letërsisë sonë. A do të mund të na thoni ç’u bë me fatin e romanit „Shtrojera”, i cili ishte një prej romaneve në konkursin letrar të „Rilindjes”, i propozuar për botim?*

- „Murgesha” është një pjesë e dytë e një romani. Të dy pjesët e romanit i kam dorëzuar përnjëherë në sektorin e botimeve të „Rilindjes”, të dy recensentët u shprehën pozitivisht. Mirëpo, pasi u kufizuan faqet e librit, u detyrova të botoj vetëm pjesën e dytë, kurse e para gjendet në bibliotekën time. Po pres të gjej kohë të lirë për të hedhur pak frymëzim të ri nëpër faqet e tij, mandej, të shohim...

Politika e botimeve tek ne, më në fund, u bë më ekspeditive, u pëgjigjet kërkesave bashkëkohore të lexuesve tanë. Ndërkaq romani „Shtrojera” paraqet një kompleks raportesh shoqërore, një temë bashkëkohore, pra, ngjarje që janë në vlim

e sipër. Tash pesë herë jam duke e ripunuar, plotësuar e kopjuar. Ende e kam nëpër duar, dhe nga fundi i vitit, duhet t'i jap trajtën përfundimtare. Shpresoj, po qe se nuk më ngec puna kund, nga fundi i vitit të gjendet në duart e lexuesve.

• *Janë dëgjuar me interesim radio-dramat tuaja: „Nga fryn era” dhe „Tregtari i kafshatave të dreqit”. Ç'mendoni për këtë zhanër?*

- Është mëkat që ky lloj teatri, me numër të madh „spektatorësh”, ende nuk është duke u mëkëmbur si duhet. Deri vonë drama origjinale ishte e rrallë. Ndoshta shpërblimi i dhjetorit, dhënë Ramiz Kelmendit, është një kthesë nga realiteti... Tek ne bëhet një punë e pamirë, nuk publikohen tekstet e radio-dramave.

• *Në fillim keni shkruar për fëmijë e pastaj për të rritur. Pra, sipas një shënimi të shkurtër, shumë veta nuk dinë se keni botuar përmbledhjen e tregimeve për fëmijë „Topi i larmë” në Shkup.*

- „Topi i larmë” është larmi temash e situatash, ashtu si i krijojnë vetë të vegjëlit. Është habi e madhe, kur më parë merr librin nga Parisi se nga Shkupi. Po ashtu, botimet e „Rilindjes” vështirë „udhëtojnë” për në Tetovë, në Dibër, në Strugë apo edhe në Shkup. Edhe tregimet për të rritur, po ashtu, presin dorën e botuesit.

• *Sipas skenarit tuaj është xhiruar filmi etnografik „Tybelitë”. Ç'u bë me skenarin „Shpëtimi”, për të cilin fituat shpërblimin letrar të Qendrës Kulturore e Propagandistike të Krahinës?*

- Paratë e këtij filmi i hëngri „Vuku”.

• *Sipas mendimit tuaj, ç'i mungon prozës sonë?*

- Autorët e prozës sonë, mendoj, janë lënë bukur shumë pas dore. Nga kjo shihet se gjendemi në batica e zbatica. I di disa emra, pak sish që gjykojnë faqe të prozës që fare s'i kanë lexuar; sikurse di edhe për të tjerët - shkruajnë për një vepër në suaza të jetës subjektive. Qëndrimet e tilla nuk përkojnë me synimet tona, pra as në lëmin e zhvillimit të kulturës e të letërsisë.

„Zëri i rinisë”
Prishtinë, 1968

Burbuqe Rushiti

Për art të mirëfilltë

Bashkëbisedë me Nebil Durakun në emisionin e Radio-Prishtinës në kuadër të rubrikës „Mysafiri i programit të natës”.

...

• ... Dhe të gjitha shkrimet e krijimtarisë suaj datojnë që në fillim të viteve '50. Tregimi juaj i parë për të rritur është „Ushtari i babës Hitler”. Ju jeni marrë edhe më herët me tregime për fëmijë, por ne po ndalemi pikërisht në këto tregime për të rritur. Dhe pos romaneve të cilat i keni botuar deri sot, ju keni botuar edhe rreth 60 tregime. A s'është pakëz e çuditshme që pas 30 vjetësh, pikërisht para disa vjetësh, të botoni përmbledhjen e parë të tregimeve? Madje kjo është edhe e fundit, meqë tregime më nuk keni botuar, kurse për romane do të bëjmë fjalë më vonë...?

- Ashtu është, është e çuditshme pakëz, t'ju them të drejtën, siç ju thashë edhe për radio-dramën „Tregtari i kafshatave të dreqit”: gjithashtu është karakteristike edhe për tregime dhe për romane që botohen më vonë. Tregimet i kam shkruar kohë pas kohe, d.m.th. ashtu siç kanë lindur frymëzimet nga një pjesë e jetës, e nënqiellit tonë më tepër fshataresk, ngase jeta në fshat në mua ka lënë një gjurmë të pashlyeshme prej fëmijërisë e deri sot. Kështu që, nuk ka qenë çështja ime, apo përpjekja ime vendimtare, por më tepër ka qenë një politikë botuese, se kur do të botohet përmbledhja! Imja ka qenë të shkruaj, kurse e të tjerëve, më tepër të mbajnë një politikë të caktuar, se kur do të botohet përmbledhja.

• ... Po, mos vallë, u deshën 30 vjet që të botohet një përmbledhje, apo ju gjatë atyre 30 vjetve i keni krijuar ato gradualisht, që sot kanë arritur sasinë mbi 60 ?

- Po, natyrisht, është një kohë e gjatë, por mendoj se megjithatë, për një vepër kurrë s'është vonë.

• ... Ju e keni dëshmuar veten me romanet: „I treturi”; „Murgesha”, „Shtrojera”, „Dhëngrenësit”, „Drenusha”, „Murana” etj. Nisur nga romanet dhe llojet e tjera të prozës që keni kultivuar, vërehet se jeni frymëzuar nga një realitet objektiv. Si e shikoni relacionin në mes realitetit dhe artit, d.m.th. relacionin: realitet-art?

- Romani i parë „Murgesha” është botuar në vitin 66, pastaj vijnë romanet e tjera: „Shtrojera”, „Dhëngrenësit”, „I treturi” dhe „Murana”. Këto janë botuar në vazhdimë në revista a në gazeta dhe kanë ngelur si të tilla. Pastaj kam botuar edhe romanin „Drenusha” dhe tash, në kohë të fundit, romanin më të ri „Egjra”.

• ... Për „Egjren” do të bisedojmë pakëz më gjerësisht, po të ndalemi pak për relacionin realiteti-arti...

- Unë personalisht mendoj se nuk ka art të mirëfilltë pa një realitet, pa një bazë të realitetit, që do të ketë ndodhur ose që mund të ndodhë; dhe, e kundërta, nuk mund të ketë as realitet pa e përcjellë arti, d.m.th., pa ndikimin e ndërsjellë të këtyre të dyjave. Njëra pa tjetrën nuk kanë kurrfarë vlere.

• ... Ju më shumë keni besim në krijimtarinë artistike-letrare dhe nuk i përfillni konceptet teorike të krijimtarisë. Si e shpjegoni këtë?...

- Është e vërtetë! Është e vërtetë se ia kam frikën shumë teorisë së letërsisë! Nëse aty-këtu hasim ndonjë element të teorisë së letërsisë, më rrok njëfarë e dridhure në trup dhe nuk e ndiej veten mirë, se mos po bie nën ndikimin apo mos po gërshetohem thjesht në krijimtari. Nuk dëshiroj t'u përmbahem rregullave të teorisë, për arsye se, mendoj, teoria nuk është aq e vjetër sa është krijimtaria. Teoria ka lindur në bazë të krijimtarisë. Në këtë mënyrë, mua, bie fjala, më pengojnë shumë disa kritikë që tepër e sforcojnë elementin teorik të krijimtarisë dhe harrojnë se veprat më të reja, në qarqet botërore e demantojnë këtë, se vetëm ato vepra që nuk u përmbahen rregullave, po ua imponojnë ngjarjet më karakteristike dhe më dominante ndër njerëz në botë, e dominojnë artin e letërsisë në përgjithësi.

• ... Jeni edhe autor i publikimit informativ „Shkrimtarët e Kosovës '43-'83”. Sa kohë iu desh që ta punonit këtë...?

- Në këtë projekt nuk kam punuar vetëm, po me një ekip të kritikëve dhe të shkrimtarëve nga Shoqata e Shkrimtarëve e Kosovës. Kemi punuar në këtë projekt intensivisht një vit të tërë. Pikësynimi ynë ka qenë të japim një panoramë, si të them, më tepër informative për shkrimtarët tanë, duke vënë në pah elementet bibliografike dhe nga një punim të shkurtër letrar. Ky lloj doracaku, u ka hyrë në përdorim nxënësve, studentëve dhe lexuesve përgjithësisht, ngase, nëse ndonjë vepër e caktuar letrare i ka pëlqyer lexuesit, ai nuk ka ditur të orientohet se ku t'i gjejë, dhe nëse ka i njëjti shkrimtar edhe ndonjë vepër tjetër të botuar. Pikësynimi ynë nuk ka qenë të japim ndonjë antologji, siç është pretenduar të thuhet më vonë,

por vetëm një publikim informativ më tepër. Kjo, mendoj se ka plotësuar nevojat. Vetë koha ka demantuar disa kritika, se që ka plotësuar atë zbrazëtimë siç thonë, të nënqiellit tonë lexues.

(Po veçojmë një fragment nga „Zjarri i çupëlinës”...)

• ... *T'i kthehemi Nebilit e jo krijuesit, çfarë bëni në kohë të lirë, çfarë lexoni?*

- Po shikoni, kohë të lirë deri më tash kam pasur shumë pakëz fare pakëz. Së shpejti do të përgatitem që të kem kohë të lirë, që ndoshta s'do të di as vetë se ç'do të bëjë me atë kohë të lirë; d.m.th., përgatitem të shkoj në pension, ngase kam filluar të punoj në moshë shumë të re; kam filluar në moshën pesëmbëdhjetëvjeçare, vonë ia kam filluar edhe shkollimit...

• ... *Çfarë punoni? Unë e di, po dëgjuesit...*

- Jam redaktor në Televizionin e Prishtinës. Gjatë këtij viti shpresoj se do të pensionohem.

• ... *Çfarë lexoni?*

- Lexoj vepra letrare, natyrisht i lexoj ato vepra që kanë një stil tërheqës. Pa një stil të fortë, pa një stil tërheqës, sado që të jetë ngjarja interesante, vështirë e kam ta përfundoj.

• ... *A janë ato vepra letrare lloje të ndryshme apo ju preokupon vetëm një lloj?*

- Jo, të ndryshme, mund të jenë nga më të ndryshmet. Më preokupojnë natyrisht veprat letrare që kanë të bëjnë me tematika sociale, edhe me tematika të tjera jo vetëm sociale...

• ... *Me siguri, këtë që thatë për nga tematika të ndryshme, pikërisht këto, ne i hasim në veprat tuaja, në romane...?*

- Po, është e vërtetë, por unë përpiqem, aq sa mundem, që, kur shkruaj, një vepër të jetë në çdo pikëpamje, të them ashtu, origjinale, të jetë edhe hulumtimi, si të them, në tematikë të jetë origjinale, të bëhen përpjekje, se, kur të më lindë frymëzimi, disi jetoj gjatë me protagonistët e mi dhe i vë në sprovë të ndryshme për një kohë të gjatë. Me ta kaloj në stuhitë të ndryshme, nëpër furtuna, disa prej tyre i merr vëshhima dhe ngelin vetëm ata që ngelin më besnik, me ta udhëtoj dhe për ta shkruaj...

• ... *Si e përjetoni Korbin në romanin „Egjra”?*...

- Në romanin „Egjra” Korbi është një personazh i kohës sonë, i cili ua fatin e dhjetëra mijëra punëtorëve tanë që punojnë dhe humbin toruan, e humbin rrugën në oborrin e vet.

• ... *T'i kthehemi fillimit të romanit, ta themi edhe këtë se ky roman u botua këtë vit, pra doli nga shtypi para disa ditësh (para gjysmë muaji), dhe, me sa jam informuar, romani „Egjra” u mirëprit nga lexuesit dhe është duke u kërkuar e po shitet mirë. Me sa di, gjysma e tirazhit është shitur, dhe kjo juve ju gëzon. T'i kthehemi fillimit: ngjarja fillon në Gjytet, jo Qytet po Gjytet! Ku gjendet ky...? A ekziston, apo vetëm në imagjinatën tuaj?...*

- Gjyteti ekziston, jo vetëm një, po shtatë Gjytete janë në Drenicë.

• ... *Në këtë roman emrat e njerëzve i hasim si nofkë! Nofka e parë që hasa unë, ishte nofka e Kokorrit?!...*

- Po, Xha Kokorri, ndonëse i verbër, ka njëfarë mbikëqyrjeje të përgjithshme mbi ngjarjet që zhvillohen tash, po edhe në të kaluarën në Gjytetin e vet, në njerëzit e tij. Si shpjegohet edhe në roman, këtë nofkë e merr, ngase si fëmijë i vogël shpesh del për të ruajtur kopshte në kokorr, në atë kasollen e ngritur diku në pemë, ose lartësuar diku në drunj, dhe nga kjo fëmijët e kanë pagëzuar me emrin Kokorr. Kështu që, me këto lloj nofkash hyri në modë dhe i gjithë fshati quhet me emra të tillë.

• ... *Nga kjo del se Kokorri, ky plak i verbër, në realitet është syri i fshatit?*

- Ashtu është, syri i padukshëm. Shpeshherë njerëzit shohin edhe kur i mbyllin sytë, ose edhe kur janë të verbër; këta madje, shohin shumë më tepër, pra mungesë e një shqisë, shkon në dobi të shqisave të tjera dhe këta lloj njerëzish janë në njëfarë mënyre fenomenalë.

• ... *Çfarë ngjarjesh sheh Kokorri?*

- Kokorri i sheh të gjitha luftërat në të kaluarën që kanë kërcënuar popullin e tij, kështjellën, Gjytetin përreth, ku edhe banon ai. Për atë gjë ai i kalon më se gjashtëdhjetë vjet me armë në dorë, nëpër luftëra të ndryshme...

• ... *Të flasim për Korbin, i cili është kryepersonazhi i këtij romani. Çfarë personazhi është ai për ju, pozitiv apo negativ?*

- Po, vështirë është të them për Korbin, nëse është personazh pozitiv apo negativ! Ka shumë elemente pozitive, ka edhe shumë negative. Kjo do të thotë se Korbi është një viktimë e kohës moderne. Është një papërgatitje e tij, për t'u vërsulur, për të vrapuar, për të nxituar nëpër rrugët e Evropës moderne. Evropa moderne atë e kapërdin...

• ... *Zotëri Nebil, a ka në këtë roman ndonjë ngjarje ireale?*

- Nuk ka. Të gjitha ngjarjet e këtij romani, pra asnjë kaptinë e romanit pothuajse nuk ekziston që të mos ketë pasur ndonjë bazë të frymëzimit real. Kam pasur fat, qoftë zyrtarisht, qoftë privatisht që kam udhëtuar nëpër Evropë dhe, gjatë takimeve me punëtorët tanë, po edhe këtu nëpër fshatrat tona, njerëzit tanë, ngjarjet tona i kam njohur shumë dhe më kanë bërë përshtypje të posaçme, kështu që ky është një rezultat i frymëzimeve nga jeta reale.

(Në vazhdim lexojmë një fragment nga romani „Egjra” ...)

• ... *Romani „Egjra” doli nga shtypi, çfarë tjetër?*

- Tash për tash kam ca plane pak më të vogla që kërkojnë përpjekje më të vogël, kështu që, të them - të pleqërisë. Këto sepse u kam borxh lexuesve, që, bie fjala, disa vepra që janë botuar shumë më herët, bie fjala romani „Shtrojera”, që është shkruar gati para një çerek shekulli, jam duke e përpunuar, duke e kthyer në gjuhën e sotme letrare, e po kështu do të bëj edhe më, bie fjala, me romanin „Murgesha” e ndonjë tjetër, nëse më mban shëndeti...

• ... *Ne ju urojmë shëndet, ju urojmë që sa më parë t'i shfletojmë qoftë „Shtrojerën”, qoftë „Murgeshën” dhe natyrisht „Egjren”, si dhe të gjitha ato vepra që do t'i krijoni. Me siguri ky nuk do të jetë takimi ynë i fundit, ne përsëri do të takohemi, do të bisedojmë rreth asaj që ju do të na ofroni në të ardhmen!...*

- Ju faleminderit!...

Radio Prishtina
korrik, 1989

III. Përkujtime

Ahmet Kelmendi

**Për një vit jo të plotë, kreu katër klasë fillore
dhe një të mesme ekonomike**

Rifat KUKAJ

Shkrimtari që jetoi me brengë për fatin tonë

Në mos më mashtroftë kujtesa, Nebil Durakun e njoha në vjeshtën e vitit 1953, ditën kur po rekrutohej për në ushtri. Ai ishte bashkë me shumë moshatarë në Skënderaj. Takimi im i parë me të më është ngulitur në kujtesë si një takim me një njeri që nuk harrohet kurrë. Përherë ishte pedant. Dhe - i buzëqeshur. Ishte i pashëm me flokët valë-valë. Ditën kur e njoha, kishte veshur një palë rroba të stofit të shtrenjtë kangar bojëkafe me vija të ngushta. Kishte një këmishë të bardhë dhe një kravatë, po ashtu, bojëkafe, por të lidhur nyjë me një elegancë. Këpucët e zeza të lustruara i shkëlqenin.

Kudo që kam hasur nxënës të tij, më kanë shprehur admirimin për mësuesin e tyre të afërt e aq të dashur. Nebili ishte njëri ndër mësuesit e hershëm në Drenicë që me tërë qenien u dhanë për shkollimin e fëmijëve dhe të vashave më të rritura nëpër kurset shëndetësore. Punoj me përkushtim pa e kursyer veten kurrë.

Edhe më vonë si gazetar në „Rilindja” e më pas në Televizion, shkrimet e tij janë ndjekur me interesim nga lexuesit e teleshikuesit. Kishte prirje të rrallë për të vjelë temat e idetë nga terreni. Fejtonet e tij në gazetë kanë qenë më të lexuarit. Si njeri që ndiente dhembje për të varfrit, dendur shkruante në shtypin e Zagrebit e të Lubjanës dhe disa herë familjet që kishin raste sociale merrnin pako me ushqime e veshmbathje nga lexuesit jashtë Kosovës.

Gjithmonë kishte zakon të fliste për të kaluarën tonë të hidhur dhe për shtypjet që na bëheshin në adresën: pse qemë vetëm shqiptarë! Në periodikun jashtë Kosovës pat botuar një sërë shkrimesh për lëvizjen kaçake dhe për deformimet që patën ndodhur në Kosovë.

Është njëri ndër shkrimtarët tanë të rrallë që librin e mirë që lexonte (e kishte lexuar shumë), mezi priste të ma parapëlqente ose të ma jepte për ta lexuar. Ka pasur shprehi për të biseduar për subjektet e veprave të tij. Më kujtohet sa me entuziazëm më fliste për fatin e një femre në Manastirin e Deviçit, jo larg

Skënderajt para se ta ngrinte këtë subjekt në romanin „Murgesha”. Po kështu më kishte folur edhe për veprat e tjera.

Përvoja si gazetar i ka ndihmuar të gjejë frymëzime kudo nëpër udhëtimet e tij, duke njohur njerëz dhe zakone të viseve të ndryshme. I kishte në qejf udhëtimet dhe për orë të tëra më fliste për përshtypjet e tij. Më kujtohet që njëherë ishim bashkë deri në Varna të Bullgarisë dhe në bibliotekën personale të një drenicasi (që kishte ikur nga ushtria) dhe ishte vendosur aty, gjetëm librin e njohur të Tagorës në shqip: „Stuhi në Gand”, që e sollëm dhe e pat botuar Redaksia e Botimeve „Rilindja”.

Ishte ndër gazetarët dhe shkrimtarët e rrallë që në çdo çast kishte dëshirë t’i ndihmonte penat e reja, duke u folur për letërsinë, artet, dhe duke i udhëzuar çfarë librash do të duhej të lexonin që të fitonin nga përvojat e të tjerëve. Përherë ishte një bashkëbisedues që më frymëzonte. Kishte humor të lehtë e nganjëherë dinte të ishte deri në fund edhe sarkastik!

Për veprat e tij letrare fjalën e ka dhënë kritika (oficiele), por po cek se librat e tij janë kërkuar e lexuar, sepse gjithnjë kanë qenë të mbështetur, siç thuhet, në tabanin kombëtar dhe me përmbajtje joshëse, duke i pasqyruar mjaft bindshëm vuajtjet tona në këtë hapësirë. Librat e tij kudo i kam hasur nëpër bibliotekat e shkollave, zakonisht të grisur ngase janë përdorur e lexuar shumë. Shpesh, kur i flisja për këtë, ai gëzohej shumë. Ishte njeri modest dhe shumë i përshtatshëm për bashkëpunim me redaktorët e shtëpisë botuese. Kishte durim që dorëshkrimin ta korrigjonte apo të them: ta përmirësonte me kujdes të madh.

Në ditët kur e kishte lodhur sëmundja e eshtrave, gjatë një vizite që i kisha bërë, më pat thënë se po ndaheshim, por unë u përpoqa të bëja një humor. Mendoja se i dhashë kurajë për jetë, por ai e dinte të vërtetën. Nga viti 1981 e këndej ishte tepër i shqetësuar dhe i mllefosur, duke mos mundur t’i duronte trysnitë mbi ne. Kishte ende plane dhe ambicie që të shkruante edhe më. Edhe gjatë lëngimit më fliste për dorëshkrimet e ardhshme.

Bashkëvendësit i ka dashur dhe i ka çmuar shumë, por dinte të bëhej edhe qortues i ashpër për prapshtitë tona, sidomos në Drenicë, kur ndonjë intelektual nuk merrej me punën e profesionit të tij për të arritur e për të bërë emër, por duke i njollosur të tjerët.

Jetoi me brengë për fatin tonë dhe vdiq po me këtë brengë. Kohët e fundit e nevríkoste shtypi joshqiptar për të gjitha ato fabrikime dezinformatash për ne, për të gjitha ato gënjeshtër. Më thoshte se tërë kjo ishte një vazhdimësi, një vartësi qysh para Çubriloviqit, të mjerushit famëkeq, e këndej për zhbërjen tonë si komb në këto troje të stërlashta, por që nuk do t’ia dalin kurrë. Madje shpesh thoshte: „Kjo është një politikë famëkeqe!” Por, fatmirësisht, pandehte shpesh ai: Kësaj i themi ne: „Hedh farë në lumë!”

Në kohën kur prisnim të ishte ca më i qetë - thënë kushtimisht, në pension, që të na jepte realizime të reja artistike, ai u nda prej nesh, pa dëshirën e tij. Vdekja e mori me vete, por fatmirësisht veprat e tij na mbetën kujtime të përhershme nëpër shekuj...

Ramiz Kelmendi

Mirënjohje pas 37 vjetësh

Shumë vjet pune të përbashkët në „Rilindje” dhe letra më lidhin me Nebil Durakun. Por një mirënjohje ia kam borxh të veçantë: ishte Nebili, më i pari, që bëri një intervistë me mua në jetën time deri atë ditë.

Ndodhi kjo plot 37 vjet përpara, më 13 mars 1960.

Pasi konstatonte se në anketën shpërblyese të „Rilindjes” reporteri i lirë i kësaj gazete, R.K., pati numrin më të madh të lexuesve, Nebil Duraku - mu për këtë qëllim - bëri një intervistë të shkurtër me të, për t’u paraqitur lexuesve edhe më afër nga ç’e njihnin nëpërmjet shkrimeve të tij gazetare dhe letrare.

Ne sapo kishim filluar, asokohe, të shkruanim. Po bënim hapat e parë. Gjthçka kishim nisur, të thuash, nga fillimi. Edhe në gazetari. Edhe në letërsi. Unë e Nebili kishim mësues, në gazetari: Haki Hoxhën, Mustafë Shalën, Masar Murtezain, kurse në letërsi: Esad Mekulin, Tajar Hatipin, Zekeria Rexhën...

Ishim pak. Pak në numër dhe pak në cilësi. Së këndejmi edhe kërsëria për të na njohur më nga afër, për të mësuar se kur zëmë të interesohemi për shkrime, kur filluam të shkruajmë për gazetë, kur krijuam ndonjë skicë, tregim a vjershë.

Intervistën e parë me mua të Nebil Durakut, të fotokopjuar, e kam para sysh, mbi tavolinë. E shikoj me kërsëri të madhe dhe saora më pleksin emocionet. Nga më të shumtat dhe më të ndryshmet të atyre moteve të përmendura, kur sapo kisha mbushur të tridhjetat dhe - si Nebili, edhe unë - ende nuk ishim të sigurt dhe assesi të ndanim mendjen se a do t’i kushtoheshim përfundimisht vetëm gazetarisë, vetëm letërsisë, apo do të bëjmë edhe gazetari, edhe letërsi.

Mbase edhe pa dëshirën tonë të madhe, si ai edhe unë, sigurisht në radhë të parë për „kafshatën e gojës” - meqë zor të gjeje mundësi vetëm nga krijimtaria letrare - kohën „zyrtare” ia kushtuam gazetës, kurse kohën „e lirë” - letërsisë. Ndaj bëmë njëherësh edhe punën e gazetarit, edhe punën e shkrimtarit.

Ka një të veçantë kurioze kjo intervistë e Nebil Durakut, po të kihet parasysh koha, në të cilën u bë: viti 1960, nënshkruar vetëm me siglat „N.D.”, për shkak se shoku, mikun e kolegu po intervistonte shokun, mikun e kolegun e vet, intervista me një fotografi që, e shikuar sot, gati-gati nuk ka ngjashmëri fare me pamjen aktuale të të intervistuarit, nga shumë anë është me interes.

Duke nisur nga pyetja e tij e parë e deri tek ajo e fundit. Pyetja e parë: Si dhe kur filluat të merreni me shkrime gazetare (letrare)? Pyetja e dytë: A ju kujtohet shkrimi i parë, fati i tij? Dhe, pas tyre, edhe pyetjet e tjera me radhë, deri në fund:

„Çka mendoni: pse jeni gazetari më i lexuar i ‘Rilindjes’?”

„Ç’do t’i thoshit reporterit të ri, me bllok, laps dhe me fotoaparaturë në dorë?”

„Çka çmoni më së shumti në këtë çast: talentin, kohën, apo radhitjen e rreshtave në qetësi? Cila ju mungon nga këto?”

„A ju pengon shkrimi i reportazheve për krijimet tuaja letrare?”

„Në çfarë kohe shkruani më tepër?”

„Nëpër disa gazeta qendrore praktikojnë botimin e reportazheve më të mira në një përmbledhje, eventualisht të veçantë. A mendoni edhe ju të botoni një përmbledhje të tillë reportazhesh të shkruara deri tash?”

„Cilin lexues e çmoni më tepër?”

„Nëpër shkrimet tuaja letrare apo gazetare lexuesi gjen gjallëri të madhe, dinamizëm. Si do t’ia përshkruanit lexuesit portretin dhe zellin tuaj?”

„A mund të na tregoni gjë mbi veprimtarinë tuaj letrare këto ditë?”

Duke ruajtur në kujtesë shumë çaste të bukura nga takimet, nga jeta dhe nga puna me Nebil Durakun, unë i detyrohem atij për intervistën më të parë të bërë me mua dhe qoftë edhe vetëm me këta dy-tre rreshta dua të shpreh ndjenjat e mia të sinqerta të mirënjohjes për punën e tij në gazetari dhe në letërsi.

Dalan Shaplo

Zemër e dhimbshme, plot dashuri për trimat

Shkrimtari dhe gazetari kosovar Nebil Duraku u nda nga gjiri i të afërmve, i shokëve dhe miqve të tij, duke lënë pas kujtimin e një jete të ndershme, një emër të krijuar me punë e kërkime dhe vepra që ai i la lexuesit, në përshtypjet e veta të drejtpërdrejta, me mendim të urtë dhe ndjenja të holla. Ky njeri që na sheh tani nga fotografia me një buzëqeshje të përzëmërt e me sy të menduar, punoi e brodhi shumë gjersa arriti të shprehë botën e tij dhe pjesë të realitetit të kaluar e të sotëm kosovar në shkrime e reportazhe, radiodrama e romane, të cilat do të lënë gjurmët e tyre në letërsinë kosovare.

Nebil Duraku, lindi në Burojë të Drenicës më 1934. Ishte thujse autodidakt; bëri shkollë pa shkëputje nga puna. Në fillim ishte mësues në Prekaz të Epërm, në Runikë dhe në Turiçefc. Pastaj punoi si gazetar në „Rilindja” e më pas në Radiotelevizionin e Prishtinës. Shkrimet e para i botoi në fillim të viteve '50. Eci në rrugën e krijimtarisë letrare duke u zhvilluar dhe duke rrahur gjini të ndryshme. Ishte gazetar dhe shkrimtar aktiv. Hartues i talentuar i një analogjie të gjerë, të pajisur me shënime e me komente: „Shkrimtarët e Kosovës '43-'83”, të cilën e botoi më 1984. Kjo përmbledhje me tregime, fragmente romanesh, poezi e copa kritikash nga tërë krijuesit kosovarë, është një paraqitje e plotë dhe një dokument plot kuptim i kulturës letrare që kanë lëvruar e përhapin në Kosovë, krijues të dalë nga gjiri i popullit, në rrethana të vështira, plotë luftë e sakrifica, me këmbëngulje për të ngritur lart këtë kulturë, me dashuri për popullin e vet dhe me nderim për popujt e tjerë. Në krye të kësaj përmbledhjeje të gjerë Nebili vë vargjet kushtuar Kosovës: „Kosovë, yll i të rrahurave të zemrës/ i vdekjeve dhe i lindjeve/ i puthjeve të nënave/ në damarët tu ke gjakun tonë!”

Ai shkroi tregime dhe radiodrama si: „Tregtari i kafshatave të dreqit”, „Kah fryn era” dhe dramën televizive „Kopshti i pleqërisë”. U vu në skenë drama e tij „Maska e çjerrë”. N. Duraku botoi romanin „Murgësja” (1963), „Shtrojera” (1969),

„Dhengrënësit” (1971), „Drenusha” (1980), „I treturi” (1983). Botoi edhe përmbledhjen me tregime „Kobi” si dhe shkrime të tjera. Në krijimet e tij përshkruhet historia e popullit të vet, bën fjalë për aspekte të jetës që shkrimtari donte të stigmatizonte, ngrihen probleme shoqërore dhe del qartë romantika e jetës. Në romanet „Drenusha” dhe „I treturi”, me një rrëfim të shtruar e poetik, pasqyrohet drama dhe tragjedia e njeriut të thjeshtë kosovar në periudhën në prag të Luftës së Dytë Botërore, si edhe fati i emigrantit që tretej në dhe të huaj dhe nuk arrinte dot të kthehej i gjallë në shtëpinë e tij. Fshatari Malush Ukshini, i ikur në Melburn të Australisë, kthehet për në vendlindje, ndërsa avioni fluturon, atij i pështjellohen kujtimet, ëndrrat e mendimet dhe, kur arrin, bie i vdekur. Njerëzit e presin dhe kujdestari në aeroport u thotë: „Urdhëroni, kjo është valixhja e tij”. Ç’fund tragjik, përmes këtij detaji të thjeshtë!

Romani „Drenusha”, shkruar me gjuhë të bukur dhe me njohje të jetës e të mjedisit fshatar, përshkruan me dhimbje fatin e rëndë të vajzës shqiptare që kërcënohej nga një shtypje e dyfishtë, që vuante nga bejlerët dhe shërbëtorët e tyre. Drenusha ishte e pastër në shpirt, e guximshme. Ajo donte një djalë të ri fshatar, dhe kjo i jepte forcë. Drenusha u arratis nga saraji i beut, ku e kishin mbyllur, dhe, më pas, me fshatarë, vëllezër e motra të saj, luftuan fashizmin. Tema të tilla të përfaqëta me një shtrat më të gjerë e rrëfim shumëplanësh, janë rrahur nga shkrimtarë të njohur kosovarë si N. Rrahmani, R. Kelmendi etj.

Nebil Duraku ishte një vrojtues i mprehtë i jetës dhe kishte një zemër të dhimbshme ndaj atyre që vuanin: zemra e tij ishte plot dashuri dhe adhurim për trimat.

Ne shprehim dhimbjen tonë për vdekjen e parakohshme të Nebil Durakut, të këtij shkrimtari e gazetari aktiv, që e shkroi me dashuri gjuhën shqipe, që krijoi vepra të frymëzuara me ndjenjë patriotike e humaniste.

„Drita”
nëntor, 1989

Mehmet Kajtazi

Njeri gojëmbël - shok i vërtetë...

Ditë më parë pushoi së rrahuri zemra e shkrimtarit tonë Nebil Duraku, në një spital të Zagrebit, më 26 tetor 1989, ndërsa më 27 tetor u varros në Prishtinë. Nebil Duraku lindi më 1934, në fshatin Burojë të Drenicës. Në mes të datës së lindjes dhe të vdekjes së tij kanë ndodhur ngjarje të ndryshme. Gjatë kësaj periudhe u bënë në rruzullin tokësor shumë luftëra, njëra prej tyre u shtri në front shumë të madh: ajo ishte Lufta e Dytë Botërore. Gjatë kësaj periudhe pati edhe vdekje të shumta, por pati më shumë lindje; gjatë kësaj periudhe bëmë hapa të mëdhenj edhe në letërsi. Kështu më pat thënë Nebil Duraku më një shkurt 1986, në një bisedë që bëmë për Hivzi Sulejmanin. Nebili nxori nga sirtari i tavolinës së punës një letër. Pasi e lexova me kujdes, ia dërgova gazetës së studentëve „Bota e re”, dhe ata e botuan më 15 shkurt 1986. Meqë letra ka rëndësi të shumëfishtë, po u rikujtojmë lexuesve përmbajtjen e saj:

„Shkrimtari ynë, Hivzi Sulejmani, nuk është më me duar të lidhura pas shpine, duke shëtitur rrugëve që shpien nga Gërmia; nuk është as në mbledhje të Shoqatës së Shkrimtarëve, nuk është as në ordinancë të mjekut duke u këshilluar për sëmundjen që e mundonte. Hivzi Sulejmani është në zemrat e të gjithë atyre që e duan artin militant. Nuk është më as Nebil Duraku, por kanë mbetur shumë fije të përbashkëta që thurin kurorën më të bukur me emrin - letërsi.”

Më 1969, Nebil Duraku (atëherë gazetar në „Rilindje”), pat shkruar për familjen e Daut Mire Muçajt, nga Jabllanica e Madhe e Pejës, të cilëve u patën lindur trenjakë. Për shpëtimin e tyre kujdesej një spital i Beogradit, prej nga erdhi lajmi se trenjakët i përballuan mirë jetës në inkubator, prandaj Dauti duhej të shkonte në Boegrad që t’i merrte fëmijët e vet. Dauti u gëzua shumë për këtë, por nuk kishte para për të shkuar atje. „Rilindja” reagoi menjëherë për këtë. Pas shkrimit në gazetë KE i Kuvendit të Kosovës dha për këtë familje gjysmë milioni dinarë. Vlerë kishin

ato para atëherë. Shkrimi bëri jehonë edhe në Slloveni, prej nga kësaj familjeje i erdhën 36 pako me rroba të ndryshme. Lubjana dhe Maribori ndihmuan edhe me të holla e pastaj në truallin e kasolles u ngrit një shtëpi e re. Hivzi Sulejmani jo vetëm që pëlqeu shkrimin e Nebil Durakut, të cilit ia dërgoi letrën që zumë ngoje pak më parë, por ai në adresë të familjes Muçaj dërgoi 50 mijë dinarë.

- Unë kam mësuar shumë nga Hivzi Sulejmani, - tha ditën kur ia dërgova „Botën e re” Nebil Durakut, dhe shtoi se njeriu duhet të jetë i njëjtë si në art, ashtu edhe në jetë.

Më 17.4.1989, një trokitje e zakonshme në derën e banesës sime. Im bir, Migjeni, e hapi derën. Xhaxhi Nebil, xhaxhi Nebil!, - tha ai i gëzuar dy herë. Të gjithë e përqaftuam. Të gjithë anëtarët e familjes u gëzuam. Ai një javë më parë kishte qenë në Lubjanë, mjekët i kishin thënë „diçka” që duhej ta dinin të gjithë për natyrën e sëmundjes, „diçka” që duhej të dinte vetëm ai që e bart atë sëmundje. Ai nuk deshi të bisedonte për sëmundjen më gjatë. Edhe një sëmundje e munda, tha Nebili, qeshi, e pyeti Migjenin për ndonjë libër të ri që ka lexuar.

- Do ta lexosh edhe këtë libër? - pyeti dhe në syprinë të tavolinës vuri romanin e sapobotuar „Egjra”.

Shtatë palë duar e uruan...

Nebili s’u duk më në banesën time, në „Kodër të Diellit”.

Më 28 tetor 1989 u zgjova herët për ta blerë „Rilindjen”. Një ditë më parë Nebili u varros. Nebili u varros! Këtë fjali të shkurtër s’pandehja se do ta shkruaja ndonjëherë në jetën time. Fjalitë që nuk i ke në qejf, të vijnë nganjëherë, ta bëjnë zemrën me gjirmë. Kisha dalë te qoshku i gazetave para se të vinte „Rilindja”. Ndeza një cigare, prisja, kamioneta me gazeta erdhi me zhurmë. E shfletova gazetën tonë, dëshiroja ta shihja ç’shkrim ka për Nebilin. Xh. Mustafa nën shtyllën horizontale, të zezë, me titull „Me rastin e vdekjes së Nebil Durakut” shkrimin të vet i kishte vënë titullin: „Shkrimtari i përjetimit të drejtpërdrejtë”. E pëlqeva shkrimin, prandaj nuk do të hidhërohet që do t’i huazoj pak fjali edhe për revistën „Fjala”: „Sidoqoftë, tash kur shkrimtari ynë Nebil Duraku, nuk është më ndër të gjallët, tash kur rrethi i krijuesve tanë letrarë është më i ngushtë për një autor që akoma do të mund të kontribuonte në begatinë e letërsisë, tash edhe në këtë moment, pra, hapet shtegu që veprat letrare të këtij shkrimtari të lexohen, të çmohen e të vlerësohen në mënyrë të gjithanshme nga specialistë të letërsisë sonë. Dhe, në këtë lexim dhe vlerësim të gjithanshëm, përveç romaneve: „Drenusha”, „Egjra”, „Shtrojera”, duhet të përfshihen edhe romanet e tjera.”

Në fund Xh. Mustafa shkruan:

„Ky është fati i shkrimtarit: ata vdesin që të jetojë vepra e tyre”.

Mirë kishte bërë edhe redaksia e kulturës e kësaj gazete që kishte botuar një fragment: „DASMA E KORBIT”, të romanit „EGJRA”, por sa keq kishte punuar redaksia tjetër, që përgatiti ngjarjet e ditës. Lëre që ishte shkurtuar informata, ishte shkurtuar edhe ajo pjesë që duhej t’i informonte lexuesit se pranë varrit të Nebil Durakut u vu kurora e Shoqatës së Shkrimtarëve të Kosovës, anëtar i së cilës ishte dhe njëri ndër themeluesit e Shoqatës, por edhe ishte botuar në faqe të fundit, në

fund të faqes. Nganjëherë vdekja e një shkrimtari për redaktorët e ngjarjeve të pasditës është ngjarje e vogël, se ata janë të preokupuar nga ngjarje që s'e kanë emrin letërsi, por politikë. Kaq, thashë dhe e mbylla gazetën.

- As mua nuk më rrihej në shtëpi, andaj dola, - tha Hajro Ulqinaku, shkrimtari ynë për fëmijë. - Na la Nebili, - tha ai, dhe hynë së bashku që të pinim nga një kafe. Ja çka mendoj unë për Nebil Durakun, shtoi Hajroja: „Njeri gojëmbël, shok i vërtetë”.

- Nebil Duraku, - tregoi pastaj Hajro Ulqinaku, - shpesh vinte në Redaksinë për fëmijë të TV Prishtinës, vinte gjithnjë me ide të reja. Herën e fundit më pat propozuar idenë për një skenar nga jeta e fëmijëve tanë në fshat, të cilëve prindërit u punojnë në Gjermani, në Zvicër e në shtete të tjera. Sa e donte letërsinë për fëmijë, aq e donte edhe letërsinë për të rritur. Nuk mund të bëj dallime, - thoshte ai. - A është vetë deti letërsia për fëmijë, apo është mali, apo deti dhe mali janë së bashku. Nebili më ka pasë folur edhe për përmbajtjen e një romani për të rritur, që e kishte temën nga deti. Ngjarja zhvillohej diku në ranishtën e Ulqinit. Kryepersonazhi ishte një gjerman, i cili kishte ardhur si turist në Ulqin, por në Luftën e Dytë Botërore po ai gjerman kishte qenë në anën e fashistëve. Gjermani sa nuk ishte përplasur për një rragam kur i ishte kujtuar hapi i tij i çmendur drejt rrëmbimit të lirive të të pafajshmëve.

- Ka dalë, a s'ka dalë romani që bën fjalë për atë gjerman? - pyeti Hajroja. I tregojmë se ka dalë dhe ai tregon se do ta blejë e do ta lexojë sa më parë.

Sërisht po kthehem prapa për një ditë. Dihet: në ditën e varrimit të Nebil Durakut. Një rresht i gjatë i njerëzve ecin pas trupit të tij. Hapat e djalit dhe vajzës së Nebilit, janë të matur, lotët nuk i shpalosin faqeve. Selim Spahiu, mësues veteran, që ka punuar së bashku me Nebilin, ka ardhur nga Skënderaj, kanë ardhur edhe shumë drenicakë nga fshatrat e ndryshme. Kanë ardhur për të marrë pjesë „në ditën e fundit” të Nebilit edhe shumë njerëz nga anë të ndryshme të Kosovës. Daut Demakut, prozatorit tonë, i rrjedhin lotët. - Ku ta ndal lotin, - thotë ai, dhe tregon se një plak që kishte ardhur nga Istogu, më rrëfeu:

- Nuk e kam parë kurrë Nebil Durakun, por ia kam lexuar romanet e tij. Kam ardhur vetëm nga Istogu... o, nuk kam ardhur vetëm, po me vete e kam romanin „Egjra”. Sa roman i mirë është edhe „Shtrojera”!

Në varrezat e Prishtinës të gjithë ndahemi. Akëcili shkon në shtëpi të vet. Ndarje e zakonshme, por thuaja të gjithëve na bashkon nata. Nata e parë pa Nebil Durakun. Ndoshta nuk kam të drejtë, por unë fillim të natës ka kohë që e marr kohën kur fillon ditari në TV (ditari i orës nëntëmbëdhjetë e tridhjetë). Në orën nëntëmbëdhjetë e lëviz sustën e radios. Dua ta dëgjoj Radio-Prishtinën. Sa pikëlluese e të mërzitshme më duken lajmet që tregojnë për luftërat nëpër botë. Sa gëzohem kur dëgjoj se në Afrikën e Jugut po lirohen nga burgu zezakët që luftojnë për të drejtat e tyre. Redaktori i ditarit në radio paralajmëron: „Sot në varrezat e Prishtinës u varros me nderime shkrimtari ynë i mirënjohur Nebil Duraku. Në praninë e disa qindra qytetarëve, të anëtarëve të familjes e të punonjësve të

„Rilindjes” e të Radio-Televizionit të Prishtinës për herë të fundit nga i ndjeri u nda kolegu i tij i Redaksisë dokumentare, Bajram Sefaj”.

Pas këtij paralajmërimi jepet vështrimi i shkrimtarit dhe i redaktorit të Radio-Prishtinës, Mehmet Hazirit, i cili tha:

- Shkrimtarët veçohen nga njerëzit e tjerë, për shkak të aftësisë së vrojtimit, por edhe të përjetimit artistik të fenomeneve shoqërore e jetësore. Kjo aftësi e tyre shpesh ua gërryen shëndetin, por edhe u dhuron një fat që nuk e kanë njerëzit e tjerë. Ata mbesin të jetojnë edhe pas vdekjes së tyre, të komunikojnë me brezat e tashëm e të ardhshëm. I tillë është edhe Nebil Duraku, të cilin sot e lëshuam në tokën që ai e përjetësoi në krijimtari, që e desh shumë dhe që shkriu për të shumë frymëzime. Nebili la pas vetes një fond të begatshëm në kopshtin e bukur të letërsisë sonë. Që në vitet '50 filloi rrëfimet e tij të jetës në letrat tona, për të kurorëzuar më vonë këtë nismë me romanet „Murgësja”, „Shtrojera”, „Dhengrënësit”, „Drenusha”, „Murana” dhe në këtë vit me romanin „Egjra”. Gjithë përvojën e tij jetësore, edhe atëherë si mësues nëpër fshatra të Drenicës, edhe më vonë në rrugëtimet e tij si gazetar, Nebil Duraku me penën e tij e skaliti në romanet, në tregimet, në fejtonet dhe në tekstet dramaturgjike. Drenica si truall i skamjes, por edhe i trimërisë së përhershme, si kopsht i urtësisë e i mprehtësisë popullore, dhe njeriu i saj mes shtigjesh, peripecish e sprovash, ishin gjithnjë të pranishme në krijimtarinë letrare të Nebil Durakut, që e pasqyroi edhe me nota të thella realiste. Realiteti në jetë dhe në art ishte normë e punës së tij krijuese. Ai këtë e pohonte gjithnjë, sa herë bisedonim me të. E kemi ruajtur edhe fjalën e gjallë të tij. Nebili e sprovoi penën e vet edhe në fushë të dramës. Para tridhjetë vjetësh në valët e Radio-Prishtinës u dha drama „Tregtari i kafshatave të dreqit”, që është pothuajse teksti i parë dramaturgjik në gjuhën shqipe tek ne, por ai shkroi edhe drama të tjera. Në mesin tonë nuk është më Nebil Duraku i urtë, i qetë, i dashur, por me ne dhe brezat që do të vijnë do të komunikojë vepra e tij, dramën, tregimet dhe romanet që na i la.”

Si u shkrua „Shtrojera” dhe përsëri shpalosje kujtimesh për Nebilin:

- Më kujtohet, - më tha Nebili, - kur erdha të punoja gazetar në „Rilindje”. Atë vit (viti 1955) isha mësues, ti ishe nxënës imi. Uleshe disi nga mesi i bankave. Një ditë hyra në klasën tuaj plot pikëllim. Ditarin e mbaja nën sqetull, e trokiste një urdhër që e kisha në xhep, të shkruar, të vulosur. Kishin urdhëruar që të mbyllej shkolla në fshatin Runikë.

- E kemi hetuar pikëllimin tënd të gjithë nxënësit, - i tregova Nebilit, por nuk dija se një ditë do të shkruanit roman për këtë.

- „Shtrojerën” e lindi populli, i cili këmbëngulës tha: „Nëse vërtet mungojnë mjetet për shkollë, siç paskan thënë ata që kanë ardhur me xhip, ne do t'i shesim tokat tona si dhe bagëtinë e pa shkollë nuk do të rrojmë dot”.

Ata që kishin dhënë urdhër për mbylljen e shkollës e tërhoqën urdhrin pas revoltës gjithëpopullore. - Po, kështu e ka jeta, kështu e ka fatin vepra letrare, - më tha Nebili dhe më pyeti:

- Mirë që e ke lexuar „Shtrojerën”, aq më mirë që të ka pëlqyer, por e ke lexuar kritikën letrare për këtë roman?

Pasi e kisha lexuar, pse të mos ia thosha, dhe nuk më kishte pëlqyer mendimi i shprehur i atij kritiku. Po, kritiku letrar, kur u ribotua romani „Shtrojera”, zgjodhi fjalët më të mira për ta lavdëruar. Edhe për këtë „mrekulli” biseduam me Nebilin. Disa kritikë, si të them, disa që veten e quajnë kritikë letrare, kanë zënë pozita të ndryshme nëpër gazeta, në revista dhe në redaksi të tjera, tha Nebili, kërkojnë që të hysh në klane me ta. Po nuk bëhesh pjesë e klaneve të tyre, ata një ditë të lavdërojnë, ditën tjetër të varrosin për së gjalli. Të tillët nuk merren me vepër letrare, të tillët tërë jetën e kalojnë me shpifje, me intriga. Ti je gazetar i ri, - më këshilloi ato ditë Nebili, - e nëse një ditë nisesh të merresh edhe me letërsi, ik sa të mundesh nga klanet që janë, prit kohën kur vetë klanet shthuren, shthuren se ato, si klane që janë, nuk e shikojnë interesin e përgjithshëm, por tërë jetën e mbështesin në interesin klanor! Medet, pse kemi të tillë, medet për krizën shpirtërore që e kanë ata, e që janë pjesë e krizës së përgjithshme në një shoqëri me krizë.

Ata nuk duhet ta luhasin kurrë krijuesin e mirëfilltë. Përkundrazi: duhet ta bëjnë të fortë, shumë më të qëndrueshëm. Kritikët që u përkasin klaneve, shpesh „bëjnë kritikë” për një vepër letrare pa e lexuar atë fare. Ata janë tragjikë, sa të duash, - thoshte Nebili.

Prej gazetarëve të brezit tim dallohen për risi në shkrime Rushit Ramabaja dhe Behlul Jashari. Ky i fundit, ato ditë botoi përmbledhjen e vjershave me titull: „Ecim kah një mrekulli”. Librin e kisha lexuar, më kishte pëlqyer. Prisja se ç’do të thoshte mësuesi im i dikurshëm, Nebili. „Nëse nuk e fusin në valle klanet, tha Nebil Duraku, Behlul Jashari do të jetë poet i shkëlqyeshëm. Ky edhe në reportazhe ka sjellë invencion”. - Vetëm ky?, - e pyeta. „Nuk është i vetmi prej gazetarëve të rinj që ka sjellë risi me anë të invencionit, por është edhe Rushit Ramabaja. E lexova edhe përmbledhjen e tij me vjersha për fëmijë, shumë e pëlqeva. Edhe Rushiti duhet të ruhet nga klanet, se ato mund ta shpallin në mëngjes hero, në mbrëmje t’i bëjnë njëqind makinacione. Klanet, duhet ta dinë Rushiti dhe Behluli, mund t’i përçajnë edhe krijuesit, se klanet punë tjetër nuk kanë, por vetëm të mos depërtojë e reja në gazetari, vetëm të mos depërtojë e reja në letërsi”. Tërë këtë që ma thoshte Nebili duke pirë kafe në ndërtesën e vjetër të „Rilindjes”, e forconte edhe më shumë në mbledhje të rubrikës, kur propozonte:

- Propozoj që kolegji i gazetës t’i shpërblejë këta gazetarë të rinj, të cilët javën që shkoi botuan nga dy reportazhe të shkëlqyeshme.

Ata që nuk e pëlqenin risinë në gazetari, pra, nuk pëlqenin risinë as në letërsi, nuk pajtoheshin me Nebilin. Kishte edhe të tillë që kurrë nuk kishin lexuar ndonjë roman, por flsinin si duhet të shkruhet romani. Kishte edhe të tillë që Nebilin e kritikonin pse po i përkrahte gazetarët e rinj, pse po shkruante vetë për njerëzit e thjeshtë. Të tillët „kishin gisht” në fizionomi të gazetës, të tillët në mbrëmje bënin plane me kritikët e klaneve për ta kritikuar edhe romanin më të ri të Nebilit.

Nebili një ditë u largua nga „Rilindja” për të punuar në TVP. Duhet të ketë pasur edhe në këtë shtëpi informative klane të ndryshme. Ai ikte nga klanet, hynte në dhomën e punës, punonte. „Tash që të dy po merremi me letërsi”, - më tha Nebili dhe më porositi që ta lexoja me kujdes dorëshkrimin e tij „Drenusha”. Para se të botohej dhe unë qeshë lexuesi i parë i këtij romani. Edhe Nebili ishte lexues i parë i dorëshkrimit tim „Plaku dhe urat”. Të dy këto romane („Drenusha”, 1980, dhe „Plaku dhe urat”, 1986), janë sot në duar të lexuesve.

Krijuesit duhet të komunikojnë ndërmjet tyre, thoshte Nebili dhe shprehte gëzimin e vet që edhe kritika letrare po ecën përpara. Perëndoi, ose është në perëndim „epoka” e atyre kritikëve, thoshte ai, të cilët e bindnin veten se janë ata që kanë në duar fatin e librit. Mirë që po botohen edhe vepra për kritikën letrare, do të thotë, sqaronte ai, jemi në kohën kur edhe më shumë do të kemi në duar vepra që flasin për qasjet e kritikëve letrarë.

«„Murgeshën”, „Dhengrënësit”, „Muranën”, por as tregimet me titull „Kobi”, - thoshte Nebil Duraku, - nuk do t’i shkruaja fare, sikur temën për to të mos e merrja nga realiteti e që t’ia ktheja sërish realitetit tjetër me emrin letërsi artistike. Për të vrojtuar sa më mirë këtë realitet e për ta „plasuar” pastaj në letër, nuk mjafton vetëm përjetimi, por edhe përvoja e të tjerëve. Unë, një pjesë të Amerikës, thoshte ai, e njoh në bazë të Markezit, siç e njoh një pjesë të jetës në Turqi edhe me anë të veprës së shkrimtarit turk Jashar Qemal, por me „sytë” e këtyre dy shkrimtarëve të anëve të ndryshme të botës, nuk mund ta shohësh realitetin tënd, por duhet t’i vësh syzet që i duron dielli i vendlindjes sate.»

Nebil Duraku më 1984 doli para lexuesve edhe me një libër me titull: „Shkrimtarët e Kosovës ’43-’83”. Në hyrje të këtij libri autori shkruan:

„Kërkesat gjithnjë e më të mëdha të botuesve, të përkthyesve, të kritikëve letrarë, të gazetarëve, të përpiluesve të teksteve shkollore ose të studentëve, të nxënësve dhe të lexuesve përgjithësisht për shënimet më elementare biografike dhe bibliografike të shkrimtarëve të Kosovës, na shtynë që ato t’i shoqërojmë me tekstet e zgjedhura të autorëve, të bindur se kështu do të kontribuojmë edhe për sendërtimin e kërkesave dhe të kërshërive të kohës për komunikim dhe këmbim të vlerave shpirtërore”.

Posa doli nga shtypi libri, një pjesë e klaneve që duhej të perëndojnë, sa nuk dogjën në turrën e druve Nebilin dhe librin e parë informativ për shkrimtarë. Ata që i kanë ndjekur me vëmendje shkrimet nëpër gazeta dhe në revista që botohen në gjuhën shqipe dhe serbokroate, kishin një bindje të tillë, e Nebili nuk kishte bërë tjetër, pos që brenda ballinave të një libri i kishte futur krijuesit që shkruajnë në gjuhën shqipe, serbokroate dhe turke! Me këtë çështje nuk merreshin ata që e kritikonin librin dhe autorin (themi edhe autorin, ngase vërejtje për librin nuk gjenin, por „gjenin” tek autori), të cilin e shpallnin „pa shkollë përkatëse” për të hartuar një libër të tillë. Shih, pra, ku shkojnë ata që merren me intriga: në mungesë të kulturës (e kultura nuk është garanci se është pjesë e ndonjë njeriu pse, bie fjala, bëhet magjistër) ata përpiluesin e librit sa nuk e dërguan edhe në gjyq. Më vonë u kuptua se kritikuesit e tillë kishin pasë vuajtur (të shkretit që kanë vuajtur!), pse

brenda ballinave të një libri të përbashkët janë edhe fytyrat e tyre të shenjta bashkë me disa krijues që sapo kishin filluar të shkruanin. Nebili, fatbardhësisht nuk doli në gjyq, por sërish iu kthye prozës dhe shkroi edhe dy romane të tjera.

Njëzet e gjashtë tetor 1989, ora dhjetë. Rifat Kukaj, shkrimtari ynë i mirënjohur, plot shqetësim pse ka marrë lajmin për vdekjen e Nebil Durakut, e quan jetën absurd! Ai, pastaj qetësohet pakëz, thotë: „Jeton vepra e tij”. Bashkë me Rifatin shkojmë për ta ngushëlluar familjen e Nebilit, trupi i të cilit ende ishte në Zagreb. Sa rëndë! Shtëpia e Nebilit plot me njerëz. Ka bujq, shkrimtarë, mjeshtër, ka policë të pensionuar, ka gazetarë. Të gjithë kanë ardhur për të ngushëlluar familjen e Nebilit. Të gjithë i puqin kujtimet dhe mendimet në një: ai do të jetojë përherë me ne, se i ka lënë prapa librat.

Kthehemi në Pallatin e Shtypit. Në hyrje të tij takoj kritikun Sylejman Sylja, dhe më thotë: «„Fjala” do t’ia kushtojë dy faqe Nebil Durakut.» Unë ngjitem pastaj me ashensor. Takoi në katin e tretë prozatorin Anton Pashku. Ishte shumë i shqetësuar, sepse pak më parë e kishin lajmëruar për vdekjen e Nebil Durakut. Ne e ngushëllojmë shoqi-shoin. Desha t’i thosha Antonit tonë se shumë u gëzova dje kur lexova në shtyp se romani „Oh” është përkthyer në gjuhën turke, por nuk ishte koha për të shprehur urimin. Vdekja e Nebilit na i kishte bërë sytë me xëc; as unë, as Antoni nuk i dallonim mirë numrat në ashensor. Megjithatë - i gjetëm numrat. Edhe njerëzit e tjerë ngjiten dhe zbresin me ashensor, libra të rinj duhet të botohen. Dhembjen e bëjnë më të vogël librat që do të dalin. Edhe librat që i ka shkruar Nebili ynë i nderuar përjetë...

„Fjala”
nëntor, 1989

Përmbajtja:

Sali Bashota
Vehap Shita

Jakup Ceraja
Emin Kabashi
Arsim Kajtazi
...

Koha e kundërshtisë
Përjetimi subjektiv i realitetit objektiv në prozën
artistike të Nebil Durakut
„Shtrojera” - roman realist
Historiku i rritës sonë
„Shtrojera” - leje e njoftimit